
Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Projekti Kundër Krimet Ekonomik në Kosovë ¹ (PECK)
www.coe.int/peck

RAPORTI I VLERËSIMIT
mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare
në fushën kundër korrupsionit (KK)

Cikli II

3 Dhjetor 2014

¹ Ky shënim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni:
Njësia për bashkëpunimin kundër krimit ekonomik
Departamenti për veprimin kundër krimit
Drejtoria e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe sundimin e Ligjit
Këshilli i Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex
E-mail: contact.econcrime@coe.int
Internet:
www.coe.int/corruption;
www.coe.int/peck

Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Shkurtesat

AKK	Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit
AP	Avokati i Popullit
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit / Ministria e Financave
ARKB	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë / Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DASHC	Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil / Ministria e Administratës Publike
DK	Dogana e Kosovës
DKu	Deputet e Kuvendit
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FATF	Task Forca për Veprimin Financiar
GjS	Gjykata Supreme
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit / Këshilli i Evropës
IAP	Instituti i Administratës Publike / Ministria e Administratës Publike
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KFOR	Forca e NATO-s në Kosovë
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
KK	Kuvendi i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPMK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës për Shërbimin Civil
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRrPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MAP	Ministria e Administratës Publike
MONEYVAL	Komisioni i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit/Këshilli i Evropës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NjIF	Njësia e Inteligjencës Financiare/Ministria e Financave
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PK	Policia e Kosovës
PKEK	Projekt i financuar bashkërisht nga BE/KiE kundër Krimit Ekonomik në Kosovë
PSH	Prokuroria e Shtetit
PSRK	Prokuroria Speciale e Kosovës
STE	Seria e Traktateve Evropiane
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZBEK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjimore/Zyra e Kryeministrit

Përmbajtja

I. HYRJE	5
II. ANALIZA	7
1. Shqyrtim i përgjithshëm i situatës aktuale të korrupsionit	7
2. Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit	11
2.1. Gjyqtarët	11
2.2. Prokurorët	17
2.3. Policia	19
2.4. Administrata Publike	23
2.5. Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit - Deputetët e Kuvendit	30
2.6. Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore	33
2.7. Prokurimi Publik	37
3. Ligji penal, zbatimi i ligjit dhe procedura penale	41
3.1. Veprat penale dhe sanksionet	41
<i>Përgjegjësia e personave juridikë</i>	43
3.2. Hetimet dhe procedura penale	45
3.3. Konfiskimi dhe mohimi tjetër i dobive pasurore dhe i të ardhurave nga krimi	49
3.4. Imuniteti nga hetimi, ndjekja ose dënimi i veprave penale të korrupsionit	50
4. Bashkëpunimi ndërkombëtar	51
III. PËRFUNDIME	52

I. HYRJE

1. Vlerësimi i parë i Kosovës kundrejt standardeve ndërkombëtare kundër korrupsionit është bërë në kuadër të Projektit të Përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës Kundër Krimin Ekonomik në Kosovë (PECK), të zbatuar gjatë një periudhe prej 38 muajsh duke filluar nga 1 shkurt 2012 deri më 31 mars 2015. Cikli i parë i vlerësimit (nga dy) ka zgjatur nga shtatori 2012 deri në maj 2013. [Raporti korrespondues i Vlerësimit](#) të regjimit kundër korrupsionit në Kosovë (më tutje në tekst si "RV") është miratuar më 10 qershor 2013. Ai është bazuar në standardet e Këshillit të Evropës dhe standardet e tjera ndërkombëtare si më poshtë dhe është përgatitur duke përdorur metodologjinë dhe praktikën e GRECO-s të përshtatur në mënyrë specifike për Kosovën:

- Njëzetë Parimet Udhëzuese për Luftën kundër Korrupsionit (Rezoluta e KM (97) 24);
- Konventa Penale kundër Korrupsionit (STE Nr. 173) dhe Protokollin e saj shtesë (STE Nr. 191);
- Konventa Civile kundër Korrupsionit (STE Nr. 174);
- Rekomandimi për Kodet e Sjelljes për Zyrtarët Publikë (Rekomandimi i KM Nr. (2000) 10);
- Rregullat e përgjithshme kundër Korrupsionit në Financimin e Partive Politike dhe Fushatave Zgjedhore (KM Rek(2003)4);
- Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC).

2. Objektiva e këtij raporti është vlerësimi i masave të ndërmarra nga autoritetet e Kosovës për të qenë në përputhje me 62 rekomandimet e dhëna në RV, sipas çështjeve si në vijim:

- Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit në aspektin e gjyqësorit (gjyqtarëve dhe prokurorëve), policisë, administratës publike, deputetëve të Kuvendit, financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore dhe prokurimit publik;
- E drejta penale, zbatimi i ligjit dhe procedurat penale: veprat penale dhe sanksionet, hetimet dhe procedurat penale, konfiskimi dhe privimet e tjera të dobive dhe të të ardhurave prej veprave penale, imunitetet nga hetimet, ndjekja penale apo gjykimi i veprave penale të korrupsionit; dhe
- Bashkëpunimi ndërkombëtar.

3. Informacioni fillestar mbi progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të RV është mbledhur nga autoritetet kompetente dhe burimet e disponueshme, si dhe takimet dypalëshe dhe punëtoritë me institucionet përfutuese dhe palët e tjera të interesuara të organizuara nga Projekti PECK gjatë periudhës nga muaji tetor 2013 deri në mesin e muajit shkurt 2014.

4. [Raporti Përcjellës](#) mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën kundër korrupsionit është finalizuar në muajin prill 2014 dhe është bërë publik në muajin qershor të vitit 2014. Ai ka vlerësuar nivelin e zbatimit të çdo rekomandimi individual dhe pajtueshmërinë e përgjithshme me standardet relevante ndërkombëtare. Raporti i Monitorimit ka përfunduar se rekomandimet e RV xxxiv dhe xxxviii janë zbatuar në mënyrë të kënaqshme; rekomandimet iii, xvi, xvii, xx, xxi, xxv, xxvi, xxxi, xxxiii, xxxv, xxxvii, xxxix, xli, xlv dhe lv janë zbatuar pjesërisht dhe rekomandimet i, ii, iv, v, vi, vii, viii, xix, xxii, xxiii, xxiv, xxvii, xxviii, xxix, xxx, xxxii, xxxvi, xl, xlii, xliii, xlv, xlvi, xlvii, xlviii, xlix, l, li, lii, liii, liv, lvi, lvii, lviii, lix, lx, lxi dhe lxii nuk janë zbatuar.

5. Në kuadër të ciklit të dytë të vlerësimit të projektit, informacioni vijues mbi progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të RV është mbledhur nga autoritetet kompetente dhe palët e tjera të interesuara gjatë vizitës në terren të organizuar nga Projekti PECK nga data 14 deri më 18 prill 2014 dhe menjëherë pas kësaj. Draft raporti është dorëzuar për komente më 15 shtator 2014 dhe është diskutuar në detaje me autoritetet relevante në takimin ballafaques më 3 dhe 4 nëntor 2014 dhe është përditësuar nën dritën e informacioneve shtesë të pranuar me shkrim.

6. Raporti është hartuar nga Ekipi i Vlerësimit i përbërë nga ekspertët e Këshillit të Evropës: z.Flemming Denker, ekspert i së drejtës penale, zbatimit të ligjit, procedurës penale dhe bashkëpunimit ndërkombëtar (Danimarkë); z. Drino Galičić, ekspert për mbrojtjet themelore dhe parandalimin e korrupsionit në lidhje me gjyqtarët, prokurorët, policinë dhe administratën publike (Bosnjë dhe Hercegovinë); z. Jean-Christophe Geiser, ekspert për parandalimin e korrupsionit në lidhje me deputetët e Kuvendit dhe financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore (Zvicër) dhe z. Edmond Dunga, Këshilltar i Projektit PECK.

7. Raporti aktual vlerëson zbatimin e çdo rekomandimi individual (të gjitha rekomandimet e RV përveç rekomandimeve xxxiv dhe xxxviii të cilat janë konsideruar si të zbatuara në mënyrë të kënaqshme në Raportin e Monitorimit, shih paragrafin 4 më lart) dhe ofron një vlerësim të

përgjithshëm përfundimtar të nivelit të përputhshmërisë së Kosovës me këto rekomandime në kuadër të Projektit aktual PECK.

II. ANALIZA

1. Shqyrtim i përgjithshëm i situatës aktuale të korrupsionit

Rekomandimet i dhe ii

8. Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar:

(i) të ndërmerret një vlerësim periodik i rreziqeve të korrupsionit, para çdo rishikimi tjetër të dokumenteve strategjike (strategjisë kundër korrupsionit dhe planit të veprimit); (ii) të miratohet një qasje më e integruar e aspekteve etike përmes planeve adekuate të integritetit, me qëllim të shtrirjes së masave parandaluese në tërë sektorin publik, përfshirë edhe pushtetin lokal; dhe (iii) të publikohen të gjeturat përkatëse dhe kështu të definohen/përshtaten më tej prioritetet strategjike (paragrafi 62); dhe

të sigurohet zbatimi dhe monitorimi i duhur dhe efektiv i kornizës së re strategjike kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017, si dhe të zbatohen masat kyçe që nuk janë zbatuar prej planit të mëparshëm të veprimit 2010-2011 (paragrafi 72).

9. Pas vonesave në fazën e miratimit gjatë vitit 2013, strategjia aktuale kundër Korrupsionit dhe Planit i Veprimit (2013-2017) ofrojnë orientim të përgjithshëm për parandalimin dhe luftimin kundër korrupsionit në të gjitha institucionet e Kosovës. Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit (AKK) monitoron periodikisht statusin e zbatimit të Planit të Veprimit në fjalë. Kështu, në pajtim me raportin e fundit gjashtëmujor në dispozicion që përfshin periudhën prej muajit janar deri në muajin qershor 2014, duket se vetëm rreth 43% nga numri i përgjithshëm i aktiviteteve të planifikuara për atë periudhë kanë fituar statusin "i zbatuar", 11% janë në proces të zbatimit, përderisa 46% janë të raportuara ose si të pazbatuara ose nuk janë fare të raportuara. Sistemi raportues tek AKK-ja parasheh që institucionet përgjegjëse dhe organizatat e shoqërisë civile të emërojnë pika kontakti të cilët do të jenë përgjegjës për raportimin tek AKK në lidhje me nivelin e zbatimit në çdo sektor dhe institucion. Ky raport i fundit si dhe raporti vjetor i vitit 2013, tregojnë megjithatë një përqindje të konsiderueshme të aktiviteteve të pazbatuara dhe të paraportuara, një rezultat i moskomunikimit të organizatave të shoqërisë civile, shoqatave profesionale të medieeve por edhe Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe disa ministrive kyçe me AKK-në. Institucionet e tjera, të cilat komunikojnë përmes pikave të tyre të kontaktit, raportojnë në mënyrë të pamjaftueshme mbi shumicën e aktiviteteve kundër korrupsionit. Kjo tregon një shkallë jashtëzakonisht të vogël të pronësisë dhe mungesës së besimit reciprok në kornizën strategjike, përfshirë strukturën aktuale të menaxhimit.

10. Përveç kësaj, planifikimi strategjik dhe zbatimi i politikave kundër korrupsionit bazuar në vlerësimet e rrezikut dhe integritetit nuk është bërë ende një realitet në Kosovë. Në të vërtetë, Ekipi i Vlerësimit ka mësuar se një projekt në vazhdim e sipër i UNDP-së është duke ofruar aktualisht asistencë në hartimin e planeve të integritetit në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe energjisë. Para ca kohe, hartimi i udhëzimeve ndërqeveritare për planet e integritetit është iniciuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit (ZQM) por ky proces nuk është përfunduar ende. Në lidhje me vlerësimin e rrezikut në planifikimin e aktiviteteve të mëtutjeshme kundër korrupsionit, po ashtu nuk ka ndonjë tregues nëse ekziston ndonjë metodologji e përbashkët për këtë lloj aktiviteti përkundër faktit se AKK-ja ka marrë asistencë dhe përkrahje ndërkombëtare në këtë aspekt me rastin e hartimit të Strategjisë kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit.

11. Në përfundim, gjenerata aktuale e dokumenteve strategjike kundër korrupsionit është promovuar duke treguar pak ose fare kosto-efektivitet dhe me mungesë të analizimit të rrezikut.

12. Në mënyrë që të zbatohen rekomandimet (i) dhe (ii), sipas mendimit të Ekipeve të Vlerësimit është e një rëndësie të madhe që treguesit për matjen e suksesit në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit të zhvillohen në mënyrë që të lejojnë gjurmimin e progresit nga sektorët dhe gjatë gjithë kohës. Kjo mund të bëhet, për shembull, gjatë ndryshimit të Planit aktual të Veprimit në vitin 2015. Po ashtu, politikat kundër korrupsionit duhet të mbështeten më shumë në fakte në të ardhmen. Që kjo të ndodhë, duhet të hartohet së shpejti një agjendë me një seri përpjekjesh të vlerësimit të rrezikut edhe në kuadër të ndryshimit të Planit të Veprimit kundër Korrupsionit nga AKK-ja. Kështu, përveç vlerësimit të rrezikut në arsim dhe shëndetësi të cilat janë duke u bërë me asistencën e UNDP-së, sektorët e tjerë siç janë prokurimi publik, financat publike etj. do të mund të përfshiheshin. Ky aktivitet do të tregonte përkushtim drejt zbatimit të rekomandimit relevant dhe do të mund të planifikohej për periudhën janar-maj 2015.

13. Përveç kësaj, mbi bazën e të gjeturave dhe konkluzioneve të shtjelluara me projektin aktual të UNDP-së, ZQM/ZKM duhet përfundimisht të miratojë udhëzimet për planet e integritetit në institucionet qeveritare, të cilat do të mund të ofronin shembull për organet e tjera publike, përfshirë ato në nivelin e qeverisjes lokale. AKK dhe ZQM duhet po ashtu t'i kushtojnë më shumë rëndësi shkaqeve për përqindjen e ulët të masave zbatuese nga Plani i Veprimit kundër korrupsionit, dhe në përputhje me rrethanat t'i adresojnë këto me autoritetet kompetente. Qeveria do të mund, me propozimin e ZQM/ZKM, të miratojë rregullore, për shembull, të cilat do të përcaktonin përgjegjësi të qarta mbi institucionet qeveritare për (mos)zbatimin e aktiviteteve të planifikuara dhe të kërkojë futjen e masave kundër korrupsionit në listën e Planit të Veprimit në planet vjetore të punës të çdo institucioni, siç sugjerohet në konkluzionet e Strategjisë kundër Korrupsionit 2013-2017. Kjo është për shkak se është e qartë se besueshmëria e tërë mekanizmit raportues, nga miratimi e deri te zbatimi i Planit të Veprimit vuan nga mangësi serioze.

14. Prandaj, Ekipi i Vlerësimit sugjeron që AKK në bashkëpunim me ZQM dhe institucionet e tjera përgjegjëse të ofrojnë më shumë sqarime analitike, jo vetëm përmes shembujve dhe statistikave, mbi arsyet për moszbatimin e shumicës së masave nga Plani i ri i Veprimit Kundër Korrupsionit.

15. Ekipi i Vlerësimit i përmbahet qëndrimit se duhet të ekzistojë një institucion i fuqishëm në sistem që siguron pronësi dhe besueshmëri ndaj planifikimit strategjik dhe zbatimit të aktiviteteve kundër korrupsionit. Përderisa nuk ofrohet një përgjigje më e fuqishme në periudhën e ardhshme, për shembull përmes fuqizimit të AKK-së apo institucioneve alternative, nuk do të ketë progres drejt përmbushjes së qëllimeve dhe masave të Strategjisë kundër korrupsionit dhe të rekomandimeve relevante të këtij raporti.

16. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimet i dhe ii nuk janë zbatuar.

Rekomandimi iii

17. *Ekipi i vlerësimit ka rekomanduar që (i) të rregullohet korniza legjislative në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit, përmes harmonizimit të legjislacionit përkatës me Kodin Penal që është miratuar së fundmi; (ii) të shqyrtohet dhe të qartësohet korniza institucionale për parandalimin e konfliktit të interesit, përmes miratimit të një sërë udhëzuesve që do të mundësonin veprime efikase gjatë procedurave për kundërvajtje dhe atyre për veprat penale, (iii) të iniciohet debat mbi ripërcaktimin e kompetencave të AKK-së, nga pikëpamja e nevojës për parandalim më efikas dhe efektiv të korrupsionit; dhe (iv) të përfshihen në mënyrë progresive autoritetet tatimore në verifikimin e pasurive të deklaruara, në mënyrë që të përmirësohet kontrolli i prejardhjes së pasurisë, dhe kështu të zvogëlohet hapësira për pasurim të paligjshëm (paragrafi 79).*

18. Autoritetet e Kosovës njoftojnë se Ligji mbi parandalimin e konfliktit të interesit (më tutje në tekst si "Ligji mbi Konfliktin e Interesit") është ende në proces të harmonizimit me Kodin e ri Penal dhe se ndryshimet relevante janë pezull në Kuvendin e Kosovës. Mosmiratimi i këtyre ndryshimeve dhe ekzistenca e përkufizimeve të ndryshme të konfliktit të interesit mund të kenë pasoja mbi efektshmërinë e bashkëpunimit në mes të AKK-së dhe Prokurorisë. Siç nënvizon raporti vjetor i AKK-së për vitin 2013, ekziston një numër relativisht i lartë i rasteve të hetimeve administrative mbi konfliktin e interesit të udhëhequra nga AKK-ja dhe të përcjella në Prokurori për hetime të mëturshme penale dhe ngritje të mundshme aktakuze, por të cilat janë hedhur nga kjo e fundit. Arsyet për pezullimin apo heqjen dorë nga hetimet e mëturshme nuk janë mbështetur sa duhet as në raportet e AKK-së as ato të Prokurorisë. Kjo dëshmon edhe njëherë se bashkëpunimi në mes të AKK-së dhe Zyrës së Prokurorit duhet të përmirësohet, siç rekomandohet, në veçanti me qëllimin për të përcaktuar rolet përkatëse me rastin e hetimeve mbi konfliktet e interesit pas kriminalizimit të kësaj vepre penale në vitin 2013.

19. Që nga mesi i vitit 2014, autoritetet e Kosovës kanë raportuar mbi disa përmirësime në komunikimin dhe koordinimin në mes të AKK-së dhe Prokurorisë në ndjekjen penale të rasteve të konfliktit të interesit dhe deklarimit të rremë: nënshkrimi i dokumentit me 26 maj 2014 nga krerët e Prokurorisë, Policisë dhe AKK-së, pas të cilit Kryeprokurori nënshkroi vendimin me 30 qershor 2014 që për çdo rast të prezantuar nga AKK-ja duhet të bëhet një konsultim paraprak në mes të prokurorëve dhe zyrtarëve të AKK-së. Po ashtu me 23 tetor 2014, AKK-ja, autoritetet e Prokurorisë dhe ato Gjyqësore u takuan për të diskutuar përcjelljen e rasteve të deklarimit të rremë të pasurive.

20. Këto janë hapa pozitivë por në përgjithësi, procedimi dhe sanksionimi i rasteve të konfliktit të interesit është ende i ulët. Statistikat nuk janë ende të sakta dhe duhet të vihen në rregull deri

në fund të vitit 2014 kur duhet të publikohet historiku i hetimeve, ndjekjeve penale dhe vendimmarrjeve gjyqësore i rasteve të konfliktit të interesit.

21. Po ashtu, në lidhje me konfliktet e interesit, standardet relevante ndërkombëtare i referohen konceptit të 'zyrtarit publik' në vend të 'personit zyrtar' në mënyrë që të përfshijnë edhe personat e punësuar nga një autoritet publik si dhe personat e punësuar nga organizatat private që ofrojnë shërbime publike. Prandaj, këshillohet që përkufizimi i fushëveprimit të Ligjit të ndryshuar mbi Konfliktin e Interesit të korrespondojë më afër me përkufizimin e "zyrtarit publik" sipas Nenit 2 a) të Konventës së KB-së mbi Korrupsionin (UNCAC). Edhe pse i propozuar në mënyrë të gjerë, përkufizimi i UNCAC-ut kufizohet në atë që përmbahet në "ligjin vendor". Përndryshe, shtrirja e mundshme e rregullave të konfliktit të interesit tek nivelet e tjera të zyrtarëve publikë ngre brenga në lidhje me zbatimin. Ekziston rreziku se organi zbatues – AKK-ja - bëhet i përgjegjshëm për çdo të emëruar në sektorin publik të institucioneve të Kosovës. Nëse ky do të ishte rasti, përgjegjësitë e reja mbikëqyrëse duhet të përcillen me burime shtesë të përshtatshme; përndryshe, vendosja e barrës së vetme mbi një institucion për të gjithë zyrtarët publikë në Kosovë do ta komprometonte seriozisht zbatimin e duhur të rregullave të reja.

22. Sa i përket deklarimit të pasurisë, Ekipi i Vlerësimit vëren se ndryshimet në Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për tërë Zyrtarët Publikë (më tutje si "Ligji mbi Deklarimin e Pasurive"), i miratuar në muajin prill të vitit 2014 nga Kuvendi i Kosovës, dhe harmonizimi me Kodin Penal të vitit 2013 është arritur. Megjithatë, mbetet e panjohur se deri në çfarë mase këto ndryshime do t'i zgjidhin konfliktet në mes të procedurave administrative dhe penale si dhe nëse AKK-ja do të jetë e mbingarkuar me një numër të zgjeruar të kërkesave për verifikimin e pasurive për shkak të përkufizimit të zgjeruar të nocioneve "person zyrtar" dhe "person i besuar" në tekstin e miratuar. Autoritetet e Kosovës raportojnë megjithatë se trajtimi i rasteve të deklarimit të rremë ka ndryshuar pasi që dëshmia e mbledhur nga AKK-ja tani përdoret nga Prokurori, i cili më shpesh e thërret AKK-në si dëshmitar në procedurat penale. Me 16 tetor 2014, KPK-ja ka obliguar prokurorët e apelit t'i rivlerësojnë të gjitha rastet në të cilat AKK-ja ka sjellë dëshmi, por statistikat mbi historikun do të bëhen të njohura vetëm nga fundi i vitit. Për momentin, statistikat mbahen manualisht, dhe në vitin 2015 do të zhvillohet një mjet i menaxhimit automatik.

23. Përveç kësaj, Ekipi i Vlerësimit gjen se një interpretim mjaftë i ngushtë i parimit të "barrës së provës" gjatë verifikimit të saktësisë të pasurive, i pengon autoritetet relevante të marrin veprime më proaktive kundër pasurive të dyshuara dhe të pashpjeguara të zyrtarëve publikë. Duhet të gjendet një balancim i duhur në mes të garancive për gjykim të drejtë dhe trajtimin urgjent të këtij fenomeni. Si fillim, autoritetet do të mund të merrnin udhëzim nga raporti i Këshillit të Evropës "*Manuali i praktikantëve mbi procedimin dhe analizimin e deklarimit të të hyrave dhe pasurive të zyrtarëve publikë*", i përgatitur në kuadër të Partneritetit Lindor - Projekti Lehtësues mbi Qeverisjen e Mirë dhe Luftën kundër Korrupsionit i Këshillit të Evropës, në janar të vitit 2014. Këshillohet fuqishëm që të zhvillohet sa më shpejt një linjë e duhur politikash mbi këtë problem të veçantë të pasurisë së pashpjeguar, që mund pastaj të zërthehet më tutje në një rregullore konkrete.

24. Gjurmimi përgjithësisht i dobët i historisë së hetimit dhe sanksionimit të zyrtarëve për shkeljen e rregullave të konfliktit të interesit dhe deklarimit të pasurive edhe pasi që Kodi Penal ka hyrë në fuqi në vitin 2013, thërret ashtu siç rekomandohet sipas pikës (iii), për një diskutim mbi riorientimin e kompetencave të AKK-së, domethënë rivlerësimi nëse kompetencat hetimore (administrative) duhet të mbetet apo jo kompetencë e saj kryesore dhe nëse tërë hetimi i këtyre veprave penale duhet të zhvillohet nga autoritetet e prokurorisë. Që kjo të ndodhë, AKK-ja mund ta thërrasë një konferencë ose të kërkojë mendim të ekspertëve me qëllim të miratimit të konkluzioneve që do të çojnë në ndryshimin e legjislacionit. Aspekti i dytë i këtij rishikimi do të mund të mbulonte fushëveprimin e verifikimit të deklarimeve të pasurive, në mënyrë që të dihet se deri në çfarë mase AKK-ja mund të verifikojë prejardhjen e pasurisë, nëse mund ta bëjë këtë plotësisht. Me qëllim të përforsimit të mbajtjes së të dhënave të rasteve të proceduara të deklarimit të rremë të pasurive, Ekipi i Vlerësimit e përsërit rekomandimin e tij për vendosjen e një sistemi të kontrollimit të ndërsjellë të të dhënave, përmes shkëmbimit automatik të të dhënave mes Administratës Tatimore, AKK-së, Regjistrisë Kadastrale (të Tokave etj.). Fillimisht, mund të jetë e nevojshme që çdonjëra nga këto baza të të dhënave të jenë në rregull para se të bashkohen me njëra-tjetrën. Vetëm nëse harmonizohen njëherë dhe më pas bashkohen, bazat e ndryshme të të dhënave duhet të lejojnë një gjurmim më efikas të shkeljeve të rregullave mbi deklarimin e pasurive.

25. Ekipi i Vlerësimit vëren se ndryshimet e miratuara në prill të vitit 2014, si dhe ato që kanë mbetur pezull në Kuvendin e Kosovës në legjislacionin relevant janë të nevojshme në mënyrë që të bëhet harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit relevant të konfliktit të interesit dhe deklarimit të

pasurive me Kodin Penal 2013. Përkundër hapave pozitive të marra për të siguruar koordinimin më të mirë të hetimit,ekziston ende një rrezik paefektshmërie të vazhdueshme në procedimin e veprave penale të deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesit edhe pas miratimit të tyre. Veprimet e autoriteteve kompetente dhe sanksionet përfundimtare të zbatuara duket se nuk kanë një efekt bindës.

26. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi iii është zbatuar pjesërisht.

2. Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit

2.1. Gjyqtarët

Rekomandimet iv, v dhe vi

27. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që:*

të rishikohet përbërja e KGJK-së për ta pasqyruar plotësisht standardin e pavarësisë së gjyqësorit, si dhe ndarjen e pushteteve mes institucioneve (paragrafi 114);

të miratohen kritere të qarta dhe transparente në bazë të të cilave presidenti do të mund ta refuzonte nominimin e ndonjë gjyqtari apo prokuroi, si dhe bazën për apelimin e këtij vendimi (paragrafi 119); dhe

të merret parasysh shqyrtimi i sistemit provues të emërimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, i cili parasheh afatin fillestar trevjeçar para konfirmimit përfundimtar të mandatit (paragrafi 129).

28. Autoritetet e Kosovës informojnë se zbatimi i rekomandimeve iv dhe vi kërkon ndryshime të mëtejshme në Kushtetutë, pasi që përbërja e KGJK-së dhe sistemi sprovues i emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve rregullohet me Kushtetutë. Ministria e Drejtësisë ka bërë përpjekje të prezantojë projekt ndryshimet e para vitin e kaluar, por kjo përpjekje ka dështuar. Autoritetet po ashtu kanë përmendur se Opinioni nr. 403/2006 i Komisionit të Venedikut mbi Emërimin e Gjyqtarëve është aplikuar dhe është marrë parasysh në lidhje me emërimin e gjyqtarëve që përcakton kritere sipas të cilave duhet të bëhet vlerësimi. Pas kësaj, Këshilli ka themeluar Komisionin që është marrë me vlerësimin e gjyqtarëve që kanë përmbushur periudhën trevjeçare të sprovimit. Deri më tani, 58 gjyqtarë janë vlerësuar dhe iu është dhënë mandat i përhershëm.

29. Sa i përket rekomandimit v, autoritetet e Kosovës rikujtojnë se sipas Nenit 18 paragrafi 2 i Ligjit mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Presidentja e Kosovës obligohet që brenda 60 ditëve ta japë një arsyetim mbi refuzimin e kandidatëve për gjyqtarë të cilët kanë qenë të propozuar nga KGJK, përderisa sa i përket bazës për ankesa, do të aplikohen dispozitat e ligjit të konfliktit administrativ. Sipas praktikës, pas një refuzimi dhe ridorëzimit të përsëritur për emërimin e një kandidati, Presidenti ka përcjellë propozimin e KGJK-së.

30. Ekipi i Vlerësimit ka qëndrimin se niveli i parimeve themelore për parandalimin e korrupsionit në gjyqësor, si pavarësia dhe llogaridhënia e gjyqtarëve duhet të ngrihet. Dispozitat aktuale kushtetuese dhe ligjet të cilat rregullojnë përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), emërimet dhe shkarkimet në gjyqësor si dhe karrierën gjyqësore nuk e kanë arritur, sipas mendimit të Ekipit të Vlerësimit, nivelin e garancive të kërkuara nga standardet Evropiane.

31. Kjo i referohet në veçanti përbërjes së KGJK-së, dhe rolit të Presidentit të Kosovës në emërimin përfundimtar dhe periudhës së provës për gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar për herë të parë.

32. Prandaj, është shumë e rekomandueshme që në periudhën vijuese autoritetet relevante (KGJK, KPK, Ministria e Drejtësisë) të thërrasin një konferencë ndërkombëtare mbi pavarësinë e gjyqësorit dhe parimet themelore, gjatë së cilës do të përcaktoheshin parimet mbi reformat e ardhshme kushtetuese dhe ligjore. Kjo konferencë do të mund ta kishte pjesëmarrjen e ekspertëve të Komisionit të Venedikut si dhe vlerësuesve të GRECO-s në mënyrë që të nxiten debate dhe fokusi mbi nivelin e kërkuar të ndryshimit të nevojshëm në Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e tjera themelore mbi gjyqësorin. Përveç kësaj, Plani Strategjik i Gjyqësorit të Kosovës 2014-2019 i miratuar nga KGJK në prill të vitit 2014 tanimë ka paraparë ndryshimin e Kushtetutës në lidhje me emërimet sprovuese. Nëse të gjitha aktivitetet e planifikuara në Planin Strategjik realizohen, në veçanti nëse Ministria e Drejtësisë e inicion sërish procedurën për ndryshimin e Kushtetutës, kjo do të mund të paraqiste bazë të mirë për zbatimin e rekomandimit vi.

33. Në veçanti, fokusi duhet të jetë si në vijim:

- Përbërja e KGJK-së: së paku gjysma e anëtarëve të KGJK-së të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga të ngjashmit e tyre. Përderisa kushti i parë është përmbushur për momentin, i dyti nuk është përmbushur: vetëm 5 nga 9 gjyqtarë të KGJK-së zgjidhen nga të ngjashmit e tyre, 4 të tjerët zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës, gjë që e vendos zgjedhjen e tyre nën

rrezikun e pazareve politike. Parimi i përcaktuar si më lartë në Kartën Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve dhe i cili bëhet i zëshëm në Rekomandimin (2010)12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në adresë të Shteteve Anëtare mbi Gjyqtarët: pavarësia, eficienta, dhe përgjegjësitë, i miratuar me 17 nëntor 2010, duhet të përfshihet plotësisht.

- Roli i Presidentit të Kosovës në lidhje me emërimin përfundimtar: Ligji mbi KGjK është i heshtur mbi atë nëse Presidenti ka diskrecion të plotë ta refuzojë kandidatin për emërim si gjyqtar/prokuror. Refuzimi duhet të arsyetohet mbi kërkesat e qarta ligjore dhe jo t'i lihet në diskrecion Presidentit roli i të cilit është vetëm konfirmimi i propozimeve të KGjK/KPK-së, përderisa ai/ajo konsideron se nuk janë respektuar parakushtet ligjore. Sa i përket të drejtës për ankesë kundër refuzimit të Presidentit, akti presidencial do të duhej të rishikohej përmes konfliktit kushtetues në vend të zbatimit të ligjit mbi konfliktin administrativ. Ekipi i Vlerësimit ka qëndrimin se refuzimi i kandidatëve për emërimin përfundimtar si gjyqtarë nga Presidenti i Kosovës, siç ka ndodhur në të kaluarën në disa raste, e nënvlerëson mbrojtjen themelore të pavarësisë së gjyqësorit siç garantohet me Kushtetutë. Arsyet për këto refuzime nuk janë bërë publike, dhe as nuk u janë njoftuar vetë kandidatëve të nominuar. Mungesa e transparencës në këtë aspekt është e dukshme. Autoritetet e Kosovës duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për ta ndryshuar perceptimin publik të procesit të emërimit dhe të përshkruajnë kriteret e qarta, objektive dhe transparente sipas të cilave Presidenti mund të refuzojë një kandidat. E drejta e ankesës ndaj vendimit të Presidentit duhet të përfshihet në nivel të njëjtë të garancive.
- Periudha 3-vjeçare e provës: edhe pse standardet e përgjithshme ndërkombëtare, siç janë "Parimet themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësorit të miratuara nga Kongresi i 7-të i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimin dhe Trajtimin e Kryesve të Veprave Penale - më vonë i miratuar nga Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (APKB) 40/32 dhe 40/146 (1985)" janë të heshtura sa i përket periudhave të provës, kjo nuk favorizohet me standardet e Këshillit të Evropës, në veçanti atyre të Komisionit të Venedikut. Në Raportin e tij mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve, Komisioni i Venedikut rekomandon fuqimisht që gjyqtarët themelorë të emërohen në mënyrë të përhershme deri në daljen në pension dhe thotë se "periudhat e provës për gjyqtarët në detyrë janë problematike nga këndvështrimi i pavarësisë"². Vështirësia me periudha të tilla të provës është se ato aplikojnë prag më të ulët për shkarkim se ato me të cilat ballafaqohen gjyqtarët e përhershëm; përndryshe do të ketë më pak nevojë për periudhën e provës. Refuzimi i ripërtëritjes së kontratës së gjyqtarit për arsye të tjera nga ato të përcaktuara në ligj dhe kodet e etikës rrezikon injektimin e një niveli të arbitraritetit në proces i cili e shkel pavarësinë e gjyqësorit. Duke pasur parasysh se periudha provuese ka sipas përkufizimit natyrë të përkohshme, rekomandimi synon faktin se Kushtetuta e Kosovës e ka bërë atë të përhershme, gjë që është në kundërshtim me mbrojtjet themelore për pavarësinë e gjyqësorit. Kjo është saktësisht pika që Komisioni i Venedikut ka theksuar në Opinionin e lartpërmendur dhe autoritetet relevante të Kosovës janë thirrur edhe njëherë për të paraparë nisjen e një debati në frymën e faktit se refuzimi për të emëruar/konfirmuar gjyqtarin nuk bazohet në baza solide ligjore siç rekomandohet.

34. Ekipi i Vlerësimit është i vetëdijshëm se ky rekomandim është dukshëm më politik dhe më i vështirë të zbatohet (më shumë një qëllim se sa vepër në vete), prandaj nuk duhet domosdoshmërisht të konsiderohet si pjesë qendrore e ndonjë politike kundër korrupsionit. Megjithatë, është thelbësisht e rëndësishme të caktohet një debat publik në muajt në vijim në mënyrë që të adresohen brengat kyçe dhe parimet e përcaktuara në rekomandimet (iv-vi) të cilat do të mbeten të vlefshme për Kosovën gjatë tërë procesit të integritetit Evropian.

35. Ekipi i Vlerësimit rekomandon fuqishëm që kjo të adresohet përmes nisjes së konsultimit publik në lidhje me nivelin e mbrojtjeve dhe garancive të cilat Kosova duhet t'i ketë në fushën e pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit.

36. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimet iv deri në vi nuk janë zbatuar.

² Shih Komisionin e Venedikut, Raporti për Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve, 16 mars 2010 që gjendet në [http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD\(2010\)004-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD(2010)004-e.pdf), § 38.

Në këtë aspekt, me 11 qershor 2014, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka vendosur që ta ftojë Kosovën të bëhet anëtare e Komisionit të Venedikut dhe ta emërojë përfaqësuesin e saj për t'u ulur në Komision (për informata të mëtejshme, shih http://www.coe.int/t/cm/home_en.asp dhe <http://www.venice.coe.int/webforms/events/?id=1767>).

Rekomandimet vii dhe viii

37. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që:*

të sigurohet funksionimi i duhur i caktimit të rastësishëm të lëndëve, siç është parashikuar në Rregulloren për organizimin e brendshëm të gjykatave (paragrafi 141); dhe

(i) të themelohet një sistem transparent dhe i unifikuar për ruajtjen dhe qasjen e informatave rreth dosjes së lëndës, ku do të përfshiheshin të gjitha fazat e hetimeve, të ndjekjes penale dhe të gjykimit; (ii) të përmirësohet menaxhimi i lëndëve, raportimi dhe qasshmëria e statistikave në sistemin gjyqësor, në veçanti lidhur me korrupsionin dhe veprat e ndërlidhura, duke siguruar përputhshmëri më të mirë me shërbimet e prokurorisë; dhe (iii) të përmirësohet transparenca e sistemit të drejtësisë penale kundrejt qytetarëve dhe medieve, veçanërisht në kontekstin e parandalimit dhe të luftimit të korrupsionit (paragrafi 144).

38. Autoritetet e Kosovës vazhdojnë të ofrojnë shumë pak informacione në lidhje me këto rekomandime. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është duke e zbatuar fazën e parë të Strategjisë së Informacionit dhe Komunikimit 2012-2017. Kjo Strategji parasheh zbatimin e të ashtuquajturit Sistemit Informativ të Menaxhimit të rasteve që do ta mundësojë caktimin elektronik të rasteve. Është marrë shënim se është miratuar Rregullorja e re mbi organizimin e brendshëm të gjykatave, e cila do të bëjë përfundimisht operacional 'caktimin me short të lëndëve', për pasojë rekomandimi (vii) ka mundësi të zbatohet. Megjithatë, pasi që nuk ekziston ende ndonjë sistem elektronik, caktimi me short i lëndëve bëhet ende manualisht. Po ashtu është marrë shënim se disa vështirësi në lidhje me masat kundër korrupsionit mund të priten në gjykatat e specializuara apo departamentet me një numër të vogël të gjyqtarëve ku parimi i caktimit me short të lëndëve nuk e ka arritur qëllimin e vet si p.sh. përfshirja e transparencës më të madhe në menaxhimin e gjykatave si dhe të sigurohet objektiviteti në trajtimin e rasteve më të ndërlikuara të korrupsionit edhe pse numri i gjyqtarëve që mund të merren me raste të tilla mbetet i kufizuar.

39. Në pajtim me Rregulloren, caktimi me short i lëndëve nuk aplikohet në rastet urgjente, të cilat iu caktohen gjyqtarëve mbi bazën e sistemit të rotacionit. Megjithatë, nuk kërkohet asnjë autorizim nga Presidenti i Gjykatës së Apelit para se të ndodhë caktimi urgjent i rasteve. Kjo nuk është në pajtim me Rregulloren e cila kërkon "autorizimin paraprak nga Presidenti apo nga Gjyqtari Mbikëqyrës, respektivisht". Një mangësi tjetër e vërejtur është se nuk mbahen procesverbale në lidhje me seancat gjatë së cilave ndodh caktimi me short i lëndëve. Një anomali e radhës është identifikuar në lidhje me ricaktimin e rasteve brenda gjykatës. Ricaktimi i rasteve nevojitet për të shmangur konfliktin e interesit kur një apel i caktohet një gjyqtari i cili ka qenë i përfshirë në procedurat e shkallës së parë në lidhje me rastin e njëjtë. Situatat e ngjashme mund të ndodhin si rezultat i reformave të fundit të sistemit të gjykatave në Kosovë dhe transferimi pasues i gjyqtarëve nga një gjykatë në tjetrën. Është evidentuar se ricaktimi i rasteve të tilla nuk e përcjell rregullin e përgjithshëm të caktimit me short të paraparë në Rregullore.

40. Ekipi i Vlerësimit ka vërejtur më tutje se nuk ka informacion thelbësor që demonstroi përmirësimin e qasjes në informacion mbi dosjet e rasteve. Në anën tjetër, "sistemi i menaxhimit të rasteve" - një mjet i automatizuar për menaxhimin e grumbullimit të përgjithshëm të rasteve është lajmëruar të bëhet shumë shpejt operacional si rezultat i projektit të financuar nga qeveria Norvegjeze. Për këtë qëllim, është themeluar Zyra e Menaxhimit të Rasteve. Menaxhimi i rasteve së bashku me caktimin me short të rasteve është një prej parakushteve për luftimin efikas kundër korrupsionit si në gjykata ashtu edhe në zyrat e prokurorëve.

41. Ekipi i Vlerësimit po ashtu merr shënim themelimin e "Zyrës së Koordinatorit Kombëtar" brenda Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), e cila duhet të koordinojë statistikën nga Policia, KPK dhe KGJK/Gjyqësori. Ajo mbështetet në koordinatorët në çdo institucion përgjegjës për mbledhjen dhe harmonizimin e statistikave. Megjithatë, ende mbetet për t'u parë se si një qasje e tillë e koordinuar mund të përdoret si mjet për ta luftuar korrupsionin. Ekipi i Vlerësimit mendon se të dhënat e sakta mbi numrin e rasteve të korrupsionit në të gjitha fazat e procedurës janë qenësore për themelimin e një përcjelljeje solide të hetimeve, ndjekjeve penale dhe gjykimeve të rasteve të korrupsionit. Në këtë drejtim, autoritetet informojnë se KPK ka miratuar procedura standarde të operimit për trajtimin e rasteve të rënda penale në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe ka zgjedhur 50 rastet më të rënda penale. Këto top 50 raste do të regjistrohen në bazën e të dhënave të vendosura nga KPK dhe të cilat do të ofrojnë informacione të detajuara deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. Informacioni do të përfshijë veprimet nga prokurori dhe gjykata si dhe kohëzgjatjen e rastit.

42. Ricaktimi i lëndëve si një masë e rëndësishme për të parandaluar konfliktin e interesit duhet të ndjekë sistemin (manual) të caktimit me short në pajtim me Rregulloren mbi veprimet e brendshme të gjykatave, deri sa të bëhet operacional caktimi elektronik i lëndëve.

43. Sistemi elektronik i caktimit me short të lëndëve duhet të bëhet plotësisht operacional në tërë gjyqësorin e Kosovës sapo të vihet në zbatim sistemi i menaxhimit të rasteve. Gjykatat dhe dhomat më të vogla apo të specializuara duhet të miratojnë rregulla të cilat nuk e vënë në pikëpyetje parimin e caktimit me short ndërkohë që mbajnë një shpërndarje të rasteve tek një numër i kufizuar i gjyqtarëve.

44. Ekipi i Vlerësimit vëren se disa kushte ligjore dhe rregullatore për vendosjen e caktimit me short të rasteve dhe sistemin e menaxhimit të rasteve janë miratuar suksesshëm, por rregullorja për veprimet e brendshme të gjykatave në lidhje me caktimin me short të rasteve nuk është respektuar tërësisht. Në mënyrë që të zbatohen këto rekomandime, autoritetet e Kosovës duhet të fillojnë të krijojnë kushte materiale për caktimin me short elektronik të lëndëve menjëherë pas fillimit të zbatimit të sistemit të menaxhimit të rasteve në tërë gjyqësorin.

45. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimet vii dhe viii janë zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi ix

46. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të përditësohen rregullat e etikës dhe të sjelljes profesionale për gjyqtarët, përmes përfshirjes së udhëzimeve të duhura, në veçanti lidhur me konfliktin e interesit dhe fushat e ndërlidhura (më konkretisht, për pranimin e dhuratave dhe përparësitë e tjera, mospërputhshmëritë dhe aktivitetet shtesë) (paragrafi 148).*

47. Autoritetet e Kosovës vazhdojnë të ofrojnë shumë pak informacion në lidhje me këtë rekomandim dhe në përgjithësi mbi menaxhimin e brendshëm të konfliktit të interesit brenda gjyqësorit. Informacioni i vetëm në dispozicion është se Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka kompletuar projekt Kodin e Etikës për Gjyqtarë dhe se ky projekt kod do t'i shkojë Këshillit për miratim pa detaje të mëtutjeshme. Megjithatë, në pyetjen nëse projekt Kodi i Etikës i adreson brengat e përmendura në rekomandim, më konkretisht pranimin e dhuratave dhe avantazheve të tjera, papajtueshmëritë dhe aktivitetet shtesë, autoritetet e Kosovës përgjigjen se ai nuk i adreson.

48. Bazuar në të dhënat e gjetura publikisht, Ekipi i Vlerësimit përfundon se zbatimi i kodeve ekzistuese të etikës nga KGjK dhe KPK mbetet i dobët, në veçanti në lidhje me procedurat disiplinore. Në mënyrë që të përmirësohet niveli i zbatimit, rregulloret disiplinore në të dy Këshillat duhet të përshtaten për t'u siguruar se procedurat dhe politikat disiplinore në luftën kundër korrupsionit në gjyqësor të japin rezultate konkrete.

49. Në mënyrë që të përforcohen më tutje masat disiplinore të parapara me Ligjet mbi KPK dhe KGjK, këta të fundit kanë kërkuar ndryshimin e legjislacionit në lidhje me procedurat disiplinore dhe funksionimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD). Ministria e Drejtësisë ka filluar tanimë plotësimin e këtyre ligjeve, përfshirë hartimin e një ligji të veçantë mbi ZPD. Për më shumë, KPK brenda Njësitit të Vlerësimit të Performancës së Prokurorëve (NjVPP) ka bazën e vet të të dhënave me informacione dhe vendime të nxjerra nga Komisioni Disiplinor i KPK-së dhe KGjK-së. Në vlerësimin e performancës së prokurorëve, NjVPP shqyrton po ashtu edhe vendimet në lidhje me shkeljet disiplinore kundër prokurorëve.

50. Ekipi i Vlerësimit merr shënim dhe mirëpret këtë zhvillim. Megjithatë, një vlerësim i thukët i historisë disiplinore mund t'i paraprijë këtij aktiviteti dhe të shërbejë si bazë për ta ndryshuar legjislacionin aktual apo për ta hartuar një të ri. Në këtë hap, KPK/KGjK do të mund të merrnin një shembull pozitiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, i cili ka themeluar një bazë të dhënash të azhurnuar periodikisht me statistika mbi masat disiplinore (shih paragrafët 104 e tutje më poshtë).

51. Përveç kësaj, dhe në pajtim me kornizën e përgjithshme ligjore mbi konfliktin e interesit në Kosovë, KGjK duhet të nxjerrë një rregullore mbi menaxhimin e brendshëm të konfliktit të interesit brenda KGjK-së si dhe në tërë gjyqësorin.

52. Trajnimi për arsimimin e vazhduar ligjor lidhur me etikën e gjyqtarëve duhet të bëhet i detyrueshëm. Ky trajnim duhet të theksojë praktikën dhe zgjidhjet për fenomenet negative të vërejtura të vetëcensurimit dhe nënshtrimit të gjyqtarëve ndaj ndikimeve të jashtme. Në lidhje me këtë, gjyqtarët duhet t'i shpërfillin kërkesat nga dega ekzekutive apo legjislative për të mos vazhduar në shqyrtimin e rasteve sipas parashikimit para gjykatave.

53. Përveç kësaj, masat disiplinore që rrjedhin nga sjellja e pahijshme, deri në si dhe përfshirë largimin nga funksioni duhet të aplikohen pavarësisht emërimit të përhershëm që i garantohet gjyqtarëve.

54. Ekipi i Vlerësimit vëren se përgjithësisht mungon një mekanizëm më rigoroz për monitorimin e zbatimit të rregullave të etikës dhe procedurat disiplinore, por që zhvillimet e fundit mund të përfaqësojnë një hap përpara nëse përcillen si duhet me ndryshime legjislative apo miratim të ligjeve të reja.

55. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi ix është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi x

56. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që KGJK-ja të miratojë udhëzues transparentë lidhur me miratimin e angazhimeve të jashtëzakonshme të jashtme të gjyqtarëve, duke i përfshirë arsyetimet e qarta që do të përdoren për dhënien e lejimeve të tilla (paragrafi 157).*

(Kjo i referohet po ashtu edhe rekomandimit xiv në lidhje me Prokurorët dhe xviii në lidhje me Policinë).

57. Autoritetet e Kosovës nuk kanë caktuar ende rregulla që qeverisin punësimin e jashtëm të gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë. Ata informojnë se Ligji aktual për Konfliktin e Interesit rregullon "aktivitetet e tjera" të të gjithë zyrtarëve, përfshirë gjyqësorin dhe policinë, duke iu lejuar ushtrimin e funksioneve jo-menaxheriale brenda partive politike apo ushtrimin e aktiviteteve në fushat e shkencës, sportit, arsimit, kulturës etj. Megjithatë, është raportuar se Projekt-kodi i ri i Etikës për gjyqtarë parasheh rastet e "punësimit jashtë" për të cilat KGJK mund të jap leje.

58. Ekipi i Vlerësimit e konsideron këtë zhvillim si hap të parë drejt një rregullimi më ligjor të kësaj çështje të ndjeshme, edhe pse AKK beson se Kodi i Etikës si legjislacion sekondar nuk duhet ta rregullojë çështjen e 'punësimit të jashtëm'. Ai argumenton se zbatimi i Kodit të Etikës është shumë i dobët dhe propozon në vend të kësaj që çështja e tillë të rregullohet me një ligj parësor.

59. Për t'i dhënë rëndësi këtij argumenti, AKK raporton se ekzistojnë raste të disa zyrtarëve publikë, në veçanti nga gjyqësori që ushtrojnë në mënyrë të njëkohshme disa funksione me pagesë jashtë orëve të punës, si në organe publike apo private, të cilat mund të çojnë në një numër të konflikteve të mundshme të interesit.

60. Ekipi i Vlerësimit ka qëndrimin se angazhimet e jashtme të paguara të gjyqtarëve duhet të lejohen vetëm përjashtimisht dhe sipas rregullimeve të rrepta dhe të zbatueshme, dhe ia lë autoriteteve të Kosovës të vendosin se cilat instrumente ligjore (ligji apo Kodi i Etikës) i përshtaten më shumë kësaj çështjeje. Në këtë kuptim, ai rikujton se rekomandimi më relevant i AKK-së në lidhje me punësimin e jashtëm të të gjithë zyrtarëve publikë nuk është përcjellë dhe mund të përbëjë një pikënisje. Ai i bën ftesë Kosovës që ta konsiderojë seriozisht këtë çështje si një prioritet në adresimin e konfliktit të interesit si për gjyqtarët ashtu edhe për prokurorët.

61. Prandaj, është e nevojshme që kushtet për aktivitetet "e jashtme" të përcaktohen në mënyrë të përpiktë në ligj dhe/apo në kodet e sjelljes për gjyqtarë, prokurorë dhe policë.

62. Në mënyrë që të evitohet shumëzimi i aktiviteteve të jashtme afariste që potencialisht çojnë në konflikt të interesit, këshillohet fuqishëm që rregullat etike të specifikojnë kufizime të aktiviteteve të jashtme për gjyqtarë, prokurorë dhe policë në fushat e shkencës, sportit, arsimit etj. vetëm për institucionet e sektorit publik, përderisa aktivitetet e njëjta në sektorin privat duhet si rregull të ndalohen, me një numër shumë të kufizuar të përjashtimeve.

63. Në këtë aspekt, këshillohet që rregullorja mbi kushtet për ushtrimin e "aktiviteteve të jashtme" publike dhe private, të bëhen pjesë përbërëse e "planeve të integritetit" të ardhshme për institucionet gjyqësore dhe policinë, siç rekomandohet në pjesën e përgjithshme të këtij raporti.

64. Ekipi i Vlerësimit i përmbahet qëndrimit se për të tri sektorët - gjyqtarët, prokurorët dhe policia - duhet të miratohen rregulla dhe procedura të qarta në mënyrë që të përcaktohen kushtet për ushtrimin e aktiviteteve të jashtme.

65. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi x nuk është zbatuar.

Rekomandimi xi

66. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që (i) të krijohen marrëdhënie formale mes ZPD-së dhe Prokurorit të Shtetit me qëllim që të përmirësohen hetimet disiplinore dhe penale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të bëhet transparent bashkëpunimi i tyre i ndërsjellë; dhe (ii) të rregullohet dhe qartësohet korniza institucionale dhe procedurat për hetimet disiplinore/penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke përfshirë edhe caktimin e afatit të procedurave disiplinore me qëllim të shmangies së vonësive të panevojshme dhe të mbivendosjes së procedurave (paragrafi 187).*

67. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacione në lidhje me përmirësimin e mbajtjes së historisë së rasteve penale dhe disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ministria e Drejtësisë ka raportuar që në muajin tetor 2014, është themeluar grupi punues për ta përgatitur një dokument strategjik që do t'i adresojë pyetjet kryesore në lidhje me të ardhmen e Zyrës së Këshillit Disiplinor.

68. Ekipi i Vlerësimit nxit që:

- të fuqizohet sistemi disiplinor kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe të përmirësohet ndërveprimi në mes të Zyrës së Këshillit Disiplinor dhe Prokurorit të Shtetit;
- të sigurohet që KGJK dhe KPK të zhvillojnë kapacitete për t'u marrë në mënyrë efektive me masat disiplinore për të gjitha gjykatat dhe zyrat e prokurorëve;
- të ofrohet mbajtje efektive e historisë të hetimeve disiplinore dhe penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve me prapavijë analitike (analizë të prirjeve dhe pengesave për hetime efikase disiplinore dhe penale) si dhe historik që duhet të përditësohet periodikisht, në baza 6-mujore.

69. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xi nuk është zbatuar.

Rekomandimi xii

70. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të qartësohet ndërveprimi në mes të AKK-së dhe prokurorit, si dhe gjyqtarëve në procedurat për kundërvajtje dhe vepra penale përmes procedurave standarde të operimit mbi konfliktin e interesit, duke pasur parasysh Kodin e ri Penal (paragrafi 188).*

71. Autoritetet e Kosovës kanë ofruar informacion se disa hapa konkrete janë ndërmarrë me qëllim të përfundimit të bashkëpunimit në mes të AKK-së, prokurorëve dhe gjykatave në lidhje me procedimin e konfliktit të interesit dhe deklarimin e pasurive si vepra penale. Më konkretisht, siç përmendet në paragrafin 19 më lart, një dokument bashkëpunimi është nënshkruar me 26 maj 2014 në mes të Krerëve të Prokurorisë, Policisë dhe AKK-së pas së cilit Kryeprokurori ka nxjerrë një vendim me 30 qershor 2014 sipas të cilit për çdo rast të prezantuar nga AKK do të bëhet një konsultim paraprak në mes të prokurorëve të rastit dhe zyrtarëve të AKK-së. Po ashtu me 23 tetor 2014, AKK, autoritetet Prokuroriale dhe Gjyqësore janë takuar për të diskutuar përcjelljen e rasteve të deklarimit të rremë të pasurive.

72. Megjithatë, siç është përmendur më herët, duhet të bëhet më shumë në mënyrë që kriminalizimi i konfliktit të interesit dhe deklarimi i rremë i pasurive të rezultojë në hetim, ndjekje penale dhe vendim gjyqësor të këtyre veprave penale.

73. Ekipi i Vlerësimit përshëndet përpjekjet e bëra nga institucionet kompetente të Kosovës në periudhën raportuese për të bashkërenduar ndërveprimin e tyre në mënyrë që të procedojnë në mënyrë më efikase dhe të rreptë konfliktin e interesit dhe deklarimin e rrejshëm të pasurive. Në veçanti, dokumenti i nënshkruar me 26 maj 2014 në mes të Krerëve të Prokurorisë, Policisë dhe AKK-së mund të konsiderohet në vend të "procedurave standarde të operimit" të rekomanduara. Megjithatë, nuk ka pasur informacion të mëtutjeshëm përcjellës në vazhdim të takimit të mbajtur në tetor 2014, përfshirë gjykatat, dhe nëse gjykatat janë po ashtu pjesë e mekanizmit të ri të formalizuar të bashkëpunimit. Përveç kësaj, ndryshimet në Ligjin mbi Konfliktin e Interesit janë ende pezull para Kuvendit të Kosovës dhe harmonizimi i tij me Kodin Penal nuk është kompletuar deri më tani. Prandaj, Ekipi i Vlerësimit sugjeron edhe njëherë se sapa të miratohet Ligji mbi Konfliktin e Interesit një dokument që parasheh një platformë për bashkëpunim në mes të AKK-së, Policisë dhe Prokurorisë të zgjerohet për të përfshirë autoritetet gjyqësore pa asnjë vonesë dhe që të vendoset dhe të mirëmbahet rregullisht shënimi i të dhënave të hetimeve, ndjekjes penale dhe vendimeve gjyqësore.

74. Ekipi i Vlerësimit pret se konflikti dhe mosmarrëveshjet në mes të AKK dhe Prokurorit në lidhje me hetimin e konfliktit të interesit dhe deklarimin e rremë të pasurive do të zgjidhen në praktikë pasi që të jetë nënshkruar formalizimi i tyre. Ai e konsideron të rëndësishë së madhe që kjo marrëveshje bashkëpunimi në mes të AKK-së dhe Prokurorit të shtrihet edhe tek gjykatat në mënyrë që të kompletohet mbajtja e shënimeve të hetimeve, ndjekjeve penale dhe vendimeve gjyqësore.

75. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xii është zbatuar pjesërisht.

2.2. Prokurorët

76. Me vendimin e datës 8 korrik 2014³, Gjykata Kushtetuese ka shpallur unanimisht të pavlefshme dy vendime të ankimuar të KPK mbi nominimin e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit dhe ka urdhëruar KPK ta përsëritë procedurën e zgjedhjes. Gjykata ka vlerësuar se procedura e zgjedhjes e udhëhequr nga KPK përbën shkelje të së drejtës për procedurë të drejtë dhe të paanshme, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

Rekomandimet xiii, xiv dhe xv

77. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që:*

KGJK-ja dhe KPK-ja të miratojnë procedura të qarta dhe gjithëpërfshirëse të verifikimit (i) duke u bazuar në kritere objektive dhe transparente; (ii) të ditura paraprakisht dhe (iii) që çdo vendim të arsyetohet në mënyrë të duhur (paragrafi 209);

KPK-ja të miratojë udhëzues lidhur me miratimin e angazhimeve të jashtëzakonshme të jashtme të prokurorëve, dhe të përcaktohet kufiri i pagesës për angazhime të tilla (paragrafi 220); dhe

të krijohet marrëdhënie formale mes ZPD-së dhe KPK-së (duke marrë parasysh edhe marrëdhënien në mes kryeprokurorëve dhe ZPD-së) me qëllim të përmirësimit të hetimeve disiplinore dhe penale të prokurorëve, duke u bazuar në parimet e transparencës, duke mbajtur njëkohësisht fshehtësinë e hetimeve dhe duke i mbrojtur të dhënat personale (paragrafi 239).

78. Autoritetet e Kosovës kanë informuar se një vlerësim prokurorial dhe një procedurë e verifikimit është përcaktuar sipas "Rregullores nr. 02/2013 mbi Rekrutimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve" të lëshuar nga Zyra e KPK-së. Sipas Rregullores, procedura e verifikimit kryhet nga Zyra e KPK për Vlerësimin dhe Verifikimin e Prokurorëve dhe përbëhet nga një verifikim personal dhe profesional të dokumenteve të dorëzuara nga kandidatët për pozitën e prokurorit të cilët janë ftuar në intervistë. Kjo përfshin verifikimin e njohurive dhe aftësive, performancës, kualifikimit dhe historisë kriminale, si dhe kontrollimin e sigurisë. Autoritetet po ashtu kanë raportuar përmirësimet në menaxhimin e statistikave dhe koordinimin në punën e KPK-së; megjithatë, parandalimi i korrupsionit brenda shërbimit të prokurorisë ende duhet të sjellë rezultate të prekshme.

79. Ekipi i Vlerësimit përsërit se procedurat e verifikimit dhe kriteri i përshtatshmërisë, përfshirë programin për arsim ligjor fillestar, i cili përfshin një theks të fuqishëm mbi etikën gjyqësore duhet të merret parasysh plotësisht nga kandidatët për pozitën për gjyqtarë dhe prokurorë. Përderisa procedurat për verifikimin e prokurorëve ekzistojnë, është e paqartë nëse Rregullorja e re 2013 e ka zëvendësuar apo jo Rregulloren e vjetër 2012 mbi të njëjtën çështje, e cila parashihte

³ Rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14; shih http://www.gjk-ks.org/repository/docs/KI99-14_SHO.pdf

Si rezultat i shpalljes përkatëse të KPK për aplikim për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit në mars 2014, prej 9 kandidatëve të paraqitur janë përzgjedhur fillimisht 6 kandidatë. Pas pranimit të ankesave dhe pas procesit të rishikimit, ky numër ka shkuar në 8 kandidatë të kualifikuar për procedura të mëtejshme të përzgjedhjes. Tre kandidatët e parë të cilët kanë rezultuar të kualifikuar pas procesit të intervistimit dhe rezultateve përfundimtare të vlerësimit të bëra publike kanë pasur të drejtë të vazhdojnë procedurën e mëtejshme të përzgjedhjes. Me 6 qershor 2014, KPK i përbërë nga 7 anëtarë ka zgjedhur me votim të fshehtë të nominuarit për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit (mandati i tij/saj është 7 vite pa mundësi të riemërimit). Dy kandidatë (i listuari i pestë në listën e përzgjedhjes dhe njëri nga tre kandidatët e vlerësuar më lart i cili ka marrë 3 vota në favor të tij) kanë parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për parregullsitë në procedurën e përzgjedhjes, përfshirë ndër të tjera mungesën e shfaqjen e paanësisë së nevojshme (një anëtar i KPK i cili ka marrë pjesë në votimin e Kryeprokurorit të Shtetit ka qenë një nga 8 kandidatët në listën e përzgjedhur për pozitën e njëjtë).

procedura të verifikimit për gjyqtarë dhe prokurorë. Përveç verifikimit në procesin e riemërimit për gjyqtarë, që është bërë nga Komisioni i përkohshëm i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGjP), nuk duket se ekziston ndonjë procedurë tjetër e verifikimit për procesin e emërimit të gjyqtarëve pas emërimit të përgjithshëm i cili ka ndodhur në periudhën nga viti 2008 deri në 2012.

80. Përveç kësaj, angazhimet e jashtme me pagesë të Prokurorëve kërkojnë, njësoj si gjyqtarët, një rregullore të rreptë. Me qëllimin e zbatimit të rekomandimit, zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), KPK dhe Kryeprokurori duhet të iniciojnë një nxjerrje të rregullores në mënyrë të njëjtë si Projektkodi i Etikës për Gjyqtarë, apo mundësisht të përfshihet një klauzolë mbi punësimin e jashtëm në ligj.

81. KPK-ja duhet të qartësojë rregullat e zbatueshme në lidhje me verifikimin e prokurorëve, bie fjala, nëse Rregullorja e vitit 2012 është ende e vlefshme apo jo sepse kjo e fundit nuk është shfuqizuar në mënyrë të qartë, edhe pse autoritetet kanë informuar të kundërtën. Kjo për arsye se Rregullorja e vitit 2013 duket më pak urdhëruese mbi përmbajtjen e verifikimit, dhe nuk përmban elemente thelbësore, bie fjala si zyra e KPK për Vlerësimin dhe Verifikimin i udhëheq procedurat e veta, çka ndodh me dokumentacionin e refuzuar, të drejtën për ankim etj. Të gjitha këto aspekte duhet të përmbahen në detaje ose në vetë Rregulloren ose në ndonjë akt nënligjor të KPK-së dhe i disponueshëm për publikun, dhe jo vetëm për palët e interesuara siç kanë informuar autoritetet.

82. Verifikimi i gjyqtarëve, përveç procesit të përgjithshëm të riemërimit duhet të përfshihet gjithashtu në Rregulloret e KGjK-së, dhe të bazohet në parimet e njëjta si verifikimi i Prokurorëve.

83. Orientimi i njëjtë në lidhje me aktivitetet e jashtme - rregullore e rreptë të punëve të jashtëzakonshme sekondare që është e vlefshme për gjyqtarët duhet po ashtu të parashihet në mënyrë të rreptë me kodin e etikës së Prokurorëve.

84. Ekipi i Vlerësimit pranon se janë bërë disa përmirësime në lidhje me rregulloret mbi verifikimin për prokurorët, por është ende e nevojshme të ndiqet nga afër procesi i ndryshimeve të kodeve të etikës dhe Rregulloreve të tjera të KPK/KGjK. Ai e përsërit nevojën për themelimin e një historiku solid të procedurave disiplinore dhe penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, në bashkëpunim të ngushtë me ZPD dhe ZKD.

85. Në lidhje me themelimin e marrëdhënieve formale në mes të ZPD dhe KPK, autoritetet e Kosovës informojnë se Ligji mbi KPK përcakton në mënyrë formale bashkëpunimin në mes të ZPD dhe Komisioni Disiplinor të KPK-së. Bazuar në këtë ligj, KPK e zbaton këtë bashkëpunim në praktikë.

86. Ekipi i Vlerësimit njeh se komunikimi formal në mes të ZPD-së dhe KPK-së është i paraparë në Ligj. Megjithatë, bashkëpunimi i tillë ende duhet të rezultojë në një mbajtje shënimesh më solide të procedurave disiplinore/penale për pretendimet e korrupsionit të gjyqtarëve apo prokurorëve. Nuk ka dëshmi të funksionimit të këtij bashkëpunimi në praktikë (numri i takimeve të përbashkëta, konkluzioneve dhe rezultateve) dhe këshillohet që autoritetet e Kosovës të ofrojnë sa më shumë informacione relevante që është e mundur në periudhën e ardhshme raportuese në mënyrë që të jetë në gjendje të vlerësojë performancën e këtij bashkëpunimi formal.

87. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimet xiii, xiv dhe xv janë zbatuar pjesërisht.

2.3. Policia

Rekomandimet xvi dhe xvii

88. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që:*

të themelohen kritere objektive dhe transparente për emërimin/shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm të policisë për të siguruar pavarësinë operationale të policisë (paragrafi 254); dhe

të themelohen kritere objektive dhe transparente për emërimin/shkarkimin e zëvendësrejtoreve dhe të zyrtarëve të tjerë të nivelit të lartë në polici (paragrafi 255).

89. Autoritetet e Kosovës kanë informuar se Ligji mbi Policinë Nr. 04/L-076 i datës 2 mars 2012 rregullon, në nenet 37, 38 dhe 39 procedurën dhe kriteret për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësrejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Sipas këtyre rregullave, Komisioni Përzgjedhës (ku marrin pjesë edhe anëtarët e EULEX-it si vëzhgues), i propozon Ministrit të Punëve të Brendshme kandidatët për emërimin në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, përderisa Ministri në një prej mbledhjeve të Qeverisë i propozon Qeverisë kandidatin për këtë pozitë. Qeveria pastaj ia rekomandon Kryeministrit kandidatin për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë, i cili emërohet përfundimisht nga Kryeministri përmes një vendimi formal të nënshkruar Ngjashëm, Ligji ofron rregulla dhe kushte për shkarkimin e zyrtarëve të lartë të policisë.

90. Përveç kësaj, autoritetet e Kosovës argumentojnë se pavarësia operationale e kandidatëve për pozita të larta menaxhuese sigurohet me faktin se ai/ajo duhet të vijë nga strukturat e Policisë (zyrtar policor) që mbajnë grada më të larta policore për së paku 5 vite.

91. Autoritetet e Kosovës konsiderojnë se kriteret e tilla për përzgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve të lartë publik të Policisë janë mjaftueshëm objektive dhe transparente për ta siguruar pavarësinë operationale të policisë.

92. Ekipi i Vlerësimit vëren se rregullimet e reja, në të vërtetë përfshijnë kërkesat e përgjithshme formale dhe objektivitetin minimal në procesin e përzgjedhjes së drejtuesve të policisë. Me fjalë të tjera, Neni 38 i Ligjit mbi Policinë specifikon kushtet e përgjithshme që një kandidat për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë duhet të përmbushë. Megjithatë, procedura ku Ministri i Punëve të Brendshme, Qeveria dhe Kryeministri që kanë secili një rol të ndarë në emërimin/shkarkimin, ndërkohë që janë formalisht pjesë e një strukture të vetme të Qeverisë do të mund të ishte më transparente dhe roli i Komisionit Përzgjedhës do të mund të rritej për ta parandaluar çfarëdo rreziku të ndikimit jo proporcional nga niveli politik. Për momentin, propozimi i Komisionit Përzgjedhës nuk është i detyrueshëm pasi që bëhet nga lista e ngushtë e së paku tre kandidatëve (por mund të jenë më shumë ose më pak); një listë e tillë, pa klasifikime preferenciale (në veçanti kur ka më shumë se tre kandidatë), ka ndikim kryesisht të vogël në zgjedhjen përfundimtare të bërë nga Qeveria. Kur Qeveria i "rekomandon" Kryeministrit emërimin e një kandidati, ky sesion përfshin të tre aktorët politikë të përfshirë – Ministrin e Punëve të Brendshme, Qeverinë dhe Kryeministrin. Sa i përket transparencës së punës së Komisionit Përzgjedhës, deri më tani kjo kufizohet në pjesëmarrjen e zyrtarëve policorë të EULEX-it në cilësinë e vëzhguesve dhe të një anëtarit të shoqërisë civile si anëtar i Komisionit. Prandaj, Ekipi i Vlerësimit ende argumenton se përkundër hapave fillestarë pozitivë drejt bërjes së procedurave të emërimit/shkarkimit më objektive, ekziston një rrezik relativisht i lartë i mbiekspozimit ndaj diskrecionit politik brenda Qeverisë nëse nuk ka mbrojtje shtesë të parandalimit të ndërhyrjes së mundshme.

93. Në mënyrë që të parandalohet një rrezik i tillë, Ekipi i Vlerësimit konsideron se një nivel më i lartë i transparencës dhe objektivitetit duhet të garantohen përgjatë tërë procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të lartë në Policinë e Kosovës. Kjo mundet të arrihet për shembull duke e ndryshuar Udhëzimin Administrativ 12/2012 që të sigurojë që "lista e ngushtë" e kandidatëve të përzgjedhur që dorëzohet nga Komisioni Përzgjedhës tek Ministri i Brendshëm dhe pastaj i përcillet Qeverisë/Kryeministrit duhet të përmbajë klasifikime të qarta preferenciale (zgjedhja e 1-rë, e 2-të, etj.) apo duhet të kufizohet në mënyrë që të zvogëlohet hapësira për vendimmarrje diskrecionale politike në vend të asaj profesionale. Deri më tani, ekziston vetëm detyrimi i klasifikimit të kandidatëve në lidhje me atë se si u përgjigjen pyetjeve përkatëse gjatë intervistës por jo në lidhje me tërë dosjen. Në fund, niveli i duhur i publicitetit të mbledhjeve të Qeverisë ku zhvillohet emërimi/shkarkimi si dhe prezantimi i një "dëgjimi" të kandidatëve për emërim do të mund të parashihej po ashtu si një masë për promovimin e transparencës së shtuar.

94. Vërejtja e njëjtë duhet të aplikohet për emërimin e Zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm të Policisë. Në pajtim me Ligjin dhe Udhëzimin Administrativ të aplikueshëm, Komisioni Përzgjedhës propozon disa kandidatë për dy pozitat tek Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, të cilët pastaj i rekomandohen Ministrit për emërim. Diskrecioni i Drejtorit të Përgjithshëm për të zgjedhur dhe rekomanduar nga lista e dorëzuar nga Komisioni Përzgjedhës duhet të bazohet në klasifikimin e qartë të përcaktuar nga Komisioni dhe bazuar në merita. Sipas rregullit, në të dy situatat lista e Komisionit Përzgjedhës duhet të konsiderohet si e detyrueshme.

95. Ekipi i Vlerësimit vëren se një arsytim më thelbësor i vendimeve mbi emërimin apo largimin e zyrtarëve të lartë policorë si dhe klasifikimi i duhur i bazuar në merita në procedurën e emërimit duhet të bëhet praktikë standarde në mënyrë që vendimet e tilla të jenë të lira nga dyshimet e mundshme mbi korrupsionin dhe të mund të sfidohen përmes një rishikimi të duhur administrativ dhe gjyqësor.

96. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimet xvi dhe xvii janë zbatuar pjesërisht.

Rekomandimet xviii dhe xix

97. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që:*

të miratohen udhëzues për policinë lidhur me miratimin e angazhimeve të jashtëzakonshme të jashtme dhe të themelohet një kufi për pagesën e këtyre angazhimeve (paragrafi 259); dhe

të themelohen kufizimet pas përfundimit të marrëdhënies së punës së policëve prej të gjitha niveleve dhe të bëhen rregullime të duhura për mbikëqyrjen efikase të zbatimit të atyre rregulloreve (paragrafi 262).

98. Autoritetet e Kosovës kanë informuar në lidhje me mundësinë e punësimit të dytë të "rregullt" brenda shërbimit në Policinë e Kosovës, gjë e cila mundësohet në pajtim me detyrat ligjore të jashtme të zyrtarëve të Policisë. Kështu, Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2013 parasheh që zyrtarët e Policisë mund të angazhohen në punësime të jashtme pas orëve të punës në Policinë e Kosovës, bazuar në marrëveshjet e nënshkruara në mes të Policisë dhe organizatave apo institucioneve të tjera që kërkojnë zbatimin e autorizimeve policore por që nuk kufizohen vetëm në rastet si më poshtë: a) kontrollimi i komunikacionit dhe sigurisë së këmbësorëve, b) kontrollimi i masës, c) sigurimi dhe mbrojtja e jetës dhe pronës, d) zbatimin rutinor të ligjit për autoritetet publike.

99. Kur kemi të bëjmë me punësimet e jashtme që nuk përfshijnë ushtrimin e autorizimeve policore, Udhëzimi Administrativ i njëjtë parasheh kritere në mënyrë që ta kufizojë punësimin e tillë në mënyrë që: 1. Punëtorët e Policisë së Kosovës nuk mund të angazhohen në punësime sekondare deri sa të mos e kenë përfunduar periudhën e tyre sprovuese, 2) për punësimin sekondar, punëtorët duhet të demonstrojnë performancë të mirë në ushtrimin e detyrave në Polici, dhe 3) punëtorët e Policisë nuk mund të angazhohen në aktivitete sekondare përderisa janë të pezulluar me apo pa pagesë, dhe në të gjitha rastet kur zyrtari i policisë është nën masa disiplinore për shkelje të rënda disiplinore të parapara me Ligjin mbi Policinë. Procedura për rishikimin e kërkesave, vendimmarrja në dhe jashtë detyrës dhe punësimi dytësor janë rregulluar po ashtu, sikurse edhe procedurat për anulimin e vendimeve në rast se personeli i policisë ka shkelur ligjin, aktet nën-ligjore të Policisë përderisa ai/ajo ka qenë i/e punësuar jashtë detyrës apo në punësim sekondar.

100. Ekipi i vlerësimit konsideron se rregullimi i punësimit të jashtëm në Polici në këtë mënyrë përfaqëson një qasje të drejtë dhe do të mund të ishte një shembull i mirë për të ndihmuar në zgjidhjen e problemit të njëjtë edhe për gjyqtarët dhe prokurorët. Pyetja e kufizimit të pagave për punësimin sekondar, natyra përjashtuese e punësimit të tillë dhe praktika e dhënies së autorizimit duhet të verifikohet më tutje. Është e një rëndësie të madhe që punësimet e tilla të mbesin vetëm raste përjashtuese e jo rregulla dhe të kontrollohen në mënyrë të rreptë. Po ashtu nuk dihet se cili autoritet i verifikon dhe i sanksionon shkeljet e mundshme të rregullave të konfliktit të interesit, siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2012.

101. Sa i përket kufizimeve pas marrëdhënies së punës (rekomandimi xix), autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacion relevant.

102. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xviii është zbatuar në mënyrë të kënaqshme, ndërsa rekomandimi xix mbetet i pazbatuar.

Rekomandimi xx

103. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të fuqizohen kapacitetet njerëzore të organeve përkatëse disiplinore dhe të hetimeve të brendshme të policisë, dhe të mbahen regjistra të besueshëm me të dhëna rreth veprimeve disiplinore dhe të tjera që ndërmerren lidhur me policët (paragrafi 276).*

104. Autoritetet e Kosovës njoftojnë se Policia e Kosovës ka kapacitete të mjaftueshme me burime njerëzore për hetime të brendshme. Më konkretisht, mekanizmat e brendshëm në dispozicion për të siguruar disiplina në Polici siç janë Drejtoria për Standarde Profesionale, Komisioni i Brendshëm Disiplinor për Ankesa dhe Shpërblime janë plotësuar me staf dhe janë funksionale. Megjithatë, ata njoftojnë se disa prej pozitive kyçe menaxheriale në strukturat disiplinore janë plotësuar mbi baza të përkohshme me të emëruar "ushtrues detyre" apo "të përkohshëm" dhe se disa pozita nuk janë të plotësuara në pajtim me kërkesat profesionale dhe përvojën, siç parashihet me Rregulloren mbi Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të posteve. Arsyeja për këtë është mungesa e sistemit të gradimit në Policinë e Kosovës që nga viti 2007. Në të vërtetë, një numër i pozitive janë plotësuar me personelin e policisë të gradave më të ulëta që janë emëruar si "ushtrues detyre". Sipas të dhënave më të reja në dispozicion, janë 57 pozita "ushtrues detyre" dhe 324 vende të lira në Policinë e Kosovës.

105. Ekipi i Vlerësimit mirëpret përfundimin e kapaciteteve njerëzore në organet relevante hetuese dhe disiplinore të Policisë së Kosovës. Ai megjithatë vëren se gjatë vitit 2013, numri i përgjithshëm i pozitive të lira ka qenë 17 brenda Mekanizmave të Brendshëm Disiplinorë për Standarde Profesionale dhe vetëm 4 janë plotësuar në vitin 2014, përderisa dy mbeten në baza të "ushtruesit të detyrës".

106. Në lidhje me të dhënat statistikore, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), si një mekanizëm i jashtëm i pavarur përgjegjës për hetimet administrative kundër nivelit drejtues me gradën kolonel dhe pozitive të larta ekzekutive, si dhe kundër të gjithë personelit policor për dyshime të përfshirjes së tyre në vepra penale mban bazën e vet të të dhënave. IPJ koordinon aktivitetet e veta me mekanizmat e brendshëm të Policisë së Kosovës (Drejtorinë për Standarde Profesionale dhe Komisionin e Brendshëm Disiplinor për Ankesa dhe Shpërblime). Këta baza të të dhënave si dhe raportet e Inspektoratit Policor të Kosovës janë të publikuara në një formë të strukturuar mirë. Po ashtu, çdo ankesë është regjistruar në bazën e të dhënave për të pasur një numër të saktë të ankesave të pranuar. Sa i përket rasteve penale të cilat i përcillen nga IPK-ja shërbimeve kompetente të ndjekjes penale, në mënyrë që këtyre rasteve t'iu jepet përparësi kur ato përfshijnë persona zyrtarë, IPK-ja ndërmerr hapa të nevojshëm. Me Kryeprokurorin e Shtetit është dakorduar të emërojë në çdo regjion një prokuror special që do të merret vetëm me rastet e IPK-së. Në rast të vendimeve përfundimtare gjyqësore kundër zyrtarëve të policisë, IPK-ja informohet së pari nga prokurori special apo gjyqtari kompetent, dhe e transmeton më tutje këtë informacion tek Policia e Kosovës në rast se janë të nevojshme masa të mëtutjeshme disiplinore. Për çdo epilog gjyqësor pranohet një njoftim nga gjykata kompetente. Megjithatë, informacioni i kompletuar mbi statusin e rasteve apo vendimeve që merren nga Prokurorët apo Gjyqtarët do të vihen në dispozicion vetëm në fund të vitit 2014.

107. Ekipi i Vlerësimit vëren se përveç mirëmbajtjes së përmirësuar të bazës së të dhënave disiplinore/penale brenda Inspektoratit të Policisë së Kosovës, dhe përpjekjet në mënyrë që të merren më shumë informacione dhe rezultate nga Prokurorit Gjykatat relevante, ende duhet të vendoset mbajtja solide e shënimeve të hetimit, ndjekjes penale dhe rezultateve të procedurave penale. Përveç kësaj, do të jetë me rëndësi që të dihet se cila është historia e zbatimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012 e lëshuar nga Policia e Kosovës mbi Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore.

108. Ekipi i Vlerësimit nënvizon se zbatimi i masave disiplinore mbetet ende një sfidë dhe hetimet penale duhet të adresohen më mirë. Ende mbetet për t'u verifikuar nëse organet relevante policore të hetimeve disiplinore dhe të brendshme janë të (apo janë në proces e sipër) pajisur me staf të duhur në mënyrë që të kenë mundësi të zhvillojnë ose hetimet efikase të brendshme penale për akuzat e korrupsionit kundër zyrtarëve të policisë ose të zbatojnë procedura disiplinore.

109. Bazuar në mënyrën e zhvilluar dhe strukturuar mirë të prezantimit të statistikave në lidhje me hetimet disiplinore dhe penale kundër zyrtarëve policorë që përgatiten në baza vjetore nga Inspektorati Policor i Kosovës, do të ishte e një rëndësie të jashtëzakonshme të zhvillohet metodologjia për prezantimin e "historisë" së hetimeve të suksesshme. Në këtë drejtim, emërimi i pikave regjionale të kontaktit në prokurori që merren vetëm me raste të IPK-së është i mirëseardhur dhe mund të ndihmojë të përcaktohet historiku. Përveç kësaj, prezantimi i vetëm

statistikor duhet të përcillet me një vlerësim dhe shpjegim më analitik mbi prirjet e sanksioneve penale si dhe mbi hetimet penale kundër zyrtarëve policorë në të gjitha nivelet.

110. Historiku i metodologjisë dhe formave të prezantimit do të mund të ishte një mjet i dobishëm për të arritur tek konkluzionet e duhura dhe për ta përmirësuar efikasitetin e masave disiplinore.

111. Prandaj, Ekipi i Vlerësimit thekson nevojën e zhvillimit të metodologjisë së "historikut" të bazuar në ekzaminime analitike dhe që synon ofrimin e rezultateve konkrete për procedimin e mëtutjeshëm të masave disiplinore apo hetimeve penale. Pas ndërmarrjes së masave të duhura në vitin 2014, raporti vjetor duhet të përfshijë informacione të kompletuara mbi sanksionet/vendimet e shqiptuara kundër punëtorëve të Policisë së Kosovës që kanë qenë nën hetim, edhe nga Departamenti për Standarde Profesionale për rastet disiplinore, edhe nga Prokuroria apo Gjykatat për vepra penale. Nëse raporti statistikor përcillet me ndonjë analizë mbi prirjet në fjalë dhe prezantohet si ndërtim solid i historikut, statistikave e tilla mund të përfaqësojnë një hap konkret në drejtim të zbatimit të plotë të rekomandimit xx.

112. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xx është zbatuar pjesërisht.

2.4. Administrata Publike

113. Në kuadër të thjeshtimit të procedurave administrative, Ligji i ri Nr. 04/L-202 Për Sistemin e Lejeve dhe Licencave synon të vendosë parime dhe rregulla për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes nëpërmjet zvogëlimit të barrierave administrative.

114. Në lidhje me kontrollin e administratës publike, Projektligji i ri Nr. 04/L-236 Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit ka qenë në proces në Kuvend që nga muaji nëntor i vitit 2013. Gjatë vizitës në terren, ai ka kaluar në leximin e dytë në seancën plenare të datës 17 prill 2014. Për shkak të mungesës së konsensusit mbi disa aspekte të pavarësisë së organizimit dhe funksionimit të këtij institucioni, prej 29 amendamenteve 5 nuk janë miratuar nga Kuvendi. Ekipi i Vlerësimit iu bën thirrje autoriteteve të Kosovës të marrin parasysh standardet relevante ndërkombëtare dhe praktikat e mira dhe t'i japin prioritet finalizimit të shpejtë të këtij procesi.

Rekomandimi xxi

115. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që (i) të rritet transparencja në administratën publike (përfshirë "e-qeverisjen") përmes zbatimit të politikës më proaktive, fuqizimit të duhur të kornizave rregullative dhe institucionale, si dhe përmes monitorimit dhe raportimit të vazhdueshëm; dhe (ii) të ndërmerren hapa të mëtejme për ta zbatuar në mënyrë adekuate qasjen në dokumente publike si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal (paragrafi 288).*

116. Ekipi i Vlerësimit rikujton nevojën e përmirësimit të qartë të masave të transparencës në institucionet e ndryshme të administratës publike përkundër përpjekjeve të ndryshme të marra deri më tani. Vonesat në lëshimin dhe/apo publikimin në faqet përkatëse të internetit të dokumenteve që duhet të jenë publike apo mungesa e publikimeve të tyre, përfshirë raportet e auditimit, shpenzimet, raportet vjetore, buxhetet, aktet nënligjore etj., nuk janë adresuar si duhet. Ekipi i Vlerësimit beson se mungesa e transparencës mund të jetë faktor kontribues për vendime arbitrare, jo të drejta dhe abuzim të kompetencave diskrecionare në vendimmarrje. Përveç kësaj, qasja në informacionin publik është ende në hapa të hershëm të zbatimit, përderisa mungesa e vetëdijesimit dhe përdorimi efektiv i kësaj të drejte nga qytetarët ka si ndikim të menjëhershëm një mungesë të gjerë të besimit në institucionet publike si dhe një përceptim shumë të lartë të korrupsionit. Udhëzimet dhe mjetet zbatuese, krijimi i plotë i infrastrukturës institucionale, domosdoshmëria për të prodhuar dhe menaxhuar statistika të përpunuara mirë, zvogëlimi i mëtutjeshëm i hezitimit për të raportuar progresin tek organi koordinues i Qeverisë nga institucionet e tjera, sistemi ende i dobët ekzistues i raportimit, paqartësitë në lidhje me listat e dokumenteve të klasifikuara dhe/apo udhëzimet administrative, dhe mungesa e vetëdijesimit dhe njohurisë të mjaftueshme të publikut e shoqëruar nga përdorimi relativisht i ulët në praktikë i kësaj të drejte mbeten disa prej problemeve të identifikuara.

117. Autoritetet e Kosovës informojnë se Ministria e Administratës Publike është aktualisht duke zbatuar një Sistem të Menaxhimit Elektronik të Dokumenteve" (SMD) me qëllim të mundësisë të regjistrimit, aprovimit, klasifikimit, vlerësimit, mbajtjes, përdorimit dhe publikimit të dokumenteve deri në dorëzimin final të tyre në arkivën elektronike (e-arkiva). Ky sistem përcjell dhe mbikëqyr afatet për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, dhe zyrtarit përgjegjës për zbatimin e tyre. Ai po ashtu ofron edhe aprovim hierarkik të dokumenteve elektronike sipas skemës organizative të institucionit përkatës. Sistemi ka një modul të veçantë që lejon kërkesën online për qasje në dokumente zyrtare dhe përgjigje korresponduese online.

118. Sistemi SMD është në fazat përfundimtare dhe është duke u bërë një klasifikim i brendshëm. Ai do të operojë në të dy nivelet: qendrore dhe lokale. Procesi i klasifikimit të dokumenteve nuk është përfunduar ende. Është caktuar një komision për të përgatitur fushat dhe listat e dokumenteve të cilat nuk do t'ju nënshtrohen qasjes në informacione.

119. Një projektligj i ri mbi procedurat administrative është duke u hartuar. Instrumentet e "one-stop-shop" dhe aprovimi i heshtur i akteve administrative do të përfshihen në këtë projektligj.

120. Përveç kësaj, Qeveria ka nxjerrë kohët e fundit Raportin vjetor 2013 në lidhje me zbatimin e legjislacionit mbi qasjen në dokumentet publike (përfshirë aktet nënligjore, në veçanti Rregulloren zbatuese 04/2012). Raporti nënvizon disa vështirësi dhe pengesa apo refuzime në zbatimin e së drejtës për qasje në dokumentet publike pa ndonjë vendim përkatës mbi klasifikimin ose vendim për refuzimin e kërkesës për qasje në dokumente publike. Ndërkohë që statistikave e ofruara në raport tregojnë një rritje të kërkesave për qasje në dokumente publike deri në 32.8%; megjithatë përfundimisht të ngjashme vërehen në lidhje me dhënien e qasjes dhe një përmirësim i lehtë në lidhje me

shkallën e refuzimeve. Por mungesa e përgjigjeve është rritur. 48% e qytetarëve, 37% e gazetarëve, 6.9% e operatorëve ekonomikë dhe 6.9% e shoqërisë civile kanë qenë autorë të kërkesave gjatë vitit 2013. Ndërkohë që 79% e kërkesave të adresuara në Qeveri dhe njësitet e varura prej saj kanë të bëjnë me buxhetin dhe shpenzimet dhe janë të adresuara nga gazetarët në rreth 85.5% të rasteve (kjo është 29.6% në nivel komunal), megjithatë në institucionet e pavarura rreth gjysma e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet, raportet apo dokumentet (dhe gazetarët përfaqësojnë vetëm 31.8% të totalit). Rreth 16 institucione të ndryshme nuk raportojnë mbi këtë çështje tek njësia përkatëse koordinuese në Qeveri. Raporti i lartpërmendur përmban po ashtu rekomandime për përmirësimin e mëtutjeshëm të bazuar në vështirësitë e deritashme dhe mangesitë e zbatimit⁴.

121. Ekipi i Vlerësimit merr shënim informacionin e ofruar dhe mirëpret përpjekjet e fundit të bëra nga autoritetet e Kosovës. Megjithatë, në mungesë të informacionit më konkret mbi modalitetet e zbatimit dhe nivelin e mbulimit të tyre nëpër institucionet publike të Kosovës, Ekipi i Vlerësimit nuk është në pozitë të vlerësojë dhe komentojë mbi progresin e arritur në lidhje me aspektet e tjera të rëndësishme të rekomandimit.

122. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxi është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xxii

123. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që (i) të zbatohen rregulla të njëtrajtshme për punësim dhe avancim transparent dhe të paanshëm të nëpunësve civilë, ndër të tjera, përmes njoftimeve të duhura për pozitat e lira, konkurrencës së drejtë mes kandidatëve dhe shmangies së konflikteve të interesit; (ii) të shtohet mbikëqyrja dhe monitorimi i procedurave të përzgjedhjes dhe avancimit të zyrtarëve publikë; dhe (iii) të themelohen procedura të duhura verifikuese për kontrollimin e të dhënave dhe të integritetit të kandidatëve për pozitat në administratën publike (paragrafi 304).*

124. Ekipi i Vlerësimit rikujton nevojën për të adresuar aspektet e ndryshme të këtij rekomandimi të cilat do të kishin një ndikim të qartë mbi përmirësimin e kredibilitetit të sistemit të rekrutimit në administratën publike. Së pari, masat për t'u ndërmarrë për rekrutim të bazuar në meritë në shërbimin civil përfshijnë së pari hapat e prekshëm për të siguruar shpallje të detyrueshme dhe paraprake të vendeve të lira të punës; dhe kryerjen e procedurave të drejta dhe objektive të testimit, përfshirë funksionimin e vërtetë dhe të paanshëm të komisioneve të përzgjedhjes dhe transparencë të duhur të procesit. Përpjekje konkrete nevojiten në mënyrë që të zbatohen procedurat ekzistuese dhe të sigurohet publiciteti i tyre i rregullt si dhe transparenca e procesit në mënyrë që të zvogëlohet fushëveprimi i diskrecionit dhe ekzistencës së dyshuar të nepotizmit aktual, favorizimit dhe mbikëqyrjes politike. Praktika e mbajtjes së "ushtruesve të detyrës si shërbyes civilë" në pozita të lira për periudha më të gjata se sa kohëzgjatja maksimale prej tre muajve duhet të ndërpritet. Së dyti, përfshirja dhe/ose ngritja e mbikëqyrjes dhe monitorimit të rregullt dhe të duhur të procedurave të përzgjedhjes dhe promovimit do të kishte vlerë të shtuar. Së fundi, autoritetet duhet të punojnë në prezantimin e procedurave të duhura të verifikimit në mënyrë që integriteti i kandidatëve dhe verifikimi i ekzistencës së shënimeve të së kaluarës eventuale kriminale të kandidatëve të mund të kontrollohet, si dhe e kaluara e mundshme penale, hetimet në vazhdim e sipër apo sanksionet disiplinore ose procedura pezull. Deri më tani, nuk ekzistojnë kërkesa dhe procedura sistematike në kornizën aktuale ligjore (Ligji për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149 dhe Rregullorja Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil) në veçanti për pozita të larta⁵. Edhe pse autoritetet e Kosovës i referohen Nenit 25, paragrafit 3 të Rregullorës Nr. 02/2010 që i referohet refuzimit të mundshëm të aplikimeve të bëra nga kandidatët me histori kriminale, asnjë informacion tjetër praktik nuk është ofruar. Përveç kësaj, kjo dispozitë

⁴ Shih për informacion të mëtutjeshëm në:

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raporti_Gjitheperفشires_Final_Shqip_7_Prill.pdf

⁵ Në momentin e fundit, autoritetet e Kosovës kanë bërë të ditur për Ekipin e Vlerësimit informacionin në vijim dhe kanë argumentuar se rekrutimi në shërbimin civil zhvillohet mbi bazën e një plani vjetor të rekrutimit që i dorëzohet MAP-it. DCSA mbikëqyrë dhe monitoron zbatimin e planit të rekrutimit përmes një mekanizmi të dhënies së autorizimit për publikimin e konkursit. Ata më tutje kanë sqaruar se rekrutimet bëhen në pajtim të plotë të procedurave ligjore (avancimeve të brendshme dhe procedurave të jashtme) përmes publikimit në gazeta ditore dhe webfaqe të institucioneve. Përzgjedhja bëhet nga një komision i pavarur përmes konkursit (verbal dhe me shkrim) dhe mbi baza të mënyrave transparente të publikimit. Së fundi, autoritetet e Kosovës argumentojnë se kandidatët kanë të drejtë të ankohen kundër hapit/vendimit të rekrutimit tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shoqërisë Civile nëse konsiderojnë se është bërë një shkelje.

Duke marrë shënim informacionin e përgjithshëm të pranuar më herët, Ekipi i Vlerësimit ka pritur të pranojë në kohë më shumë informacione konkrete dhe të sakta mbi masat e ndërmarrë për të adresuar aspektet e ndryshme të rekomandimit.

nuk i adreson aspektet e tjera që ndërlidhen me kontrollet e integritetit dhe procedurat e verifikimit.

125. Sipas autoriteteve të Kosovës gjatë periudhës nga qershori deri në gusht të vitit 2014, institucionet qendrore dhe lokale kanë paraqitur 209 kërkesa (që korrespondojnë me 345 pozita) të cilat janë rishikuar në raport me shpalljet e jashtme dhe të brendshme të punësimit për plotësimin e vendeve të punës në kuadër të zbatimit të politikave dhe legjislacionit të shoqërisë civile si dhe mbikqyrjen e procedurave të punësimit.

126. Ligji i Shërbimit Civil është aktualisht në proces të amendamentimit. Janë propozuar katër hapa për punësimin dhe avancimin e shërbyesve civilë: nga brenda institucionit, nga një institucion në tjetrin, përmes skemës së avancimit, dhe së fundi duke përdorur punësime të jashtme dhe të hapura. Çështjet që lidhen me statusin e shërbyesve civilë, studentët dhe qartësimet mbi masat disiplinore janë disa nga shembujt e tjerë të ndryshimeve të propozuara. Janë planifikuar të bëhen edhe disa amendamente në Ligjin për Pagat.

127. Në përgjithësi, ka vështirësi në lidhje me zbatimin e të dy ligjeve. Klasifikimi i pozitave në shërbimin civil nuk është finalizuar ende. Një komision i përbashkët i MAP-MF është në krye të këtij procesi dhe deri më tani ka rishikuar rreth 75% të propozimeve të institucioneve në pajtim me Rregullorën Nr. 05/2012 mbi Klasifikimin e Pozitave të Punës në Shërbimin Civil. Disa akte nënligjore ende mund të mos aplikohen për shkak të këtij procesi në vazhdim. Një iniciativë e përkrahur nga UNDP synon amendamentimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Shtetërore. Amendamentimet e planifikuara në Ligjin mbi Pagat e Shërbyesve Civilë, do të vendosin, në mes tjerash, rregulla mbi pagat e kategorive të zyrtarëve të cilët nuk janë të përfshirë në legjislacionin për shërbyesit civilë (arsimi, shëndetësia, doganat, policia, etj.) pasi që më shumë se 50% e këtyre kategorive nuk janë rregulluar në mënyrë të qartë. Një projekt i Sistemit të Menaxhimit Informativ të Burimeve Njerëzore i mbështetur nga Banka Botërore synon të krijojë një sistem elektronik për shërbimin civil. Të gjitha modulet relevante të SMIBNj janë zhvilluar në pajtim me kërkesat e projektit, përfshirë lansimin e pilot fazës të aplikimit si dhe pilotimit në mjedis të vërtetë në zyret e Ministrisë së Administratës Publike.

128. Sipas burimeve publike në dispozicion duket se Deklarata e politikave prioritare afatmesme është miratuar nga Qeveria në prill të viti 2013 (vendimi 02/123 i datës 5 prill 2013). Përveç amendamenteve legjislative, ky dokument kërkon të fokusohet në reformat mbi përforcimin e legjislacionit dhe reforma substanciale, dhe të përmirësojë kushtet e punës në administratë (faqe 18). Përveç kësaj, krijimi i një shërbimi civil jo politik, profesional, meritokrat dhe të menaxhuar mirë është një prej prioriteteve në lidhje me administratën publike. Raporti mbi situatën e shërbimit civil në Kosovë është aprovuar nga Qeveria me 26 qershor 2013 (vendimi 02/136)⁶. Përveç kësaj, përmes vendimit Nr. 11/141 i datës 26.07.2013, Qeveria ka rishikuar organizimin dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Reformën e Administratës Publike. Raporti mbi zbatimin e këtij Plani të Veprimit është miratuar nga Qeveria me 5 nëntor 2013 (vendimi nr. 02/155). Megjithatë, Ekipi i Vlerësimit nuk ka arritur ta marrë një kopje të asnjë prej dokumenteve të lartpërmendura as nga burimet në dispozicion publik, as nga autoritetet.

129. Ekipi i Vlerësimit do ta çmonte pranimin e informacioneve të mëtutjeshme dhe më konkrete, përfshirë aspektet praktike të zbatimit, në lidhje me këtë rekomandim. Deri më tani, informacioni i mbledhur është i kufizuar në deklaratat apo të dhënat e kufizuara të ofruara si dhe në disa referime pa ndonjë informacion më të thelluar mbi masat e zbatimit.

130. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxii nuk është zbatuar.

Rekomandimi xxiii

131. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që (i) të miratohet kodi i etikës për nëpunësit civilë sa më shpejt që është e mundur; (ii) të shqyrtohet mundësia e shtrirjes së zbatimit të tij për kategoritë e pambuluara të zyrtarëve në administratën publike; dhe (iii) të rritet njohuria e të gjitha niveleve të administratës publike rreth standardeve të etikës profesionale (ndër të tjera përmes trajnimeve, udhëzimeve dhe këshillave të rregullta) (paragrafi 308).*

⁶ Autoritetet kanë informuar se projekt raporti mbi situatën e shërbimit civil në Kosovë për vitin 2013 është në proces të miratimit.

132. Autoritetet e Kosovës informojnë se në vitin 2011, ZQM ka përgatitur, publikuar dhe shpërndarë Doracakun mbi Etikën dhe Transparencën në Administratën Publike në të gjitha institucionet relevante. Doracaku është një përmbledhje e shkurtër e asaj se çka është etika dhe transparenca në administratën publike. Ai përmban po ashtu një përmbledhje të dokumenteve ndërkombëtare e kombëtare në të cilat përfshihen apo përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e administratës publike gjegjësisht, shërbyesve civilë, përfshirë ofrimin e shërbimeve publike dhe kualitetit të tyre.

133. Në fund të vitit 2013, projekt Kodi i Etikës në Administratën Publike është proceduar për aprovim nga Qeveria por është tërhequr për plotësime të mëtutjeshme.

134. Ekipi i Vlerësimit vëren se informacioni në lidhje me Doracakun mbi Etikën dhe Transparencën në Administratën Publike u referohet zhvillimeve të cilat kanë ndodhur para miratimit të Raportit të Vlerësimit dhe nuk i janë vënë në dijeni më herët Ekipit të Vlerësimit. Përveç kësaj, doracaku nuk e adreson drejtëpërdrejt pjesën e parë të rekomandimit. Po ashtu, nevojitet më shumë informacion mbi përmbajtjen (përfshirë vënien në dispozicion të një kopje) dhe statusin e Kodit të Etikës, përfshirjen e palëve të interesit dhe periudhën e pritshme të miratimit. Nuk është shënuar progres për aspektet e tjera të rekomandimit.

135. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandim xxiii nuk është zbatuar.

Rekomandimi xxiv

136. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të zhvillohen udhëzues në lidhje me sjelljen dhe veprimet e zyrtarëve publikë me rastin kur ata marrin dhurata, në mënyrë që të kompletohen rregullat e parapara në Nenin 11 të Ligjit Nr. 04/L-050 mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave të të gjithë Zyrtarëve Publikë (paragrafi 311).*

137. Autoritetet e Kosovës informojnë se projektligji Nr. 04/L-228 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Deklarimin e Pasurive Ligji Nr. 04/L-050 është miratuar nga Kuvendi më 20 mars 2014) (shih po ashtu paragrafët 18 dhe më tutje më lart).

138. Ekipi i Vlerësimit ndan mendimin se ky ligj nuk e adreson në mënyrë specifike përmbajtjen e këtij rekomandimi. Përveç kësaj, përfshirja e përjashtimeve nga rregulli i përgjithshëm i ndalimit të dhuratave për zyrtarët publik (dhuratat e rastit deri në 25 euro për dhuratë dhe deri në 500 euro për zyrtar në vit) duken të jenë një hap mbrapa në lidhje me kornizën e mëhershme ligjore.

139. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxiv nuk është zbatuar.

Rekomandimi xxv

140. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që (i) të fuqizohet kontrolli i deklarimit të pasurisë dhe të interesave me qëllim që të arritjes së zbatimit dhe monitorimit të duhur; (ii) të shtohen përpjekjet për zhvillimin e kapaciteteve nëpër institucionet individuale për parandalimin dhe zbulimin e konflikteve të interesit përmes mbikëqyrjes nga afër dhe mekanizmave bashkëndues si dhe përmes materialeve specifike referuese, udhëzuesve dhe trajnimeve; dhe (iii) të shtrihet tek secili person që ushtron funksion në administratën publike (duke i përfshirë menaxherët dhe këshilltarët) në çdo nivel të qeverisë një standard adekuat dhe i zbatueshëm lidhur me konfliktin e interesit, duke e përfshirë migrimin jo të duhur në sektorin privat ("pantouflage") (paragrafi 320).*

141. Siç u përmend më lart, dy projektligjet që synojnë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Deklarimin e Pasurive (Ligji Nr. 04/L-050) dhe Ligjin mbi Konfliktin e Interesit (Ligji Nr. 04/L-051) kanë qenë në procedurë e sipër në Kuvend në fillim të vitit 2014. Ndërkohë që amendamentimet në Ligjin për Deklarimin e Pasurive Ligji Nr. 04/L-050 janë miratuar, nuk është arritur konsensus në lidhje me amendamentimet e Ligjit për Konfliktin e Interesit Nr. 04/L-051 të cilat rrjedhimisht nuk janë miratuar.

142. Ekipi i Vlerësimit vëren se neni 3 i ndryshuar i Ligjit Nr. 04/L-050 parasheh zgjerim të detyrimeve të deklarimit të pasurisë për më shumë zyrtarë (ata të emëruar nga Presidenti, pozita të barasvlefshme të kryeshefave të agjencive publike, dhe zëvendësve të tyre, kryeshefat, zëvendësit dhe sekretarët e ndërmarrjeve publike të nivelit qendror dhe lokal, udhëheqësit e departamenteve, drejtorive, drejtorateve apo njësiteve të barasvlefshme, përfshirë udhëheqësit e njësiteve të financave dhe të prokurimit të institucioneve dhe ndërmarrjeve publike, anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik, zv. kryeinspektorët, Kryetari dhe anëtarët e Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve). Po ashtu, përkufizimi i anëtarëve të familjes është qartësuar dhe zgjeruar (bashkëshorti/tja, bashkëshorti/tja jomartesor(e), prindërit dhe fëmijët nën mbikëqyrje që jetojnë në bashkësi familjare). Përveç kësaj, një kërkesë për të identifikuar burimin e pasurive është përfshirë në paragrafin 5 të Nenit të ndryshuar 15 të ligjit (shih Nenet 1, 2, 13 dhe 16 që përdorin termin "prejardhje" si dhe Nenin 5, paragrafin 3 dhe Nenin e ndryshuar 15, paragrafin 5 që përmban termin "prejardhje").

143. Një detyrim është paraparë në nenin 15 për të kontrolluar plotësisht çdo vit së paku 20% të deklarimeve. Zyrtarët publikë, deklarimi i të cilëve do të kontrollohet do të përzgjidhen përmes një procedure të thjeshtë. Kjo procedurë dhe lista e zyrtarëve të selektuar janë të hapura për publikun. Po ashtu, ekziston mundësia për të kontrolluar një deklarim specifik sipas kërkesës të publikut ose personave të interesuar.

144. Një ndryshim i paqartë dhe problematik është bërë në nenin 16.3 të Ligjit për Deklarimin e Pasurive Nr. 04/L-050. Kjo ka të bëjë me çështjen e informacionit të ofruar tek AKK nga bankat dhe institucionet financiare. Përfshirja e shprehjes "në pajtim me Kodin e Procedurës Penale" nuk duhet patur si pasojë kufizimin ose pamundësinë për të ofruar informacion tek AKK nga bankat dhe institucionet e tjera financiare në lidhje me të dhënat mbi depozitat, llogaritë dhe transaksionet e mbajtura nga zyrtarët publik të cilët i nënshtrohen ligjit.

145. Sa i përket sanksioneve, neni 17 i amendamentuar detyron AKK-në për të dorëzuar kallëzim penal tek zyra kompetente e prokurorit; për të informuar kryesuesin e institucionit dhe të publikojë emrat e zyrtarëve publikë të cilët nuk deklarojnë pasuritë e tyre. Prandaj gjobat dhe procedurat kundërvajtëse të nenit 17 të mëparshëm janë anuluar në mënyrë që sigurohet harmonizimi me Kodin Penal.

146. Ekipi i Vlerësimit ka mësuar gjatë vizitës në terren se janë dorëzuar 71 kallëzime penale nga AKK gjatë vitit 2013 për mosdeklarim e pasurive ose deklarim të rremë të pasurive (kjo përfshin kallëzime rreth 20 deputetëve; 36 kallëzime penale kanë të bëjnë me rastet e mosdeklarimeve, të tjerat me deklarime të rreme shumica e të cilave kanë të bëjnë me biznese, të hyra dhe të dhëna në lidhje me patundshmëri). Sipas informacioneve të ofruara nga zyret e prokurorëve, janë ngritur 28 aktakuza. 28 kallëzime të tjera penale janë dorëzuar nga AKK gjatë muajve të parë të vitit 2014. Ekipi i Vlerësimit do ta çmonte informacionin përcjellës mbi këto raste.

147. Nga perspektiva e palëve e interesuara joqeveritare të takuara gjatë vizitës në terren, fushat prioritare të cilat duhet të adresohen nga institucionet e administratës publike përfshijnë nevojën për të siguruar plane të qarta të performancës si dhe llogaridhënien e përmirësuar; si dhe të parashohin leadership në vend të vetëm adresimit të çështjeve legislative dhe institucionale.

148. Ndryshimet në Ligjin për Konfliktin e Interesit tregojnë disa prirje pozitive:

- Zgjerimi i fushëveprimit të ligjit për të gjithë zyrtarët publik;
- Unifikimi dhe bashkërendimi i terminologjisë dhe përkufizimeve në lidhje me zyrtarët publik (termi i përdorur është "person zyrtar"); - të njëjtat si në Nenin 120 të KP- në vend të "zyrtarit publik";
- Ndryshimet në përkufizimin në nenin 4 (neni 120 dhe 424 i KPP);
- Neni 9 (1.7 deri në 1.9): përfshirja e disa rregullave që synojnë adresimin e "pantouflage" për një periudhë prej 5 viteve;
- Mundësia e dhënë për AKK për të paraparë rishikimin e vendimit të marrë në një situatë të konfliktit të interesit nga organi që e ka lëshuar atë (neni 18, pikat 13 deri në 15) - pezullimi i veprimeve;
- Neni 19 (pikat 2-4): Pjesëmarrja e AKK si vëzhgues në të gjitha aktivitetet publike të prokurimit dhe mundësia për të lëshuar rekomandime;
- Regjistri i Konfliktit të Interesit të mbahet nga AKK;
- Neni 20 - Harmonizimi me KP dhe sanksionet e tjera.

149. Megjithatë ka ende çështje brengosëse në dispozitat aktuale si dhe në disa amendamente të propozuara në Ligjin për Konfliktin e Interesit. Këto çështje janë diskutuar me Drejtorin e AKK-së dhe një Letër Këshilldhënëse është përgatitur nga Projekti PECK për t'u marrë parasysh më tutje nga vendimmarrësit (shih po ashtu paragrafët 18 dhe më tutje më lart):

- Përkufizimi i "personave zyrtarë" dhe zgjerimi i rregullave të Konfliktit të Interesit në nivelet e tjera të personave zyrtarë pa marrë parasysh kapacitetet zbatuese dhe organet zbatuese;
- Përkufizimi i "personave të besuar" dhe vështirësitë e lindura në praktikë;
- Çështja e shumëzimit të veprimtarive shtesë të zyrtarëve publikë;

- Domosdoshmëria e dallimit të qartë të nocioneve të konfliktit të interesit përkundrejt papajtueshmërisë; dhe
- Posaçërisht, marrëdhëniet ndërmjet Konfliktit të Interesit si vepër penale kundrejt shkeljes administrative si dhe një ndarje dhe pavarësi në mes të procedurave penale dhe administrative të konfliktit të interesit për ta shmangur çfarëdo mosndëshkimi në lidhje me shkeljet e dispozitave të konfliktit të interesit.

150. Pas leximit të parë në komisionin kompetent parlamentar dhe disa takimeve të njëpasnjëshme, projektligji që synon amendamentimin e Ligjit për Konfliktin e Interesit nr. 04/L-051 ka ngecur dhe nuk është miratuar. Ndjeshmëritë politike duket të jenë në qendër të kësaj mungese të konsensusit të duhur.

151. Çështja e të ashtuquajturit "punësim të dyfishtë" ka qenë temë e debatit në mes të palëve të interesit dhe publikut, përfshirë mediat. Duket se më shumë se gjysma e zyrtarëve publikë vazhdojnë të kenë së paku dy punë/pozita të paguara. Çka shkakton brenga të konsiderueshme dhe reagime publike është proporcioni i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe zyrtarëve të ndryshëm publikë dhe shërbyesve civilë të cilët kanë më shumë se një vend pune. Media ka raportuar për zyrtarë publikë të cilët mbajnë nga katër ose pesë pozita të paguara.

152. Duket se përderisa aspektet e mëtutjeshme të rekomandimit nuk janë adresuar ende dhe aspekti i parë është ende në fazat e hershme të zbatimit, për rrjedhojë Ekipi i Vlerësimit nuk mund veçse të përfundojë se ky rekomandim nuk është adresuar plotësisht.

153. Nën dritën e këtyre zhvillimeve, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxv është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xxvi

154. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të merret parasysh përdorimi më i gjerë i rotacionit në lidhje me këta sektorë të administratës publike të cilat janë në veçanti më të ekspozuar ndaj rrezikut të korrupsionit (paragrafi 322).*

155. Autoritetet e Kosovës informojnë se rotacioni përdoret në disa sektor të administratës publike, ku ekziston rreziku i korrupsionit siç është Administrate Tatimore, Doganat dhe Departamenti Doganor i Policisë së Kosovës.

156. Ekipi i Vlerësimit mban shënim informacionin e ofruar dhe i inkurajon autoritetet të konsiderojnë përdorimin periodik të masave të rotacionit apo masa të ngjashme në sektorë të tjerë dhe për zyrtarë publikë dhe shërbyes civilë të cilët mbeten më të ekspozuar ndaj rreziqeve të korrupsionit ose janë veçanërisht të pambrojtur ndaj rreziqeve të korrupsionit. Kjo mund të përfshinte, mes të tjerash, shërbimet e tjera të Policisë së Kosovës (p.sh. personelin e policisë të komunikacionit), autoritetet dhe institucionet e prokurimit publik që merren me dhënien e kontratave përfshirë privatizimin, çdo personel përgjegjës për dhënien e shërbimeve publike që përfshin kontakte të shpeshta me publikun; personelin nga inspektimi, auditimi dhe funksionet e kontrollit dhe stafin specifik në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë. Përveç marrjes parasysh të rreziqeve relevante ndaj të cilave mund të ekspozohen zyrtarët publikë, konsideratat e tjera (dyshimet e bazuara, kontaktet e panevojshme, etj.) mund t'i udhëzojnë menaxherët në zbatimin e masave të rotacionit apo zgjidhjeve të tjera të ngjashme.

157. Rrjedhimisht, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxvi është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xxvii

158. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të themelohet dhe të mirëmbahet raportimi i rregullt qendror i statistikave mbi zbatimin e procedurave dhe sanksioneve disiplinore në administratën publike (paragrafi 332).*

159. Ekipi i Vlerësimit rikujton nevojën dhe përfitimet për Qeverinë për të mbledhur sistematikisht - në nivel qendror - statistika periodike nga institucionet e tjera publike në lidhje me përdorimin e procedurave dhe masave disiplinore. Pavarësisht rëndësisë së raportimit dhe mbledhjes periodike të të dhënave dhe statistikave të tilla për vlerësimin e efikasitetit të sistemit dhe asistimin e proceseve të tjera të administratës publike, nevojave dhe reformave, nën dritën e fokusit kryesor të këtij raporti, të dhëna të tilla ofrojnë orientim të dobishëm në identifikimin e mangësive në legjislacionin, rregulloret dhe politikat ekzistuese apo në zbatimin praktik të tyre në aktivitetet e administratës publike. Mbledhja e rregullt dhe vlerësimi i të dhënave dhe statistikave të tilla

kontribuojnë në marrjen e masave të përshtatshme dhe për të bërë ndryshimet e duhura për një parandalim më të mirë dhe më efikas të korrupsionit dhe menaxhimit të rregullave të etikës.

160. Autoritetet e Kosovës kanë ofruar statistikën në vijim të cilat mbahen nga Bordi i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin civil në Kosovë për vitin 2013; 137 ankesa të aprovuara, 22 raste ku është deklaruar se nuk është kompetente mbi lëndën; 26 kthime mbrapa; 7 procedura të ndërprera; 12 ankesa të pezulluara; dhe 4 të udhëhequra nga ankesa.

161. Ekipi i Vlerësimit vëren megjithatë se informacioni i ofruar nuk adreson asnjë aspekt të rekomandimit më lart. Ekipi i Vlerësimit ka mësuar se nuk ka statistika të sakta mbi procedurat disiplinore. Përvoja praktike me legjislacionin është kuptueshëm e kufizuar. Përveç kësaj, në situatën aktuale, Ministria e Administratës Publike ka mundësi të vogla për t'u informuar në baza periodike⁷ pasi që sistemi aktual i decentralizuar pa mundësi të informacionit dhe statistikave të centralizuara gjithëpërfshirëse mbi hetimet, masat dhe sanksionet disiplinore nuk është aspak i dobishëm në marrjen e vendimeve për çështje të politikave, ligjore, rregullatore apo menaxheriale në lidhje me etikën dhe parandalimin e korrupsionit në administratën publike. Ekipi i vlerësimit dëshiron ta theksojë se regjistri qendror i shërbyesve civilë mund të ishte një mundësi në të ardhmen për ta marrë parasysh fizibilitetin e menaxhimit dhe raportimit të statistikave nga institucionet publike. Përfshirja e procedurave për mbledhjen sistematike përmes ministrisë apo administratës së linjës dhe vlerësimi në nivel qendror i informacionit mbi shkeljet e rregullave etike dhe rezultatet e procedurave disiplinore në sistemin e shërbimit civil do të ishte një model i nevojshëm për t'u zgjeruar më tutje në institucionet e tjera të administratës publike.

162. Prandaj, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxvii nuk është zbatuar.

⁷ Bazuar në projekt-raportin mbi situatën në shërbimin civil për vitin 2013 (të dhënat e ofruara nga institucionet që punësojnë shërbyes civilë), rezultoni se janë shqiptuar 228 masa disiplinore kundër shërbyesve civilë në vitin 2013 kundër 327 masave të ngjashme në vitin 2012 (më pak se 37.8% apo 144 masa të shqiptuara).

2.5 Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit - Deputetët e Kuvendit

163. Kosova ka mbajtur zgjedhjet e përgjithshme më 8 qershor 2014 pas vendimit të datës 7 maj 2014 për ta shpërbërë Kuvendin. Natyra demokratike e këtij votimi, në pajtueshmëri të gjerë me standardet Evropiane si dhe mungesa dhunës së dukshme apo të organizuar dhe manipulimit sistematik kudoqoftë, ishin të mirëseardhura dhe janë lavdëruar nga bashkësia ndërkombëtare dhe palët vendore të interesit. Dalja në zgjedhje prej 42% ka qenë më e lartë në krahasim me zgjedhjet e kaluara në vitin 2010, por më e ulët se në zgjedhjet e fundit komunale.

164. Sipas rezultateve zyrtare të çertifikuara zgjedhore të dala më 4 korrik 2014, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e udhëhequr nga Kryeministri në largim Hashim Thaqi ka marrë 30.38% (37 ulëse); Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e udhëhequr nga Isa Mustafa, 25.24% (30 ulëse); Vetëvendosje, e udhëhequr nga Albin Kurti, 13.59% (16 ulëse); Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, ka fituar 9.54% (11 ulëse), Nisma e sapo themeluar e udhëhequr nga Fatmir Limaj, 5.15% (6 ulëse) dhe Lista Sërbe ka fituar 5.22% (9 ulëse). 11 ulëset e tjera janë shpërndarë mes minoriteteve të tjera të përfaqësuara.

165. Në një lëvizje të papritur për PDK-në, një ditë pas zgjedhjeve LDK, AAK dhe Nisma kanë propozuar një koalicion për të formuar një qeveri të udhëhequr nga Ramush Haradinaj (AAK) dhe kanë njoftuar Presidentën mbi vendimin e tyre për të formuar një grup unik parlamentar LDK-AAK-Nisma. Vetëvendosja ra dakord për të qenë pjesë e koalicionit të lajmëruar përmes një marrëveshje pasuese të shkruar me tri palët e tjera.

166. Me 1 korrik 2014, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka nxjerrë vendimin sipas kërkesës së Presidentes për qartësimin e veprimit kushtetues të Presidentes në lidhje me pajtueshmërinë e Nenit 84.14 (kompetencat e Presidentit) me Nenin 95 të Kushtetutës (Zgjedhja e Qeverisë), me fjalë të tjera, kompetencat e zyrës së saj në propozimin (Kuvendit) e kandidatit për të formuar qeverinë e ardhshme⁸.

167. Më 7 korrik 2014, Presidentja e Kosovës ka thirrur seancën inaguruese konstituive të Kuvendit të sapozgjedhur për në datën 17 korrik 2014. Pas dështimit për të votuar kandidatin e PDK-së për Kryeparlamentar dhe vendimit për ta thirrur sesionin, 83 deputet nga partitë e tjera politike filluan një takim pak minuta më vonë, votuan një peticion për zëvendësimin e Kryesuesit më të vjetër nga deputeti i dytë më i vjetër, dhe zgjodhën Isa Mustafën si Kryeparlamentar të Kuvendit me 65 vota për. Më 18 korrik 2014, 30 deputetë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i dorëzuan katër pyetje Gjykatës Kushtetuese duke e kontestuar legjitimitetin e sesionit konstituiv të Kuvendit një ditë më parë dhe emërimin pasues të Kryesuesit të tij. Më 23 korrik 2014, Gjykata Kushtetuese ka miratuar një masë të përkohshme⁹ duke e pezulluar vendimin e Kuvendit për ta emëruar Isa Mustafën (Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK) si Kryesues dhe duke e ndaluar çfarëdo vazhdimi të procesit konstituiv brenda Kuvendit. Kjo e përjashton çfarëdo mundësie për të themeluar një Qeveri deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata. Në vendimin përfundimtar nr. KO119/14 të datës 26 gusht 2014¹⁰, Gjykata Kushtetuese e konsideroi mbledhjen, procedurën dhe vendimit për ta zgjedhur Kryeparlamentarin si jo kushtetues, duke argumentuar se Kryetari i Kuvendit nuk është propozuar nga grupi më i madh parlamentar (PDK). Ajo po ashtu u bëri thirrje deputetëve që ta kompletojnë sesionin konstituiv duke zgjedhur Kryetarin e saj dhe zëvendëskryetarët në pajtim me Kushtetutën.

168. Ngërçi politik zgjati rreth 6 muaj, gjatë të cilit nuk është arritur asnjë marrëveshje konkrete në mes të liderëve të partive politike. Me 21 nëntor 2014, liderët e PDK-së dhe LDK-së (Thaqi dhe Mustafa) shpallën qëllimin e tyre për të formuar një koalicion duke i dhënë kështu fund ngërçit të gjatë.

Rekomandimet xxviii, xxix dhe xxx

169. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që:*

⁸ Shih për më shumë informacion në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/KO103-14_SHQ_aktgjykim.pdf

⁹ Masa e përkohshme së bashku me përmbledhjen e dobishme të fakteve mund të gjendet këtu: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/KO119-14_VMP_SHQ.pdf

¹⁰ Shih për informacion të mëtejshëm http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_119_14_shq.pdf

Kodi i mirësjelljes së deputetëve të kuvendit të rishikohet dhe të plotësohet me masa praktike për zbatimin e tij, siç janë trajnimet e dedikuara, këshillimet në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me etikën dhe korrupsionin (paragrafi 351);

t'i jepet AKK-së – ose ndonjë organi tjetër zyrtar, në bashkëpunim me administratën tatimore - kompetenca për kryerjen e vlerësimit të duhur të pasurisë së deklaruar (paragrafi 367); dhe

të ndërmerren masa për të siguruar mbikëqyrjen dhe zbatimin e rregullave ekzistuese lidhur me konfliktin e interesit dhe zbulimin e lidhjeve të jashtme nga ana e deputetëve të kuvendit (paragrafi 379).

170. Autoritetet e Kosovës nuk kanë raportuar ndonjë progress në lidhje me këto rekomandime.

171. Në mungesë të informacionit, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimet xxviii, xxix dhe xxx nuk janë zbatuar. Ekipi i Vlerësimit i nxit fuqishëm autoritetet e Kosovës të tregojnë vendosmëri më të madhe në zbatimin e rekomandimeve xviii, xxix dhe xxx në lidhje me deputetët. Duhet më shumë për t'u bërë për të parandaluar nepotizmin dhe favorizimin dhe për të siguruar që ndiqen rregulla të qarta të etikës. Ekziston një zbrazëti në mes të legjislacionit ekzistues dhe zbatimit të saj në praktikë. Për shembull, AKK-ja nuk ka marrë asnjë masë në rastin e zv. Kryeministrit i cili, për rreth dy vjet, ka qenë po ashtu edhe anëtar i bordit të Agjencisë së Privatizimit¹¹. Në një rast tjetër, Kryeshefi Ekzekutiv i një kompanie publike ka qenë në të njëjtën kohë anëtar i KQZ-së, në kundërshtim me nenin 61.8 të Ligjit Nr. 03/L-073 mbi Zgjedhjet e Përgjithshme¹².

172. Ekipi i Vlerësimit konsideron se Kuvendi duhet të marrë përgjegjësi për promovim më të mirë të kulturës së etikës në mesin e deputetëve. Për një regjim të etikës dhe sjelljes që të funksionojë si duhet, deputetët duhet të japin vetë kontributin në suksesin e atij regjimi. Vënia e vlerave në efekt kërkon komunikim të standardeve kyçe si dhe arsimim dhe trajnim të vazhdueshëm për të ngritur vetëdijesimin dhe zhvilluar shkathtësitë të cilat do të ndihmojnë në konfrontimin dhe zgjidhjen e dilemave etike. Përmbajtja e kodit të sjelljes do të mbetet fjalë në letër nëse nuk komunikohet dhe rrënjësohet në mënyrë adekuate. Ofrimi i këshillimit të dedikuar (përfshirë atë të natyrës konfidenciale) mund të asistojë më tutje për t'i bërë deputetët më të familjarizuar me sistemin aktual për të parandaluar konfliktet e interesit dhe për të adresuar dilemat e integritetit.

173. Pyetja e vlerësimit adekuat të pasurive të deklaruar është e një rëndësie kyçe. Një organ i pavarur (për shembull AKK) duhet të jetë në pozitë të vlerësojë dhe, nëse është e nevojshme, të korrigjojë vlerën e pasurive të deklaruar. Aktualisht, vlerat e pasurive të deklaruar nuk i nënshtrohen asnjë korrektimi. Në këtë kontekst, "Doracak i Praktikantëve mbi Procedimin dhe Analizimin e Deklarimeve të të Hyrave dhe Pasurive të Zyrtarëve publik" i përgatitur në kuadër të "Projektit të Asistencës së Partneritetit Lindor të Këshillit të Evropës mbi Qeverisjen e Mirë dhe Luftën Kundër Korrupsionit" do të ishte shumë i dobishëm në ofrimin e këshillimit në metodologji.

174. Pika e fundit për t'u nënvizuar është problemi i së ashtuquajturës "pasuri e pashpjegueshme" e deputetëve: disa ndryshime shumë të rëndësishme në pasurinë e deputetëve, sipas deklarimeve të pasurive, nuk kanë fare pasoja: as AKK-ja, as Zyra e Prokurorit, e as autoritetet e zbatimit të ligjit nuk marrin asnjë masë për të marrë sqarime në lidhje me këto ndryshime¹³. Siç është përmendur në paragrafin 24 më lart, Ekipi i Vlerësimit përsërit rekomandimin e tij për të vendosur një sistem të rishikimit të kryqëzuar të të dhënave, përmes shkëmbimit automatik të të dhënave në mes të administratës tatimore, AKK, Regjistrin Kadastral (të Tokës) etj. Në hapin e parë, bazat e

¹¹ Sipas Nenit 96.7 të Kushtetutës, papajtueshmëritë e anëtarëve të Qeverisë në lidhje me funksionet e tyre duhet të rregullohen me ligj. Megjithatë, nuk ekziston akoma një legjislacion në lidhje me këtë.

¹² Sipas kësaj dispozite, një person nuk mund të jetë anëtar i KQZ-së nëse ai/ajo mban një post të lartë publik.

¹³ Cituar nga KIPRED, Pandëshkueshmëria në Kosovë: pasuria e pajustificueshme, Analizë e Politikave nr. 5/13, fq. 9 "Në shkelje të plotë të kërkesave të ligjit, deklarimet e tanishme të pasurisë nga legjislatura e tanishme e Kosovës nuk paraqiten në një mënyrë transparente. Formularë të deklaruar nga deputetë përmbajnë të dhëna jo të plota posaçërisht kur bëhet fjalë për origjinën e pasurisë së tyre. Nga 41 deputetë, 22 deputetë (ose më shumë se gjysma) për pasuri të patundshme kanë deklaruar prejardhjen e pasurisë si trashëgimi familjare ose pronë të përbashkët familjare pa cekur vitet e zotërimit të pronës. Në mënyrë të ngjashme për zyrtarët e kabinetit qeveritarë nga 22 të analizuar 12 prej tyre (apo më shumë se gjysma) kanë deklaruar trashëgimi për disa nga pasuritë e tyre, kryesisht pasurive të patundshme. KIPRED ka shikuar deklarimin e pasurive të 41 deputetëve, duke zgjedhur gjysmën e deputetëve nga secili grup parlamentar nga 4 partitë më të mëdha politike. Në shumicën e rasteve të përmendura më lart pasuria e përgjithshme e rritur është e pajustificueshme nëse krahasohet me të ardhurat e tyre vjetore".

të dhënave ekzistuese do të mund të konsolidoheshin dhe harmonizoheshin; në hapin e dytë, ato duhet të bashkohen. Si rezultat, bazat e ndryshme të të dhënave do të lejojnë për një gjurmim më efikas të shkeljeve të rregullave mbi deklarimin e pasurive.

2.6 Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore

175. Sipas informacionit të ofruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk mund të raportohet asnjë progres në fushën e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, përveç amendamenteve të reja të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (Ligji nr. 04/L-212 i 31/07/2013).

Rekomandimi xxxi

176. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të bëhet harmonizimi i dispozitave juridike për financimin e subjekteve politike dhe të fushatave në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për kandidatët e tjerë për zgjedhjet (për zgjedhjet komunale dhe të përgjithshme dhe për zgjedhjet presidenciale) (paragrafi 403).*

177. Sipas informacionit të ofruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ligji Nr. 04/L-212 i datës 31/07/2013 ka ndryshuar dhe plotësuar ligjin bazë nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike (miratuar me 16 shtator 2010), më tutje në tekst si Ligji FSP) i cili veç është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 të datës 21 Dhjetor 2011.

178. Ekipi i Vlerësimit merr shënim informacionet e marra. Ai e mirëpret Ligjin e ri Nr. 04/L-212 dispozitat e reja të të cilit adresojnë disa rekomandime të lëshuara në këtë pjesë.

179. Megjithatë, qëllimi i rekomandimit xxx është të procedohet në harmonizimin e përgjithshëm të legjislacionit në lidhje me subjektet politike, kandidatët për zgjedhjet në nivel lokal dhe qendror, zgjedhjet presidenciale, dhe të hartohet ligji i ri për të koordinuar të gjitha dispozitat ligjore dhe ligjet rezultuese që rregullojnë financimin politik në një ligj. Nuk është mjaft e qartë për Ekipin e Vlerësimit nëse Ligji i ri nr. 04/L-212 e harmonizon me të vërtetë fushën e financimit politik.

180. Mungesa e Kodit Zgjedhor shpesh përmendet si një çështje që duhet të merret parasysh për një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse, të qartë dhe të harmonizuar.

181. Një çështje tjetër e rëndësishme është projektligji për zgjedhjen e Presidentit. Nuk ka pasur zhvillime më të fundit në këtë aspekt që nga periodha e RV dhe deri në muajin prill 2014.

182. Nën dritën e informacionit të disponueshëm, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxxi është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xxxii

183. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të përgatitet një faqe unike dhe gjithëpërfshirëse e internetit, e cila e paraqet kornizën juridike dhe rregullative dhe ofron informata përkatëse në lidhje me raportet periodike të subjekteve politike si dhe informata të tjera relevante (paragrafi 404).*

184. Autoritetet e Kosovës bëjnë referencë në nenin e rifrazuar 19, paragrafi 10 të Ligjit të ndryshuar FSP që detyron KQZ të publikojë dhe mbajë të publikuara të gjitha raportet vjetore financiare të partive politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të partive politike në faqet e tij zyrtare të internetit jo më larg se 30 qershor të vitit pasues.

185. Ekipi i Vlerësimit merr shënim këtë riformulim dhe konsideron se i adreson të gjitha çështjet e ngritura në rekomandimin xxxii.

186. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxxii është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Rekomandimi xxxiii

187. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të sigurohet se përkufizimi i 'kontributit' dhënë partisë politike, siç parashihet me Rregullën 01/2008 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, të përdoret vazhdimisht në kornizën legjislative dhe rregullative në lidhje me financimin e subjekteve politike dhe fushatave zgjedhore në mënyrë që të përfshihen burimet e tërthorta (siç janë shërbimet apo donacionet në natyrë) (paragrafi 420).*

188. Autoritetet e Kosovës bëjnë referencë në nenin 2 të riformuluar, paragrafi 1.5 i Ligjit të ndryshuar FSP: 1.5 Kontributet - dhuratat (donacionet) ose ndihma e cilido lloj që nënkupton një akt të ndërgjegjshëm për t'i dhuruar të mira ekonomike apo të ngjashme për subjektin politik, qoftë në para të gatshme, shërbime, shitja e gjësendeve nën çmimin e tregut, ofrimi i shërbimeve nën çmimin e tregut apo në të mira të tjera materiale".

189. Ekipi i Vlerësimit vëren se ky formulim i ri është në pajtim me rekomandimin e RV. Megjithatë, nuk është e qartë nëse ky formulim i ri mbulon të tërë kornizën ligjore dhe institucionale në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, dhe, për shembull, nëse është i detyrueshëm edhe për zgjedhjet presidenciale.

190. Në mungesë të informacionit të mëtutjeshëm që adreson çështjen më lart, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxxiii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xxxv

191. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të përcaktohen kushte më të sakta për kërkesat e raporteve financiare dhe për afatin/afatet e publikimit (paragrafi 436).*

192. Autoritetet e Kosovës bëjnë referencë në paragrafin e ri 5 të nenit 15 të ligjit të ndryshuar FSP "5. Subjektet politike duhet të publikojnë dhe të mbajnë të publikuar së paku një (1) vit në faqet e tyre zyrtare Raportin Vjetor Financiar të vitit paraprak dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës së zgjedhjeve paraprake dhe ta publikojnë versionin tyre të shkurtuar në njërin nga gazetatat ditore kombëtare. Formatin e versionit të shkurtër për publikim e përcakton KQZ-ja përmes një akti nënligjor".

- 5.1 Raporti Vjetor Financiar i subjektit politik duhet të publikohet në mjetet e informimit të parapara në paragrafin 5. të këtij neni deri më 30 korrik të vitit pasues.
- 5.2 Raporti i Deklarimit Financiar të Fushatës së subjektit politik duhet të publikohet në mjetet e informimit të parapara në paragrafin 5 të këtij neni më së larg gjashtë (6) muaj pas ditës së mbajtjes së zgjedhjeve".

193. Në mendimin e Ekipit të Vlerësimit, KQZ duhet të përcaktojë një format të standardizuar për raportim që duhet të përdoret nga partitë politike për shpalosjen e të gjitha informacioneve të kërkuara për t'i lejuar publikut krahasimin e raporteve. Raportet duhet të jenë të kuptueshme lehtë për një qytetar mesatar dhe duhet të dallojnë të hyrat nga shpenzimet. Përveç kësaj, raportet duhet në mënyrë të duhur t'i numërojnë donacionet private dhe publike në kategori të standardizuara. Raportet duhet të përfshijnë financimin vjetor të partisë dhe të fushatës (aty ku është e zbatueshme).

194. Në lidhje me pjesën e parë të rekomandimit (kushte më të përpikta për kërkesat e raporteve financiare), Ekipi i Vlerësimit vëren me kënaqësi se ndryshimet e Nenit 4, paragrafët 2 deri në 5 të ligjit bazë FSP parashohin rregulla të reja që merren me çështjen e llogarive të detyrueshme të vetme bankare për partitë politike. Megjithatë, nuk janë prezantuar kushte të mëtutjeshme të sakta për kërkesat e vetë raporteve financiare.

195. Në lidhje me pjesën e dytë të rekomandimit (kushte më të përpikta për afat(et) e publikimit), Ekipi i Vlerësimit vëren me kënaqësi se dispozitat në paragrafin e ri 5 të Nenit 15 të Ligjit të ndryshuar FSP janë në pajtim me kërkesat e tij.

196. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxxv është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xxxvi

197. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që Komisionit Qendror të Zgjedhjeve/Zyrës ose Agjencisë kundër Korrupsionit t'i jepet mandati dhe autoriteti i duhur si dhe burimet financiare dhe personeli i specializuar për mbikëqyrjen efektive dhe proaktive të financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore, për hetimin e shkeljeve të pretenduara të rregullave për financimin politik, dhe, sipas nevojës, për shqiptimin e sanksioneve (paragrafi 442).*

198. Nuk është ofruar asnjë informacion mbi këtë çështje të rëndësishme nga autoritetet e Kosovës.

199. Ekipi i Vlerësimit u bën thirrje autoriteteve të Kosovës të merren me këtë rekomandim me prioritet, pasi që zbatimi i tij është qenësor për mbikëqyrjen efektive të financimit politik.

200. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxxvi nuk është zbatuar.

201. Kosovës i mungojnë mekanizma të kontrollit mbi financimin e partive politike. Zyra përgjegjëse për rishikimin dhe kontrollimin e raporteve financiare nuk ka burime të mjaftueshme për të hetuar dhe ekzaminuar raportet financiare të partive politike. Këto detyra mund të zgjerohen në institucione dhe organe të tjera, siç është AKK, në mënyrë që të kontrollohen të hyrat e partive politike dhe të zbulohen praktikat mashtruese financiare.

Rekomandimi xxxvii

202. *Ekipi i vlerësimit ka rekomanduar që (i) të unifikohen formularët e raportimit të partive, në veçanti në lidhje me përmbajtjen, afatet e dorëzimit dhe të publikimit të tyre; dhe (ii) të përcaktohet procedura për monitorimin e standardeve të përcaktuara (paragrafi 443).*

203. Për arsyet tani më të diskutuara sipas rekomandimit xxxv, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxxvii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xxxix

204. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të vendosen sanksione më bindëse, më efektive dhe më proporcionale në lidhje me shkeljen e rregullave të financimit politik dhe Komisionit qendror të zgjedhjeve t'i jepet autoriteti i duhur për hetimin e këtyre rasteve dhe për vendosjen e sanksioneve të duhura (paragrafi 454).*

205. Autoritetet e Kosovës thonë se Neni 21 i rishikuar (dispozitat ndëshkuese) i Ligjit FSP të ndryshuar parasheh një sistem më koherent të sanksioneve, në pajtim me rekomandimin xxxix. Neni 21 kërkon që subjekti politik të gjobitet me gjobë bazë me dhjetë përqind (10%) të shumës së realizuar nga Fondi për përkrahjen e subjekteve politike (më tutje në tekst si "Fondi") në vitin paraprak nëse subjekti nuk e paraqet Raportin Vjetor Financiar dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës në afatin e paraparë me ligj, dhe me gjobë ditore prej 0.01 % të shumës së gjobës bazë, deri në paraqitjen e raportit. Një subjekt politik i cili nuk merr mjete nga Fondi gjobitet me gjobë bazë me një mijë (1000) euro dhe me gjobë ditore prej 0.01 % të shumës së gjobës bazë, deri në paraqitjen e raportit. Një subjekt politik i cili nuk e paraqet Raportin Vjetor Financiar dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës brenda afatit të përcaktuar me ligj humb të drejtën për të përfituar nga shpërndarjet e Fondit për vitin e ardhshëm.

206. Subjekti politik do të gjobitet për mospërmbylljen e kriterëve të raportit financiar të përcaktuar me ligj si në vijim: për informatat e pasakta dhe jo të plota të dhëna lidhur me bilancin e gjendjes, pasqyrën e fitimit dhe të humbjeve dhe pasqyrën e pagesës mbi vlerën pesë mijë (5,000) euro të bërë personave të tjerë, me pesë mijë (5,000) euro si dhe me gjobë ditore prej 0.01% të shumës bazë deri në përmirësimin e këtyre të dhënave.

207. Subjekti politik do të gjobitet me gjobë bazë me dy mijë (2,000) euro për mungesën e kopjeve të dokumentacionit të raportit financiar të paraparë në paragrafin 3 të nenit 15 të ligjit bazik.

208. Një subjekt politik gjobitet me gjobë bazë në shumën prej pesë mijë (5,000) euro për mospublikimin e Raporteve Financiare të paraparë në nenin 15, paragrafi 5. të ligjit bazik dhe me gjobë ditore në vlerë prej 0.01% të vlerës së gjobës bazë deri në publikimin e tyre

209. Subjekti politik gjobitet me dyfishin e vlerës së pranuar ndërsa kandidati për kryetar komune, deputet, këshilltar komunal dhe kandidati i pavarur gjobitet me vlerën e njëjtë të pranuar nëse pranon dhe ekzekuton donacione nga personi fizik në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të ligjit bazik, apo pranon dhe ekzekuton donacione nga personi juridik në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të ligjit bazik, apo pranon dhe ekzekuton donacione në kundërshtim me nenin 11 të ligjit bazik, apo pranon dhe ekzekuton donacion deri në njëzet mijë (20,000) euro, origjina e të cilëve nuk mund të dëshmohet.

210. Një subjekt politik i cili nuk mund të dëshmojë origjinën e të hyrave të pranuar dhe të ekzekutuara mbi njëzet mijë (20,000) euro do të gjobiten me trefishin e asaj shume.

211. Personat fizikë dhe juridikë të cilët japin kontribute në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 11 të ligjit bazik, gjobiten me njëzetë përqindë (20%) të vlerës së dhënë.

212. Të gjitha të hyrat e realizuara nga subjekti politik jashtë burimeve të parapara me nenin 4 të ligjit bazë do të derdhen në Buxhetin e Kosovës dhe subjektet politike do të gjobiten me dhjetë përqind (10%) të shumës së realizuar.

213. Një subjekt politik gjobitet me dyfishin e mjeteve financiare të harxhuara në kundërshtim me nenin 8 dhe nenin 10 të ligjit bazë.

214. Një subjekt politik gjobitet me gjobë bazë me pesëmijë (5,000) euro për mbajtjen aktive të dy apo më shumë llogarive bankare dhe me gjobë ditore prej 0.01 % të shumës së gjobës bazë gjer në mbylljen e këtyre llogarive.

215. Subjekti politik gjobitet me shumën njëmijë (1,000) euro për mosnjoftimin e KQZ-së në afatin e paraparë në nenin 3, paragrafi 5. të këtij ligji, për mjetet e pranuar në kundërshtim me këtë ligj.

216. Nëse në keqpërdorim të fondeve është i përfshirë kandidati apo subjekti politik dhe vërtetohet se fitimi i mandatit/mandateve është si rezultat i keqpërdorimit të fondeve në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, kandidati apo subjektit politik i merret mandati.

217. Subjektet politike kanë të drejtë ankese ndaj ndëshkimeve të shqiptuara. Ankesat i drejtohen Panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtresa në bazë të legjislacionit në fuqi.

218. Të hyrat nga gjobat sipas këtij ligji derdhen në Buxhetin e Kosovës.

219. Ekipi i Vlerësimit merr shënim për këtë rregullore të detajuar dhe precize. Megjithatë, Ekipi i Vlerësimit konsideron se në disa aspekte, gjobat janë relativisht të vogla dhe nuk janë bindëse mjaftueshëm. Përveç kësaj, kapacitetet hetimore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të demonstron në terma praktike.

220. Rrjedhimisht, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xxxix është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xl

221. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që t'i caktohet Zyrës autoriteti i duhur për kryerjen, sipas nevojës, të verifikimit thelbësor (përveç shqyrtimit formal ekzistues) të informatave të dhëna prej kandidatëve zgjedhorë dhe subjekteve të tjera politike (paragrafi 455).*

222. Autoritetet e Kosovës nuk kanë raportuar informacione në këtë aspekt.

223. Në mungesë të informacionit, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xl nuk është zbatuar.

Rekomandimi xli

224. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që raportet e partive politike të publikohen rregullisht në një faqe publike të internetit (paragrafi 456).*

225. Autoritetet e Kosovës referohen në paragrafin e ri 5 të Nenit 15 të Ligjit FSP të ndryshuar që thotë: "Subjektet politike duhet të publikojnë dhe të mbajnë të publikuar së paku një (1) vit në faqet e tyre zyrtare Raportin Vjetor Financiar të vitit paraprak dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës së zgjedhjeve paraprake dhe ta publikojnë versionin e tyre të shkurtuar në njërin nga gazetatat ditore kombëtare" [...]. Siç është përmendur sipas rekomandimit xxxii (shih paragrafin 182 më lart), autoritetet e Kosovës bëjnë po ashtu referencë në nenin e riformuluar 19, paragrafi 10, të Ligjit të amendamentuar FSP, që detyron KQZ të publikojë dhe mbajë të publikuara të gjitha raportet financiare të partive politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit në faqen e vet zyrtare të internetit jo më larg se 30 qershor të vitit vijues.

226. Ekipi i Vlerësimit merr shënim informacionin e ofruar. Ai pranon se rregullorja aktuale parasheh publikimin e detyrueshëm dhe periodik të raporteve të partive politike, dhe se llogaritë duhet të publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.

227. Për këtë arsye, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xli është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

2.7 Prokurimi Publik

Rekomandimi xlii

228. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të krijohen kushte për më shumë transparencë dhe barazi në konkurrim, me qëllim për ta minimizuar rrezikun e mundësive për korrupsion në fushën e prokurimit publik dhe të privatizimit (paragrafi 467).*

229. Autoritetet e Kosovës njoftojnë se mbi bazën e ndonjë trajtimi të pabarabartë apo diskriminimi sipas Nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042 (LPP), operatorët ekonomikë vendorë dhe të huaj kanë të drejtë sipas Nenit 109 të ankohen në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit. Gjithashtu, edhe me legjislacion sekondar që është i publikuar në web faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik- KRPP-së (www.krpp.rks-gov.net), dhe përfshin rreth 81 akte nënligjore janë krijuar kushte për një barazi në konkurrim. Përveç kësaj, ata pohojnë se në bazë të statistikave, numri më i madh i aktiviteteve të prokurimit nga autoritetet kontraktuese është duke u zhvilluar përmes procedurës së hapur që është transparente dhe iu mundëson operatorëve ekonomikë një konkurim të lirë.

230. Autoritetet përkatëse thonë se webfaqja e KRPP-së ka një publikim për të gjitha njoftimet e kontratave për autoritetet kontraktuese përderisa webfaqja e OSHP-së publikon në mënyrë periodike të gjitha vendimet mbi rishikimin e ankesave të ngritura nga operatorët ekonomikë. Përveç kësaj, webfaqja e KRPP-së vizitohet rregullisht dhe ka shënuar një mesatare për vitin 2013 prej 24,405 vizitave në ditë¹⁴. Sipas Raportit Vjetor të KRPP-së, ka një rritje të njoftimeve të publikuara të kontratave të dhëna gjatë vitit 2013: 5,256 njoftime të kontratave të cilat janë publikuar në vitin 2013 paraqesin një rritje të vogël në krahasim me vitin 2012, ndërsa 6,919 njoftime për dhënie të kontratës të publikuara shënojnë një rritje prej 10.8% kundrejt vitit 2012. Edhe pse publikimi i kontratave të dhëna në vlera/çmime të vogla (kuotimeve të çmimeve) nuk është detyrim ligjor si për kontratat, megjithatë publikimi faktual i tyre ka ndikuar në këtë rritje. Përveç kësaj, KRPP ka ofruar këshilla profesionale në rreth 1,476 raste përmes mjeteve elektronike apo përmes telefonit (35 interpretime me shkrim, 368 përgjigje elektronike dhe 1,073 interpretime përmes telefonit).

231. Autoritetet e prokurimit publik më tutje u referohen statistikave që tregojnë se një numër i madh i aktiviteteve të prokurimit është zhvilluar sipas procedurës së hapur (87.86% e rasteve) duke iu mundësuar operatorëve ekonomikë konkurrimin e lirshëm dhe transparent, në krahasim me procedurat e negociuara të cilat përfaqësojnë vetëm 5.60%¹⁵.

232. Autoritetet më tutje thonë se numri mesatar i ofertuesve për periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2013 ndryshon prej 5 deri në 5.9 dhe përbën një mesatare prej 5.43 të operatorëve për tender (kjo është më e lartë në krahasim me disa vende fqinje që numërojnë një mesatare në mes të 3-4 ofertimeve për tender). Së fundi, sipas OSHP-së, 90% e dëgjimeve të tij janë publike.

233. Ekipi i Vlerësimit merr shënim informacionin e ofruar dhe progresin e mëtutjeshëm të kryer nga autoritetet e Kosovës në ofrimin e nivelit të kënaqshëm të transparencës dhe barazisë në konkurrim. Megjithatë, ai mbetet i brengosur në lidhje me periodicitetin, vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë në përpjekjet në këtë drejtim dhe nxit autoritetet përkatëse t'i kushtojnë rëndësi të veçantë të gjitha masave të ndërlydhura me transparencë dhe barazi në aktivitetet e tyre ditore. Progresi i mëtutjeshëm dhe i qartë në këtë drejtim do t'i zvogëlonte rreziqet e korrupsionit, përmirësonte integritetin dhe rriste konkurrencën. Në anën tjetër, përderisa janë vërejtur disa prirje pozitive në fushën e prokurimit publik, megjithatë nuk janë raportuar kurrfarë masash konkrete për të adresuar transparencën dhe barazinë në konkurrencë në fushën e privatizimit.

234. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xlii është zbatuar pjesërisht.

¹⁴ Shifrat e dhëna më lart tregojnë 8,400 vizitorë në ditë (19% më e lartë në krahasim me vitin 2012), 12,560 njoftime të shfletuara në ditë (12.8% më e lartë), 3,360 njoftime të shkarkuara (11% më e lartë) dhe 85 rregullore të konsultuara në ditë (apo 22.6% më e lartë se në vitin 2012).

¹⁵ Nga vlera e përgjithshme e kontratave të nënshkruara që arrijnë vlerën prej 444,181,399.10 euro, kontratat e nënshkruara sipas procedurave të hapura arrijnë në 390,277,502.17 euro (87.86%) kundrejt kontratave të negociuara pa publikim të njoftimit të kontratës (5.61%) dhe kuotim i çmimit (5.78%).

Rekomandimi xliii

235. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që, (i) me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve dhe mundësive për korrupsion, të sigurohet rregullimi i mëtejshëm i procedurave dhe i rregullave për prokurimin publik, duke përfshirë fillimin e shpejtë të blerjes qendrore; (ii) të shtohen mekanizmat dhe kapacitetet e monitorimit, mbikëqyrjes dhe shqyrtimit; (iii) të rishikohet Ligji mbi prokurimin publik për sa i përket fushëveprimit dhe procedurave në lidhje me raportimin e shkeljeve dhe shkelësve të prokurimit publik; dhe (iv) të shtohet shkëmbimi dhe trajtimi i informatave dhe bashkëpunimi horizontal ndërmjet agjencive, sidomos mes organeve të prokurimit publik, të auditimit, organeve kundër korrupsionit, organeve tatimore dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit (paragrafi 489).*

236. Autoritetet e Kosovës informojnë se Ligji i Prokurimit Publik është pothuajse plotësisht i harmonizuar me kërkesat e BE-së dhe është ranguar lart në Raportin e Progresit të KE-së 2013. KRPP ka nxjerrë dhe ka aprovuar të gjitha aktet detyruese (gjithsej 81) të nevojshme për zbatimin e LPP-së dhe janë të publikuara në tri gjuhët zyrtare në web faqen e KRPP-së.

237. Përveç kësaj, përveç monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik tek autoritetet kontraktuese siç kërkohet me LPP, KRPP ka filluar poashtu edhe monitorimin e menaxhimit të kontratave publike/marrëveshjeve sipas Nenit 87.2.1 mbi LPP. Me qëllimin e rritjes së mekanizmave të monitorimit dhe mbikëqyrjes, KRPP ka riorganizuar që nga 1 janar 2014 një Departament për Mbikëqyrjen dhe Monitorim duke i themeluar dy divizione brenda departamentit: Divizioni për Monitorimin e Aktiviteteve të Prokurimit që përfshijnë procesin deri në nënshkrimin e kontratave; dhe Divizionin për Monitorimin e Zbatimit të Kontratave që përfshijnë procesin pas nënshkrimit të kontratave dhe më tutje. KRPP po ashtu ka filluar të monitorojë njoftimet e kontratave në mënyrë që të shmangë kritere të dyfishta dhe të pakuptueshme. Në lidhje me këtë, për periudhën nga maji në tetor 2014, janë bërë 260 përmirësime në këto njoftime. Në bashkëpunim të ngushtë me Projektin e Bankës Botërore, KRPP ka prezantuar po ashtu monitorimin e matjes së performancës në prokurimin publik.

238. KRPP ka nxjerrë Projekt Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik 2015-2020 që ka kaluar një proces të konsultimit me palët e interesuara kyçe gjatë muajit tetor 2014¹⁶. Nuk është ofruar asnjë informacion për Ekipin e Vlerësimit në lidhje me hapat e mëtejshëm, afatet dhe miratimin e pritur të saj.

239. Në funksion të rritjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave me institucionet e ndryshme, KRPP deri më tani ka nënshkruar memorandum të mirëkuptimit me Agjencinë e Prokurimit Publik (tani Agjencia Qendrore e Prokurimit) dhe me Agjencinë Kundër Korrupsionit. Një memorandum i mirëkuptimit është duke u përgatitur në mes të KRPP dhe OSHP dhe me Administratën Tatimore të Kosovës.

240. Sipas auditimeve të kryera nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, prokurimi publik vazhdon të mbetet sektor me rrezik dhe të cenueshëm në Kosovë. Aktivitetet dhe raportet e auditimit demonstrojnë progres të vogël në sistemin e prokurimit publik. Shkeljet tipike të vërejtura përfshijnë favorizime të dhëna operatorëve specifik me dosjet e tenderëve, kjo edhe për shkak të mangësive të specifikimeve teknike, menaxhimit jokorrekt të kontratave, ndryshimeve shumë të shpeshta të kontratave; mos informimit të operatorëve ekonomik jo të suksesshëm/eliminuar, dhe përzgjedhjes në shkelje të ligjit dhe jo të rregullt të operatorëve.

241. Katër projekte janë duke u zbatuar aktualisht fushën e prokurimit publik. Një projekt i BE-së ofron asistencë në zhvillimin e strategjisë kombëtare të prokurimit publik, dhe një strategji të trajnimit të PP, asistencë për prokurimin e centralizuar dhe vetëdijësimin publik. Tri projektet e tjera të cilat mbështeten nga Banka Botërore fokusohen në e-prokurim, matjen e performances dhe çmimet e referencës së mallrave, punëve dhe shërbimeve.

242. Mungesa e funksionimit të duhur të AQP-së vazhdon të jetë një çështje brengosëse. Sipas Nenit 95 të LPP, AQP është përgjegjës për ushtrimin e aktiveve specifike të prokurimit për dhe në emër të autoriteteve kontraktuese pas një vendimi të Ministrit të Financave si dhe prokurimin e centralizuar të disa komoditeteve në pajtim me një listë të aprovuar nga Qeveria. Ajo mund po ashtu të kryejë prokurimin e çfarëdo malli, pune ose shërbimi nëse kjo kërkohet nga autoritetet kontraktuese. Edhe pse korniza legjislative parasheh mundësinë për një prokurim të centralizuar

¹⁶ Disa objektiva strategjike të parapara në këtë Projekt Strategji kanë të bëjnë mes tjerash me përmirësimin e efikasitetit dhe transparencies të sistemit të prokurimit publik (përfshirë monitorimin e rregullave dhe praktikave), prokurimin qëndror, përmirësimin e kapaciteteve dhe qasjen në informacione, e-prokurimin si dhe harmonizimin e mëtejshëm me standardet relevante ndërkombëtare.

nga AQP-ja, deri më tani, as Ministria e Financave e as Qeveria nuk kanë aprovuar procedura të tilla për t'ia mundësuar AQP-së nënshkrimin e kontratave kornizë që do të arrinin shkallë ekonomike dhe kursime të kostove për sektorin publik. Rasti i vetëm i raportuar i aktivitetit të prokurimit qëndror ka të bëjë me furnizimin me naftë për 42 institucione në vlerë prej 15 milionë euro.

243. Ekipi i Vlerësimit i referohet ligjit më të ri Nr. 04/L-237 që ndryshon dhe plotëson LPP nr. 04/L-042 i cili është dorëzuar në Kuvend në nëntor 2013 dhe është miratuar më 20 mars 2014. Në lidhje me këtë, Ekipi i Vlerësimit ndjen keqardhje për faktin se amendamentimet aktuale nuk e adresojnë pikën (iii) të rekomandimit. Rrjedhimisht, ai rikujton fuqishëm nevojën për ndryshimin e regjimit raportues të shkeljeve dhe shkelësve të prokurimit publik. Riorganizimi i Departamentit për Mbikëqyrje dhe Monitorim është përpjekje pozitive për të përmirësuar kapacitetet dhe mekanizmat e mbikëqyrjes dhe monitorimit si dhe monitorimin e kontratave. Megjithatë, nuk ka informacion konkret në lidhje me vetë procesin e monitorimit dhe progresin e shënuar në këtë aspekt. Ngjashëm, fakti se anëtarët e Organit Shqyrtues të Prokurimit nuk janë zgjedhur që nga muaji gusht 2013¹⁷ ka dëmtuar seriozisht funksionimin normal të këtij organi të rëndësishëm shqyrtues. Pasoja kryesore e kësaj zbrazëtie ka qenë se prokurimet e bëra gjatë kësaj periudhe nuk u janë nënshtruar ekzaminimeve nga OSHP-ja. Rreth 250 ankesa të cilat janë dorëzuar gjatë periudhës së lartpërmendur mbeten të paekzaminuara dhe janë refuzuar me vendimin Nr. 174/14 të 27 marsit 2014 për shkak të pengesave të parashkrimit sipas LPP (Neni 117 dhe 79 i LPP-së në lidhje me Nenin 131 të Ligjit mbi Procedurën Administrative)¹⁸.

244. Përveç kësaj, aspektet e tjera të rekomandimit nuk janë adresuar pasi që nuk janë raportuar masa domethënëse në lidhje me to. Në fund, informacioni i ofruar për Ekipin e Vlerësimit në lidhje me pjesën e katërt të rekomandimit (rritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave mes agjencive), nuk përmban masa konkrete.

245. Nën dritën e informacioneve të përmendura më lart, Ekipi i Vlerësimit përfundon se Rekomandimi xliii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi xliv

246. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që (i) të krijohen politika dhe trajtime koherente për punonjësit në sistemin e prokurimit publik me qëllim të mënjanimin të ndryshimeve të punonjësve; (ii) të qartësohen dhe fuqizohen procedurat me qëllim për të pasur kriteret objektive për lidhjen e kontratave; (iii) të krijohen rregulla për parandalimin e konfliktit të interesit në prokurimin publik, duke përfshirë edhe deklarin e detyrueshëm të situatave të konfliktit të interesit nga anëtarët e paneleve të prokurimit, dhe (iv) të promovohen trajnime dhe specializime të mëtejme të përqëndruara në parandalimin dhe zbulimin e praktikave korruptive (paragrafi 498).*

247. Sipas autoriteteve të Kosovës, përveç neneve relevante të LPP-së nr. 04/L-042, që qartësojnë kriteret e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, KRPP – ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2014 mbi hartimin e specifikacioneve teknike për kontratat e punës që përmban udhëzime për autoritetet kontraktuese në përcaktimin e specifikimeve teknike për kontratat e punës në pakjtim me Nenin 27.1 (Dosja e Tenderit) dhe 28 (Specifikimet Teknike) të LPP-së. Përveç kësaj, Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2014 mbi Sigurinë e Tenderit, Ekzekutimit dhe Aplikimin e Kriterit Përzgjedhës Ekonomik dhe Financiar qartëson kriteret përzgjedhëse për kontratat e dhëna autoriteteve kontraktuese.

248. Autoritetet njoftojnë se trajtimi koherent i personelit në sistemin e prokurimit publik rregullohet me Ligjin mbi Shërbimin Civil. Me qëllim të mbrojtjes së zyrtarëve të prokurimit dhe shmangjes së stafit të cilët punojnë në fushën e prokurimit publik, KRPP ka përgatitur disa amendamente për ligjin PP të cilat do t'i adresojnë këto çështje.

249. Kodi i Etikës i Prokurimit si pjesë e legjislacionit sekondar (pjesa D) përfshin një detyrim për të deklaruar konfliktet e interesit nga anëtarët e paneleve të prokurimit¹⁹. Përveç kësaj, KRPP është pranë finalizimit të nxjerrjes së një rregullore mbi konfliktin e interesit në prokurimin publik.

¹⁷ Për shkak të skadimit të mandatit të anëtarëve, Bordi i OSHP-së ka pushuar së ekzistuari me 31 korrik 2013. Kuvendi ka arritur t'i zgjedhë anëtarët e rinj vetëm me 21 mars 2014 (rreth 8 muaj më vonë).

¹⁸ Pas konstituimit të Bordit të ri të OSHP-së të gjitha ankesat e parashtruara pas dates 21 mars 2014 janë rishikuar sipas dispozitave ligjore.

¹⁹ Në lidhje me OSHP, çështja është e rregulluar me Nenin 12 të Rregullave të Procedurës së OSHP-së.

250. LPP parasheh nivele themelore dhe të avancuara të trajnimit për zyrtarët publik të cilët janë të përfshirë në aktivitete të prokurimit. Këto trajnime po ashtu fokusohen në parandalimindhe zbulimin e praktikave korruptive. Gjatë vitit 2013, 576 zyrtar të prokurimit i janë nënshtruar trajnimit të avancuar, ndërsa 428 kanë kaluar testin dhe iu janë dhënë çertifikata valide për prokurim publik me kohëzgjatje prej tre vitesh. 111 pjesëmarrës të tjerë (9 nga minoritetet) pritët të çertifikohen përdërisa 60 pjesëmarrës janë çertifikuar sipas komponentës bazike. Përveç kësaj, KRPP ka miratuar një strategji trajnimi në fushën e prokurimit publik për 2014-2018.

251. KRPP ka miratuar një memorandum të mirëkuptimit me Odën Ekonomike të Kosovës me qëllim të ofrimit të trajnimeve të prokurimit publik për operatorët publik. KRPP po ashtu organizon trajnime për operator komercial, gjyqtar, prokuror, OJQ, media, auditor etj.

252. Ekipi i Vlerësimit merr shënim informacionin e ofruar dhe disa masa që synojnë adresimin e disa aspekteve të rekomandimit. Megjithatë, ai nuk mund ta vlerësojë zbatimin e dy aspekteve të para të rekomandimit në mungesë të një informacioni më relevant. Përveç kësaj, Ekipi i Vlerësimit vëren se duhet informacion më konkret për vlerësimin e aspekteve të tjera të mbetura të rekomandimit.

253. Prandaj, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xlv është zbatuar pjesërisht.

3. Ligji penal, zbatimi i ligjit dhe procedura penale

3.1 Veprat penale dhe sanksionet

Rekomandimi xlv

254. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren masa juridike për t'i mbuluar drejtpërdrejt përfituesit e tretë në nenet 429 dhe 430 të KP në lidhje me ryshfetin aktiv (paragrafi 524).*

255. Ekipi i Vlerësimit rikujton se arsyeja për këtë rekomandim ka qenë sepse nenet në lidhje me korrupsionin aktiv (Nenet 429 dhe 430 të KP) nuk i përfshijnë drejtpërdrejt situatat ku përfshihen përfituesit palë të treta - për shembull, kur ryshfeti i jepet jo vetë personit zyrtar, por gruas së tij ose një personi tjetër në kundërshtim me Konventën e së Drejtës Penale mbi Korrupsionin (STE Nr. 173) "për veten e vet apo për dikënd tjetër", dhe në kundërshtim me Nenin 428 të KP në lidhje me korrupsionin pasiv, "për veten e vet apo për një person tjetër".

256. Autoritetet e Kosovës kanë raportuar që për momentin, sipas kornizës përkatëse që rregullon hartimin e legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë (në veçanti Rregullorja mbi Rregullat e Procedurës së Qeverisë Nr. 09/2011) organet të cilat merren me zbatimin e legjislacionit, mund të paraqesin propozime konkrete që synojnë ndryshimin e legjislacionit të aplikueshëm ose për hartimin e ligjit të ri.

257. Në lidhje me këtë, me 24.09.2014 autoritetet kanë adresuar me shkrim të gjitha institucionet gjyqësore (nr. 147/2014) dhe kanë kërkuar nga ato të ndërmarrin veprime konkrete për të hartuar koncept dokumente në pajtim me Rregulloren e Qeverisë (Neni 29), dhe autoritetet janë duke pritur që këto veprime të ndërmerren nga organet e gjyqësorit, për nevojat eventuale që ata mund të kenë për ndryshimin/amendamentimin e legjislacionit të aplikueshëm në fushën e drejtësisë.

258. Siç kanë deklaruar autoritetet më herët, është përsëritur se në rast të ndryshimeve, amendamenteve në legjislacionin e zbatueshëm pas propozimit të organit kompetent për zbatimin e tij, Ministria e Drejtësisë do të marrë parasysh rekomandimet e Projektit dhe do ta mirëpresë kontributin e ekspertëve të PECK.

259. Ekipi i Vlerësimit merr shënim për informacionin e ofruar dhe mirëpret veprimet e ndërmarrja. Ai beson se një konsideratë e kujdesshme do t'i jepet po ashtu edhe përmbajtjes së rekomandimit dhe masat e nevojshme do të ndërmerren për zbatimin e tij. Ekipi i Vlerësimit rikujton megjithatë se ky rekomandim kërkon amendamente/ndryshime në Kodin Penal.

260. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xlv nuk është zbatuar.

Rekomandimi xlvi

261. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që autoritetet të sigurojnë që të mos ketë zbrazëti në sistem, dhe nëse është e nevojshme, të ndërmarrin masa legjislative që veprat e mitos aktive dhe pasive në sektorin publik t'i mbulojnë të gjitha veprimet/mosveprimet në ushtrimin e funksioneve të zyrtarit publik, qofshin apo jo në kuadër të fushëveprimit të detyrave të zyrtarit (paragrafi 526).*

262. Ekipi i Vlerësimit rikujton se lloji i veprimeve për t'u kryer ose mos kryer nga zyrtari publik në kontekstin e veprës penale të ryshfetit duhet të bjerë "brenda punëve të tij/saj zyrtare" - nenet 428, 429 dhe 430 të KP. Nenet 428 dhe 429 përdorin formulimin: "të veprojë në pajtim me detyrën e tij/saj zyrtare" dhe neni 430 përdor: "të veprojë në ushtrim të detyrës së tij/saj zyrtare". Neni 120.2.2 e definon zyrtarin publik si në vijim: një person zyrtar vendor është personi i cili ushtron autoritet publik dhe personi zyrtar i huaj është çdo person që mban një detyrë legjislative, ekzekutive, administrative apo gjyqësore në shtetin e huaj. Sipas *Konventës Penale mbi Korrupsionin të Këshillit të Evropës*, lloji i akteve që duhet kryer duhet të jetë në ushtrim të **funksioneve të tij/saj**. Pyetja është nëse veprimet dhe mosveprimet të cilat janë plotësisht jashtë detyrave zyrtare apo kompetencave të veta ligjore, por të cilat ai/ajo ka mundësi t'i ushtrojë për shkak të funksionit që ka, do të mund të mbuloheshin direkt nga dispozitat e mitos (p.sh. dhënia e qasjes në informacion konfidencial në të cilin ka qasje zyrtari publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij/saj në situatat kur mbledhja apo shpalosja e informacionit të tillë nuk bien në mënyrë rigoroz brenda fushëveprimit të detyrave të zyrtarit në fjalë). Prandaj, Ekipi i Vlerësimit i fton autoritetet ta studiojnë këtë rekomandim më tutje dhe amendamentimet/ndryshimet potenciale në Kodin Penal.

263. Autoritetet e Kosovës nuk kanë dhënë informacion në këtë aspekt.
264. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xlvii nuk është zbatuar.

Rekomandimi xlvii

265. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislativë për të siguruar që korrupsioni në sektorin privat të penalizohet në përputhje me nenet 7 dhe 8 të Konventës Penale mbi Korrupsionin (STE Nr. 173) (paragrafi 539).*

266. Ekipi i Vlerësimit rikujton se arsyet për këtë rekomandim kanë qenë se nenet 315 dhe 316 në lidhje me ryshfetin në KP nuk kanë qenë në pajtim me kërkesat e Konventës (STE Nr. 173). Për shembull elementet e "ofrimit" dhe "pranimit të një oferte ose premtimi" mungojnë, "për veten e tij/saj apo për dikënd tjetër" mungon në nenet 315 dhe 316 KP, por shfaqet në paragrafin 2 të Nenit 315 KP ("për veten e tij/saj"), nocioni i "drejtpërdrejtë dhe tërthorazi" mungon në të dy dispozitat. Në lidhje me fjalët "të veprorë ose mos veprorë në ushtrimin e funksioneve të tij/saj", shprehet me fjalët "me qëllim të lënies anash të interesave të organizatës së tij të biznesit apo të personit juridik ose për t'i shkaktuar dëm organizatës së tillë të biznesit apo personit juridik me rastin e lidhjes së kontratës ose kryerjen e ndonjë shërbimi [ose pajtimit për të kryer një shërbim - 315.1 KP]" të cilat paraqiten vetëm në nenet 315.1 dhe 316.1 KP. Në lidhje me elementin e dashjes të të dy veprave penale, ai nënkuptohet me fjalët "në mënyrë që...të shkaktojë dëm..." apo "me qëllim të arritjes së ndonjë përparësie të paarsyetueshme". Përveç kësaj, formulimi i përdorur në të dy dispozitat është "gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike". Nuk është e qartë nëse kjo përfshin çdo person që punon në sektorin privat në çfarëdo cilësie.

267. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacion konkret në lidhje me këtë rekomandim.
268. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xlvii nuk është zbatuar.

Rekomandimi xlviii

269. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të shqyrtohet heqja e kërkesës për penalizim të dyfishtë në nenet 115 dhe 116 të KP në lidhje me veprat penale të korrupsionit që kryhen jashtë vendit (paragrafi 561).*

270. Ekipi i Vlerësimit rikujton se në Kosovë kërkohet parimi i kriminalizimit penal të dyfishtë dhe vepra duhet të përbëjë një vepër penale sipas ligjit në fuqi në vendin ku është kryer (shih Nenet 115.3 dhe 116, 1.2 KP). Në Nenin 17 (Juridiksioni) të Konventës Penale mbi Korrupsionin të Këshillit të Evropës (STE Nr. 173) një varg kriteresh janë përcaktuar në lidhje me juridiksionin mbi veprat penale. Sipas këtij Neni, kërkesa e veprës penale të dyfishtë nuk duhet të jetë pengesë për të ndjekur penalisht veprat penale të korrupsionit.

271. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacion konkret në lidhje me këtë rekomandim.
272. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xlviii nuk është zbatuar.

Rekomandimi xlix

273. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislativë për të siguruar që afatet kohore për hetimet të mos e pengojnë luftën efektive kundër korrupsionit (paragrafi 569).*

274. Ekipi i Vlerësimit rikujton se afati maksimal prej dy vite e gjysmë për hetime të rasteve të mëdha të ryshfetit duket të jetë i shkurtër, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e rasteve dhe vështirësitë në identifikimin e kryesve. Duke e pranuar se afati i shkurtër mund të jetë i dëshirueshëm në kontekstin e korrupsionit të vogël, *afati prej dy vite e gjysmë duket qartazi i pamjaftueshëm në rastet e mëdha dhe komplekse*, sidomos kur këto raste kanë lidhje me jashtë. Kjo mund të shmanget duke e zgjatur afatin për hetime në rastet e mëdha të korrupsionit.

275. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacion konkret në lidhje me këtë rekomandim.

276. Megjithatë, duke pasur parasysh raportin e fundit monitorues mbi parashkrimin e hetimeve penale dhe ekzekutimin e dënimeve në gjykatat themelore të Kosovës për periudhën 2001-2013²⁰, Ekipi i Vlerësimit është i brengosur në lidhje me prirjen kritike dhe numrin e madh të rasteve që janë parashkruar (2,230 raste penale në vitin 2013 që përfaqësojnë vetëm numrin më të madh vjetor të ndjekur nga 1,860 raste në periudhën e vitin 2011-2012²¹). Në mesin e rasteve të identifikuar si të parashkruara, ekzistojnë raste të korrupsionit të cilat mbulohej nga Kreu 29 i KP mbi "Veprat Penale kundër Detyrës Zyrtare" (11 raste sipas parashkrimit relativ dhe 24 raste sipas atij absolut). Në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, nga 72 raste të hetuara gjatë vitit 2013 kundër gjyqtarëve të cilët nuk kanë iniciuar procedura, 64 janë hedhur sepse ata nën përgjegjësinë e të cilëve bijnë këto raste nuk i ushtrojnë më funksionet e gjyqtarit. Rreth gjysma e numrit të përgjithshëm të këtyre rasteve i takon dy gjykatave themelore dhe vetëm një dege. Ekziston po ashtu edhe rreziku i vazhdimësisë së prirjes edhe në të ardhmen.

277. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi xlix nuk është zbatuar.

Rekomandimi I

278. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislativë për të siguruar shfuqizimin e mundësisë së paraparë përmes mbrojtjes së veçantë të pendimit efektiv për t'ia kthyer ryshfetin dhënësit të ryshfetit që e raporton veprën penale para se ajo të zbulohet (paragrafi 572).*

279. Ekipi i Vlerësimit rikujton se, sipas nenit 316(4), shpërblimi ose dhurata i kthehen personit në rastet e ryshfetit aktiv privat, kur gjykata gjen se kërkesat për pendim efektiv janë plotësuar, gjë që është në kundërshtim me praktikën e GRECO-s në këtë fushë.

280. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacion konkret mbi ndryshimet në lidhje me këtë rekomandim.

281. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi I nuk është zbatuar.

Përgjegjësia e personave juridikë

Rekomandimi li

282. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që të fuqizohen funksionet kontrolluese të regjistrimit të ndërmarrjeve me qëllim që të sigurohet se personat fizikë si dhe ata juridikë të cilët themelojnë kompani të kontrollohen dhe të monitorohen në lidhje me historitë e mundshme penale dhe diskualifikimet profesionale apo edhe informatave të tjera përkatëse mbi personat juridikë gjatë procesit të regjistrimit (paragrafi 580).*

283. Ekipi i Vlerësimit rikujton se në mënyrë që lufta kundër korrupsionit të bëhet më efektive, çdokush që aplikon për regjistrim të një kompanie duhet të kontrollohet në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës për çfarëdo historiku të kaluar të mundshëm kriminal, kufizim të të drejtave si p.sh. privim të përkohshëm ose çfarëdo informacioni tjetër që e bën regjistrimin e tillë problematik.

284. Autoritetet e Kosovës raportojnë se Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës nuk ka ndërmarrë asnjë hap në zbatimin e Rekomandimeve li, par. 262, 264, 265, 266, prandaj Agjencia nuk ka ndonjë amendamentim të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare, dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të siguruar se personat fizik dhe juridik të cilët themelojnë biznese monitorohen në lidhje me prapavijën e tyre potenciale kriminale dhe diskualifikimet profesionale apo informacionet e tjera.

285. Ekipi i Vlerësimit merr shënim informacionin e ofruar. Ajo beson se konsideratë e kujdesshme do t'i jepet kërkesave të rekomandimit dhe masat e nevojshme do të ndërmerren për të qenë në pajtim me të.

²⁰ Për më shumë informacion, shih www.cohu.org

²¹ 10,504 raste rezultojnë të jenë të parashkruara për periudhën 2001 deri në 2013: 55% e rasteve i takojnë formës absolute, 31% formës relative të parashkrimit ndërkohë që 14% janë raste të cilat nuk janë kategorizuar ose u referohen ekzekutiveve.

286. Duke qenë se nuk është bërë asnjë progres konkret deri më tani në lidhje me themelimin e një grupi punues për ndryshimin e ligjit, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi li nuk është zbatuar.

Rekomandimi lii

287. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislativë për të siguruar që subjektet juridike të mund të konsiderohen përgjegjëse jo vetëm në situatat kur do të mund të dënohej personi fizik, duke i përfshirë situatat kur përgjegjësia bazohet në mungesën e mbikëqyrjes, por gjithashtu edhe në situatat kur nuk është e mundur të vërtetohet përgjegjësia e personit fizik për veprën penale (paragrafi 584).*

288. Ekipi i Vlerësimit rikujton se në Kosovë përgjegjësia e personave juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës. Prandaj, nuk është e qartë nëse personi juridik do të jetë përgjegjës në rrethanat kur përgjegjësia bazohet në mungesën e mbikëqyrjes dhe do të jetë e vështirë t'i atribuohet përgjegjësia e personit juridik në rastet kur personi fizik përgjegjës për veprën penale nuk identifikohet.

289. Përveç informacionit të referuar në paragrafët 252 deri në 254 më lart, autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacione konkrete në lidhje me këtë rekomandim. Ky rekomandim kërkon amendamente/ndryshime në Kodin Penal.

290. Ekipi i Vlerësimit përfundon rekomandimi lii nuk është zbatuar.

Rekomandimi liii

291. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që autoritetet e Kosovës të ndërmarrin hapat e nevojshëm për ta siguruar dhe për ta përmirësuar zbatimin praktik të kësaj mase si mjet për sanksionimin e veprimtarisë penale (paragrafi 585).*

292. Ekipi i Vlerësimit rikujton se ky rekomandim kërkon që autoritetet e Kosovës të sigurojnë që çdoherë që kundër një personi fizik ngrihet një aktakuzë duhet të merret parasysh që të mbahet penalisht përgjegjës edhe personi juridik.

293. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacion në lidhje me këtë rekomandim.

294. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi liii nuk është zbatuar.

Rekomandimi liv

295. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që Kosova ta shqyrtojë mundësinë që të kërkojë prej auditorëve të jashtëm që ata t'i raportojnë tek menaxhmenti aktet e dyshuara të mitos, ose nëse menaxhmenti nuk reagon apo nëse menaxhmenti është vetë i përfshirë, që t'i raportojnë ato tek autoritetet kompetente të pavarura prej kompanisë, siç janë autoritetet e zbatimit të ligjit apo autoritetet rregullative, dhe, kur të jetë e nevojshme, të sigurojnë që auditorët që i bëjnë ato raportime në mënyrë të arsyeshme dhe në mirëbesim të mbrohen prej veprimeve juridike (paragrafi 593).*

296. Ekipi i Vlerësimit rikujton se ka qenë mendimi i bashkëbiseduesve të takuar gjatë vizitës në terren se auditorët nuk kanë detyrim të raportojnë aktivitetin kriminal në kompani tek policia.

297. Ekipi i Vlerësimit rikujton gjithashtu se ky rekomandim kërkon konsiderata dhe amendamente/ndryshime të mundshme në legjislacion.

298. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacion në lidhje me këtë rekomandim.

299. Në mungesë të informacioneve, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi liv nuk është zbatuar.

3.2. Hetimet dhe procedura penale

Rekomandimi Iv

300. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren hapa për mbledhjen e informatave dhe statistikave të nevojshme dhe të detajuara, duke përfshirë të gjitha aspektet e rasteve të korrupsionit prej fillimit deri në fund (përfshirë edhe rezultatin e rastit), me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të hetimeve/ndjekjes penale (paragrafi 612).*

301. Organi përgjegjës për mbledhjen, procesimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare statistikore është Agjencia Statistikore e Kosovës (ASK). Agjencia operon që nga viti 1948 dhe aktualisht rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-036 mbi Statistikat Zyrtare në Kosovë. Plani i Zhvillimit Strategjik i AKS-së 2009-2013 përcakton qëllimet dhe prioritetet afatmesme për përmirësimin e kualitetit dhe konsistencës së sistemit statistikor duke i harmonizuar metodologjitë dhe standardet vendore në raport me standardet statistikore të Bashkimit Evropian (EUROSTAT).

302. Misioni i Agjencisë është që të përmbushë kërkesat e përdoruesve për të dhëna statistikore të cilësisë së lartë, objektive dhe të dorëzura në kohë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme për të bërë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit të projekteve në nivel komunal dhe të shtetit; për të përkrahur institucionet qeveritare, institucionet shkencore, institucionet kërkimore akademike, komunitetin e biznesit, me qëllim të dhënies së informacionit të duhur për vendimarrësit dhe përdoruesit e tjerë në Kosovë. Sipas Rregullorës nr. 01/2013 mbi Riorganizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Pozitave të Punës në Agjencinë e Kosovës për Statistika, një prej departamenteve në Agjencinë e Kosovës për Statistika, Divizioni i Statistikave Sociale, është mes tjerash, përgjegjës për mbledhjen, procesimin, analizimin dhe publikimin e statistikave mbi: *2.4 të dhënat mbi shëndetin, mirëqenien sociale, arsimin, jurisprudencën, papunësinë dhe të dhënat e tjera në fushën sociale.*

303. Përveç kësaj, Koordinatorin e ri i caktuar për Luftimin e Krimit Ekonomik brenda KPK do të koordinojë statistikave dhe mbledhjen e informacionit. Në nëntor 2013, KPK ka aprovuar një plan strategjik për bashkëpunim ndër-institucional për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Një bazë e të dhënave (mekanizëm për përcjellje) është vendosur në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor, policinë dhe agjencitë tjera. Qëllimi është të sigurohet rishikimi i hetimeve, ndjekjeve penale dhe vendimeve përfundimtare të gjykatës në rastet që ndërlidhen me veprat penale të krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me armë, trafikimit me narkotikë dhe pastrimit të parave.

304. Më 26-27 shkurt të vitit 2014, Projekti PECK organizoi në Prishtinë një punëtori dyditore mbi mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e statistikave për qëllime të vlerësimit. Nevoja për një punëtori të tillë ka dalë nga të gjeturat e Raporteve të Vlerësimit të Ciklit të 1-rë të PECK mbi përputhshmërinë e Kosovës me standardet ndërkombëtare në fushat e LKK dhe LPP/LFT. Punëtorja ka sjellë së bashku rreth 50 përfaqësues të të gjitha institucioneve përkatëse, përfshirë 7 gjykatat dhe prokuroritë themelore në Kosovë, dhe ka mundësuar diskutimin dhe shkëmbimin mbi gjendjen aktuale në lidhje me statistikave në çdo institucion përkatës, dhe praktikën e mira në prodhimin e statistikave të besueshme dhe të unifikuara për krimin ekonomik bazuar në praktikën holandeze dhe britanike. Deri më tani, agjencitë e ndryshme përgjithësisht janë duke numëruar informacione mbi krimet dhe rastet në mënyra të ndryshme. Ata prodhojnë të dhëna vetanake në frekuenca të ndryshme periodike dhe në afate të ndryshme. Për të lejuar krahasimin e duhur dhe kuptimplotë është me rëndësi që institucioni statistikor të përcaktojë frekuencën dhe periudhën raportuese për të gjitha publikimet e statistikave zyrtare dhe të pajtohet me të gjitha organet e tjera në lidhje me këto frekuenca dhe periudha. Përveç kësaj, institucionet e përfshira duhet të pajtohen mbi metodologjinë e njejtë dhe bazat e njësive për numërim.

305. Një sistem i menaxhimit të rasteve (SMR) cili do të prezantohet me përkrahje financiare të Norvegjisë; megjithatë nuk është blerë ende dhe zbatimi do të zgjasë deri në vitin 2017. Përdorimi i SMR-së do të jetë i detyrueshëm dhe zbatimi i tij do të mund të sigurohet përmes masave disiplinore. Përveç menaxhimit të bashkërenduar të statistikave, pritet që SMR të përfshijë caktimin e lëndëve tek gjyqtarët. Përveç kësaj, SMR do të jetë i vlefshëm edhe për publikimin e vendimeve të gjykatës duke pasur parasysh faktin se vetëm vendimet e Gjykatës Supreme publikohen deri më sot. Ky sistem mund të jetë një mjet thelbësor për të vlerësuar edhe prirjen e krimit si dhe efektshmërinë e sistemit.

306. Ekipi i Vlerësimit merr shënim informacionin e ofruar. Megjithatë, është e paqartë çfarë të dhënash do të mbledhen, cili/at institucion(e) do të merren me informacionin dhe sipas cilave

rregulla. Përveç kësaj, ai vëren se bashkëpunimi në mes të institucioneve përgjegjëse për statistika duhet të qartësohet për të siguruar, mes të tjerash, të dhëna të përputhshme statistikore, shmangje të konfliktit të kompetencave, ngritje të bashkëpunimit dhe mbikëqyrje të duhur. Mendimi i Ekipit të Vlerësimit është i tillë që përgjegjësia e zbatimit të këtij rekomandimi duhet të merret parasysh dhe të qartësohet. *Përgjegjësia për zbatimin duhet të përqëndrohet tek një person/institucion që duhet të ketë kompetenca ekskluzive për t'iu dhënë njësiteve të tjera përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave udhëzime të detyrueshme në lidhje me detyrat e tyre në këtë fushë.*

307. Ekipi i Vlerësimit mirëpret masat e marra nga autoritetet në pajtueshmëri me rekomandimin. Megjithatë, ai vëren se këto masa janë në fillim të zbatimit të tyre apo synohet të zbatohen në të ardhmen, kështu që mbetet për t'u parë se si ato do t'i adresojnë mangësitë e identikuara.

308. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi lv është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi lvi

309. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të fuqizohet Departamenti special kundër korrupsionit si në lidhje me kompetencën e këtij departamenti ashtu edhe në lidhje me rritjen e burimeve dhe bashkëpunimit midis prokurorëve, hetuesve dhe ekspertëve (paragrafi 615).*

310. Ekipi i Vlerësimit rikujton se shumë institucione të ndryshme merren me hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit. Nuk është e qartë nëse një rast duhet të trajtohet brenda policisë së zakonshme/sistemit prokurorial ose nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës, dhe nëse kështu, nëse duhet të trajtohet nga Task Forca Speciale kundër Korrupsionit. Sipas nenit 442 të KP, gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it që janë përgjegjës për procedurat penale kanë juridiksion dhe kompetencë mbi çdo rast që mund të hetohet apo ndiqet penalisht nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës. Në lidhje me veprat penale të korrupsionit, rezultoi nga Neni 441 i KP se Zyra e Prokurorisë Speciale ka kompetencë plotësuese për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të përcaktuara në të.

311. Ekipi i Vlerësimit rikujton më tutje se Neni 20 i Konventës Penale mbi Korrupsionin të Këshillit të Evropës (STE Nr. 173) kërkon nga Shtetet Palë të miratojnë masa të nevojshme për të siguruar që personat apo organet të specializohen në mënyrë të duhur në luftën kundër korrupsionit. Kjo kërkesë e specializimit nuk nënkupton të aplikohet në të gjitha nivelet e zbatimit të ligjit. Nuk kërkohet në veçanti që në çdo zyrë të prokurorisë apo në çdo stacion policor të ketë njësi speciale apo ekspert për veprat penale të korrupsionit. Një njësi e vetme e specializuar që merret me rastet e mëdha/të ndërlikuara të korrupsionit do të përmbushte kërkesën e Konventës. Kjo dispozitë nënvizon nevojën e një lufte efektive kundër korrupsionit duke trajnuar mjaftueshëm njësitet apo stafin e zbatimit të ligjit. Përveç kësaj, sipas Neni 21 të Konventës, bashkëpunimi me autoritetet e ngarkuara me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale është një aspekt i rëndësishëm i veprimit koherent dhe eficient kundër atyre të cilët kryejnë vepra penale të korrupsionit të definuara aty. Kjo dispozitë përfshin një detyrim të përgjithshëm për të siguruar bashkëpunimin e të gjitha autoriteteve publike me ata të cilët hetojnë dhe ndjekin penalisht veprat penale.

312. Autoritetet e Kosovës raportojnë se me 4 nëntor 2013 ka dalë një Plan i Veprimit mbi Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në luftën kundër korrupsionit. Qëllimi i këtij Plani të Veprimit ka qenë përkrahja e zbatimit të Planit Strategjik mbi Bashkëpunimin Ndërinstitucional në Luftën Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, përmes përkufizimit të aktiviteteve dhe veprimeve konkrete nga Prokuroria Speciale e Kosovës dhe prokuroritë themelore në lidhje me rastet e korrupsionit. Planet e tjera të veprimit mundet po ashtu të përgatiten për zbatim të mëtutjeshëm të Strategjisë mbi Bashkëpunimin Ndërinstitucional në Luftën kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit.

313. Autoritetet e Kosovës kanë raportuar më tutje se me 4 nëntor 2013 zyret e prokurorisë në tërë Kosovën kanë numrin si në vijim të rasteve të cilat janë në fazën e hetimit të procedurës penale (domethënë, ende presin për veprime të Prokurorit për ta hedhur poshtë kallëzimin penal, përfunduar, pezulluar hetimet apo ngritur aktakuzë): 482 raste që përfshijnë 1 396 persona dhe 164 informacione që përfshijnë 342 persona. Në tërë Kosovën në vitin 2013, gjykatat kanë sjellë vendime në rastet e korrupsionit kundër 23 personave, kundër të cilëve janë ngritur aktakuzat, 22 prej tyre janë shpallur fajtorë, ndërsa kundër një personi gjykata ka hedhur poshtë aktakuzën pas gjykimit kryesor. Nuk ka qenë e mundur të merret më shumë informacion as në lidhje me rastet as për sanksionet/dënimet.

314. Një udhëzim i datës 13/11/2013 i lëshuar nga Prokurori i Shtetit i Kosovës trajton çështjen nëse një rast i korrupsionit duhet të konsiderohet si një korrupsion i nivelit të lartë dhe e përcakton se një rast i tillë i korrupsionit duhet të trajtohet brenda PSRK-së.

315. Autoritetet e Kosovës raportojnë se PSRK-ja, një organ i përhershëm dhe i specializuar prokurorial brenda Prokurorisë së Shtetit të Kosovës, është zyre prokuroriale unike e përbërë nga Prokuror dhe staf mbështetës, vendor dhe të EULEX-it. Brenda EULEX-it është i përfshirë një numër i stafit mbështetës vendor. Në fillim të muajit maj 2013, PSRK është përbërë nga 10 prokuror vendor dhe 5 të EULEX-it. Sipas informacionit të raportuar në tetor 2013, PSRK është përbërë nga 18 prokuror (5 prokuror të EULEX-it). 6 prokurorë të rinj i janë bashkuar PSRK-së që nga 1 nëntori i vitit 2013. PSRK-ja komunikohet me Policinë, Doganat, ATK-në, AKK-në, NjIF-in dhe personat apo entitetet e tjera të ndërlidhura me rastet që raportohen tek PSRK-ja. Është planifikuar rritja e mëtutjeshme e burimeve²².

316. Që nga fillimi, Prokuroria Speciale është vendosur në një ndërtesë të Policisë, me hapësira të pamjaftueshme për të gjithë të punësuarit. Ka pasur (ende ka) nevojë për hapësirë shtesë në mënyrë që të ketë të gjithë prokurorët vendor dhe të EULEX-it dhe personelin e vendosur nën një kulm. Duke pas parasysh vendimin e KPK-së për rritjen e numrit të Prokurorëve, Sekretarëve Ligjor dhe Bashkëpunëtorëve Ligjor, paisjet shtesë për këta persona duhet po ashtu të ofrohen. Në takimin e mbajtur me 5 shtator 2014 KPK ka vendosur që ZPS së bashku me personelin vendor dhe personelin e EULEX-it të vendosen në ndërtesën E të Pallatit të Drejtësisë, që duhet të ofrojë kushte adekuate të punës për ZPS-në. Rialokimi është planifikuar të ndodhë në vitin 2015.

317. Një Marrëveshje e Bashkëpunimit mbi parimet bazë në lidhje me themelimin dhe operacionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimin Ekonomik është nënshkruar me 22 nëntor, 2013, me qëllim të rritjes së efikasitetit të ndjekjes penale të shkelësve, dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me veprë penale. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia kundër Korrupsionit dhe Agjencia e Inteligjencës.

318. Ekipi i Vlerësimit merr shënim informacionin e ofruar dhe mirëpret veprimet e marra në veçanti në lidhje me rritjen e burimeve dhe bashkëpunimit me akterët e tjerë në luftën kundër korrupsionit.

319. Megjithatë, sipas mendimit të Ekipit të Vlerësimit rastet e korrupsionit zakonisht trajtohen nga njësi të shumta të ndryshme. Ekziston policia/prokuroria lokale, Policia e Kosovës/Prokuroria ose Prokuroria Speciale, si dhe njësitet hetuese në Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës. Kur krahasohen shifrat nga Ekipi i Vlerësimit në lidhje me rastet në pritje me shifrat e vendimeve të gjykatës, mospërputhja mes këtyre numrave është aq e qartë sa që Ekipi i Vlerësimit ka bregua të mëdha nëse Plani i Veprimit i lartpërmendur mund të zgjidhë vetvetiu problemet në lidhje me efektshmërinë e luftës kundër korrupsionit (shih paragrafët 308 dhe më tutje më lart). Kur rastet e korrupsionit trajtohen nga aq shumë entitete në krahasim me numrin e popullsisë, nuk është e mundur ekzistimi i tërë specializimit dhe përvojës së nevojshme në çdo organ për t'u marrë me këto raste të vështira dhe të ndërliduara. Ekipi i Vlerësimit është i mendimit se organi i specializuar i PSRK-së, Task Forca Speciale kundër Korrupsionit, duhet të merret me rastet e korrupsionit në një masë më të madhe se sa deri më sot në vend që ato të trajtohen nga aq shumë entitete të ndryshme. Duket se nuk ka pasur asnjë zhvillim në lidhje me qartësimin e kompetencave dhe nuk ka pasur asnjë informacion për një bashkëpunim më të ngushtë në mes të prokurorëve, hetuesve dhe ekspertëve në rastet e korrupsionit. Nuk ka dyshim se efikasiteti i luftës kundër korrupsionit do të ishte më i madh me stafin që punon bashkë në baza ditore por që vazhdon të zhvillojë specializim në pajtim me fushat specifike apo aftësitë dhe përvojat përkatëse. Ky departament mund të kishte kompetencë të merret me rastet e korrupsionit për tërë Kosovën p.sh. jo vetëm në rastet e konsideruara si korrupsion i nivelit të lartë²³ por edhe në çfarëdo rasti të

²² KPK ka ngritur numrin e prokurorëve vendorë në 18. Nga këto pozita, janë plotësuar 13. KPK ka shpallë vende të lira pune për tre prokurorë shtesë. Shpallja është mbyllur me 3 tetor 2014.

²³ Udhëzimi i Përbashkët Administrativ i datës 13 nëntor 2014 që është bashkë-nënshkruar nga Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurori i EULEX-it dhe kreu i PSRK-së, ka definuar korrupsionin. Ky udhëzim parasheh raste të cilat do të mund të nxisnin kompetenca subsidiare (dytësore) të PSRK-së në pajtim me nenet 9, 10 dhe 11 të Ligjit të PSRK-së. Urdhërsa e njejtë u është dërguar të gjitha agjencive të zbatimit të ligjit në Kosovë.

Sipas tekstit të udhëzimit, një veprë penale e nivelit të lartë të korrupsionit konsiderohet:

1. Një nga veprat penale të përmendura aty (kryesisht ato në nenet 291(2), 316, 405(2), 406(2), 422 deri në 432, 435 dhe 436 të Kodit Penal- ato përfshijnë të gjitha format e rryshfetit, keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, keqpërdorimin në zyre, mbledhjen dhe shpërndarjen ilegale dhe përvetësimin ilegal të

rëndë siç për shembull rastet e ndërlikuara ku shumtë e rëndësishme ose konsiderata të tjera janë në lojë, apo raste të lidhura me krimin e organizuar, apo raste që përfshijnë politikanë, apo përdorimi i metodave të veçanta afariste, ose raste që kërkojnë hetime të gjera jashtë apo në çfarëdo rasti tjetër serioz.

320. *Nuk duket se ka zhvillime në lidhje me përforcimin e një entiteti qendror që merret në përgjithësi me rastet e korrupsionit në tërë Kosovën (qartësimi i kompetencës së PSRK-së), nuk ka pasur rritje të mjaftueshme të burimeve dhe nuk ka informacion konkret mbi një bashkëpunim më të ngushtë në mes të prokurorëve, hetuesve dhe ekspertëve në rastet e korrupsionit.*

321. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi Ivi nuk është zbatuar.

Rekomandimi Ivii

322. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislativë për të siguruar që pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë ankesë në lidhje me ndërprerjen e hetimeve (paragrafi 617).*

323. Ekipi i Vlerësimit tërheq vëmendjen në çështjen që lidhet me përfundimin e një rasti. Nëse prokurori vendos ta përfundojë/mbyllë hetimin, pala e dëmtuar nuk ka mundësi të bëjë ankesë tek një Prokuror më i lartë/Kryeprokurori i Shtetit. Mbyllja e një rasti është një vendim i rëndësishëm me pasoja të shumta. Sistemi është po ashtu më i pambrojtur në lidhje me korrupsionin kur i takon vetëm një personi të vendosë mbi ndërprerjen e një rasti.

324. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacion në lidhje me këtë rekomandim.

325. Prandaj, Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi Ivii nuk është zbatuar.

pronës gjatë një hetimi apo ekzekutimi të një vendimi gjyqësor); dhe një prej kushteve pasuese në pikat 2, 3 apo 4.

2. Subjekti i dyshuar për kryerjen e kësaj veprë është Presidenti i Kosovës, Kryeparlamentari apo deputeti, Kryeministri, zv. Kryeministri, dhe Ministri, Kryebashkiaku, gjyqtari i Gjykatës Supreme apo Gjykatës së Apelit, Kryeprokurori i Shtetit, Kryeprokurori - pavarësisht vlerës së veprës penale apo përfitimit.
3. Subjekti i dyshuar për kryerjen e këtij krimi është zv. Ministri, shërbyesi civil i nivelit të lartë (Sekretari Gjeneral dhe pozitat ekuivalente), punonjësit e Ministrisë dhe institucioneve publike në vendimmarrje dhe pozita këshilldhënëseë dhe nëse përfitimi apo dëmi i shkaktuar kalon 500,000 euro.
4. Një veprë penale do të konsiderohet si korrupsion i nivelit të lartë në çdo rast ku përfitimi apo dëmi i shkaktuar kalon 1,000,000 euro.

Ky udhëzim duhet për pasojë të ndryshohet në mënyrë që të plotësojë kërkesat e rekomandimit.

3.3. Konfiskimi dhe mohimi tjetër i dobive pasurore dhe i të ardhurave nga krimi

Rekomandimi lviii

326. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar që (i) të themelohet një entitet në kuadër të strukturës ekzistuese me theks të posaçëm për identifikimin, gjurmimin dhe ngrirjen e të ardhurave nga krimi; dhe (ii) të rritet efektiviteti i sistemit përmes themelimit të standardeve të detyrueshme për zbatim të ligjit në ndjekjen e fondeve të mjeteve të jashtëligjshme për hetimet e veprave penale që gjenerojnë të ardhura nga krimi (paragrafi 636).*

327. Autoritetet e Kosovës raportojnë se Kryeprokurori i Shtetit ka lëshuar më 14/01/2014 një Direktivë në lidhje me veprimet e prokurorëve për të gjithë prokurorët e shtetit në lidhje me pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara përkohësisht, apo pronën për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirje. Në të njëjtën kohë, një udhëzim i thjeshtuar është bërë për prokurorët në lidhje me konfiskimin në Kosovë. Në këtë udhëzim përkrahur detyrat e prokurorëve. Ekzistojnë tri fusha të konfiskimit të cilat prokurorët duhet t'i marrin parasysh: së pari çfarëdo instrumentalitetesh të përdorura në kryerjen ose ofrimin e ndihmës në kryerjen e veprës penale, së dyti çfarëdo mjete të ndaluar të zbuluar (armë, kontrabandë), së treti çfarëdo përfitimi material të identifikuar. Në të gjitha rastet, udhëzimi këshillon prokurorët të ndjekin hapat e identifikimit, bllokimit dhe konfiskimit.

328. Ekipi i Vlerësimit mirëpret veprimet e marra dhe i nxit autoritetet të sigurojnë se ky udhëzim shumë i vlefshëm të ndiqet për zbatim. *Megjithatë, ai nuk ka informacion në lidhje me veprimet e ndërmarra për të themeluar një njësi speciale brenda strukturës ekzistuese me referencë të veçantë në identifikimin, gjurmimin dhe ngrirjen e pasurive të fituara nga krimi.*

329. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi lviii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi lix

330. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të sigurohet që sendet që planifikohen të përdoren në ndonjë vepër penale të mund të konfiskohen si dhe të zgjerohet fushëveprimi i dispozitave për konfiskimin e dobive pasurore dhe i të ardhurave nga krimi në mënyrë që të ofrohen mundësi më të mira për përdorimin efektiv të konfiskimit në rastet e korrupsionit (paragrafi 637).*

331. Autoritetet e Kosovës kanë raportuar se Ligji i ri nr. 04/L-140 mbi Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale ka hyrë në fuqi me 11 shkurt 2013. Ai parasheh mundësinë e konfiskimit të:

- Pasurive që i nënshtrohen kompetencave të zgjeruara të konfiskimit të cilat nuk janë dobi pasurore nga vepra penale e përshkruar në aktakuzë (Neni 6);
- Pasurive që i nënshtrohen kompetencave të zgjeruara të konfiskimit të fituara nga i pandehuri i cili ka vdekur (Neni 7);
- Pasurive që i nënshtrohen kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, të fituara nga i pandehuri i cili është larguar nga Kosova (Neni 8);

Dispozitat e këtij ligji mund të zbatohen për pasurinë e cila i është bartur palës tjetër nga personi i cili është apo bëhet i pandehur apo i dënuar. Pala tjetër ka të drejtë për të provuar se është blerës *bona fide* i pasurisë. Pasuria nuk mund të konfiskohet nga blerësi *bona fide* i asaj pasurie.

332. Ekipi i Vlerësimit merr shënim në lidhje me informacionin e ofruar. Megjithatë, ky ligj nuk i zgjidh problemet e përmendura në Raportin e Vlerësimit të PECK (paragrafi 637) në lidhje me kufizimet e imponuara nga KPP në nenin 278 në krahasim me mundësitë për të konfiskuar në pajtim me nenin 96 të KP (konfiskimi i përfitimeve materiale të transferuara tek personat e tretë), konfiskimi vetëm i materialit, kur gjendet (in rem), dhe konfiskimi i objekteve që synohen të përdoren. Përveç kësaj, Ligji mbi Kompetencat e Zgjeruara nuk është i qartë në nenin 13 kur thuhet se "me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dispozitat që bien në kundërshtim me Ligjin do të shfuqizohen". Për hir të qartësisë ligjore, dispozitat e veçanta të shfuqizuara duhet të identifikohen dhe përmenden drejtpërdrejt në këtë dispozitë.

333. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi lix nuk është zbatuar.

3.4. Imuniteti nga hetimi, ndjekja ose dënimi i veprave penale të korrupsionit

Rekomandimi Ix

334. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren hapa për të siguruar që të mos merret parasysh periudha kur hetimi nuk mund të kryhet në afatin kohor për hetim (paragrafi 647).*

335. Ekipi i Vlerësimit rikujton se *ky rekomandim kërkon amendamente/ndryshime në legjislacion*. Siç përmendet në paragrafin 647 të Raportit të Vlerësimit, Neni 157 KPK parasheh bazë ligjore për pezullimin e hetimeve. Përveç çrregullimeve të përkohshme mendore apo paaftësive, apo ndonjë sëmundje tjetër serioze dhe ikjes së të pandehurit, nuk është e qartë nëse formulimi "rrethanat e tjera të cilat e pengojnë përkohësisht ndjekjen e suksesshme penale të të pandehurit" mund të ofrojë bazë për pezullimin e kohës së kufizuar për hetime.

336. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar informacion në lidhje me këtë rekomandim.

337. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi Ix nuk është zbatuar.

4. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Rekomandimi Ixi

338. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren hapa për mbledhjen e informatave dhe statistikave të duhura dhe të detajuara që i përfshijnë të gjitha aspektet e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike që nga fillimi e deri në fund, në mënyrë që të vlerësohet efikasiteti i dhënies së ndihmës së ndërsjellë juridike; dhe (ii) të aplikohen standarde të shërbimit rreth kohës së kthimit të kërkesave të jashtme për ta garantuar efektivitetin e sistemit (shih raportin e vlerësimit kundër pastrimit të parave) (paragrafi 659).*

339. Autoritetet e Kosovës kanë njoftuar se janë nënshkruar disa marrëveshje ndërkombëtare gjatë vitit 2013/2014:

- Marrëveshja e Ekstradimit me Italinë (e publikuar më 19.11.2013);
- Marrëveshja për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale me Italinë (publikuar më 19 nëntor 2013)
- Marrëveshja me Hungarinë për bashkëpunimin në parandalimin dhe luftimin e krimit (publikuar më 6 shtator 2013)
- Marrëveshja për Bashkëpunimin Policor në Luftën kundër Krimit me Zvicrën (Palët e Kosovës: PK, DK dhe NjIF) publikuar më 13 mars 2014.

340. Autoritetet e Kosovës informojnë më tutje se janë mbledhur statistika në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike gjatë vitit 2013, ku Kosova ka pranuar dhe procesuar një total prej 8,778 kërkesave dhe përgjigjeve në lidhje me rastet e hapura dhe rastet e reja, përfshirë çështjet e ekstradimit. Rastet specifikohen në kategori të ndryshme dhe vendet në fjalë janë listuar.

341. Ekipi i Vlerësimit i mirëpret veprimet e ndërmarra dhe statistikave të mbledhura, megjithatë ai ka mendimin se ato nuk i adresojnë të gjitha mangësitë e identifikuara në Raportin e Vlerësimit (paragrafi 659). *Informacioni i ofruar nuk përmban të gjitha këndet e një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike nga fillimi deri në fund, në mënyrë që të vlerësohet efikasiteti i dhënies së ndihmës së ndërsjellë juridike, e as nuk përfshin standarde të reja të mundshme të shërbimeve për kohën e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave të huaja në mënyrë që të garantohet efektshmëria e sistemit.*

342. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi Ixi është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi Ixii

343. *Ekipi i Vlerësimit ka rekomanduar të ndërmerren hapa për të siguruar që ndihma e ndërsjellë juridike në përputhje me rregullat e Konventës Penale mbi korrupsionin (STE Nr. 173) jepet në rastet e korrupsionit, pavarësisht asaj që Kosova nuk ka një detyrim të tillë ligjor (paragrafi 660).*

344. Autoritetet e Kosovës raportojnë se Ligji Nr. 04/L-213 i datës 31/07/2013 për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale ka hyrë në fuqi më 31 korrik 2013.

345. Ekipi i Vlerësimit merr shënim informacionin e ofruar. Neni 1 paragrafi 3 i ligjit parasheh parimin e reciprocitetit si bazë për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar. Ai thotë se "në mungesë të një marrëveshje ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe shtetit tjetër, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar duhet të administrohet mbi baza të parimit të reciprocitetit". Megjithatë, ky ligj nuk përmban asnjë përjashtim nga rregulla e përgjithshme në lidhje me rastet e korrupsionit. Përveç kësaj, *nuk është ofruar asnjë informacion nëse duhet të bëhet një përjashtim i brendshëm në këto situata.*

346. Ekipi i Vlerësimit përfundon se rekomandimi Ixii nuk është zbatuar.

III. PËRFUNDIME

347. Në bazë të përfundimeve të Raportit të Monitorimit (dy rekomandime të zbatuara - xxxii and xxxviii) dhe të gjetjeve të parashtruara më lart, Ekipi i Vlerësimit përfundon se Kosova ka zbatuar më tej kënaqshëm ose adresuar në mënyrë të kënaqshme vetëm 45 prej 62 rekomandimeve të përmbajtura në Reportin e Vlerësimit të PECK. Rekomandimet xxxii, xxxv, xxxviii dhe xli janë zbatuar kënaqshëm; dhe rekomandimi xviii është trajtuar në mënyrë të kënaqshme rekomandimet iii, vii, viii, ix, xii, xliii, xiv, xv, xvi, xvii, xviii, xix, xx, xxi, xxv, xxvi, xxxi, xxxiii, xxxv, xxxvii, xxxix, xlii, xliii, xlv, lv, lviidhe lxi janë zbatuar pjesërisht dhe rekomandimet i, ii, iv, v, vi, x, xi, xix, xxii, xxiii, xxiv, xxvii, xxviii, xxix, xxx, xxxvi, xl, xlv, xlvi, xlvi, xlvi, xlvi, xlvi, xlix, l, li, lii, liii, liv, lvi, lvii, lix, lx dhe lxii nuk janë zbatuar.

348. Në përgjithësi, niveli i përputhshmërisë me rekomandimet e Raportit të Vlerësimit është i ulët. Autoritetet e Kosovës nuk kanë zbatuar fare ose kanë zbatuar pjesërisht pjesën më të madhe të rekomandimeve shumica e të cilave kërkojnë ndryshimin ose miratimin e legjislacionit relevant kryesor, përderisa të tjerat thërresin për zbatim efikas në praktikë të legjislacionit relativisht të ri. Megjithatë, disa përpjekje janë bërë për të adresuar mangësitë e identifikuara. Në veçanti, kërkesat aktuale ligjore që detyrojnë KQZ-në të publikojë dhe mbajë të publikuara të gjitha raportet vjetore financiare të partive politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të partive politike në faqen e tij të internetit, i kontribuojnë nivelit të përmirësuar të transparencës me kusht që ato të zbatohen. Ngjashëm, publikimi i raporteve vjetore financiare së bashku me raportin përfundimtar të auditimit si një obligim i detyrueshëm për partitë politike, prezantimi i përkufizimit dhe rregullorës për entitete që ndërlidhen me një parti politike, vendosja e rregullave në lidhje me specializimin, pavarësinë dhe know-how/ekspertizën e auditorëve të thirrur për të audituar llogaritë e partive politike dhe kandidatëve si dhe prezantimi i publikimeve të detyrueshme periodike përbëjnë disa masa pozitive të ndërmarrë. Përveç kësaj, autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë masa për të miratuar udhëzime për policinë në lidhje me aprovimin e angazhimeve të jashtme.

349. Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë hapa të pjesshëm për të rishikuar dhe qartësuar kornizën ligjore për parandalimin e konflikteve të interesit edhe pse procesi i rishikimit ligjor nuk është përfunduar ende. Në lidhje me masat që synojnë përforcimin e mbrojtjeve themelore dhe parandalimin e korrupsionit në lidhje me gjyqtarët dhe prokurorët, masat e zbatuara pjesërisht kanë të bëjnë mes tjerash me : hapat për të siguruar funksionimin e duhur të caktimit me short të rasteve në gjykata; masat për ta vendosur një sistem transparent dhe të unifikuar të mbajtjes dhe qasjes së informacionit në dosjet e rastit; përpjekjet për të azhurnuar rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtarë, përpjekjet për ta përmirësuar bashkëveprimin në mes të AKK-së dhe Prokurorëve, si dhe gjyqtarëve në procedura për kundërvajtje dhe vepra penale përmes procedurave standarde të operimit; miratimin dhe zbatimin e procedurave të verifikimit për gjyqtarët, udhëzime në lidhje me miratimin e angazhimeve të jashtme dhe aktiviteteve përjashtimore dhe vendosjen e marrëdhënieve më të mira në mes të ZPD-së dhe KPK-së në lidhje me hetimet disiplinore dhe penale ndaj prokurorëve.

350. Sa i përket masave parandaluese në Polici, autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë hapa për të prezantuar kritere objektive dhe transparente për emërimin/shkarkimin e menaxhmentit dhe zyrtarëve të lartë të Policisë së Kosovës dhe përforcimin e kapaciteteve njerëzore të organeve relevante disiplinore dhe të brendshme të policisë, dhe mbajtjen e shënimeve të besueshme të veprimeve disiplinore dhe të tjera në lidhje me zyrtarët e policisë.

351. Ngjashëm, disa masa të vazhdueshme dhe iniciativa synojnë t'i adresojnë pjesërisht masat e transparencës në administratën publike (në veçanti instrumentet që kanë të bëjnë me e-qeverisjen dhe qasjen në dokumentet publike), përforcimi i deklaratimit të pasurive dhe interesave dhe shtrirjen e standardeve adekuate dhe të zbatueshme të konfliktit të interesit, për çdo zyrtar publik, si dhe masat e rotacionit në sektorët e administratës publike në veçanti atyre të ekspozuara ndaj rrezikut të korrupsionit.

352. Përveç kësaj, në lidhje me financimin e partive politike, autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë disa masa që synojnë mes të tjerash harmonizimin e dispozitave ligjore mbi subjektet politike dhe financimin e fushatave në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm për kandidatët e tjerë për zgjedhje, rishikimin e përkufizimit të një "kontributi" për një parti politike, vendosjen e kushteve më të sakta për kërkesat e raporteve financiare dhe afateve të publikimit, për të unifikuar format e raportimit të partive, në veçanti në lidhje me përmbajtjen, periudhën e dorëzimeve të tyre dhe publikimin, për të paraparë sanksione më bindëse, efektive dhe proporcionale në lidhje me shkeljet e rregullave të financimit politik dhe për të paraparë publikime periodike të raporteve të partive politike.

353. Në fushën e prokurimit publik, janë ndërmarrë disa masa për të krijuar kushte për transparencë të ngritur dhe barazi në konkurrencë, janë përmirësuar kapacitetet e mekanizmave monitoruese dhe mbikqyrëse, janë paraparë rregulla të parandalimit të konfliktit të interesit në prokurimin publik për të përfshirë deklaratimet e detyrueshme të situatave të konfliktit të interesit nga anëtarët e komisioneve të prokurimit; dhe për të promovuar trajnimin dhe specializimin e mëtutjeshëm të fokusuar në parandalimin dhe zbulimin e praktikave korruptive.

354. Në fund, në lidhje me fushën penale, janë marrë disa hapa për të mbledhur informacione dhe statistika të detajuara dhe të duhura përfshirë të gjitha këndet e një rasti të korrupsionit që nga fillimi deri në fund, është përmirësuar efektiviteti e sistemit përmes prezantimit të pikënisjeve të obligueshme për zbatimin e ligjit në ndjekje të fondeve ilegale, si dhe është bërë progres i pjesshëm në mbledhjen dhe mbajtjen e informacioneve dhe statistikave të duhura dhe të detajuara për ndihmën e ndërsjellë juridike dhe çështjet e tjera të ngjashme.

355. Përkundër zhvillimeve pozitive të përmendura më lart, shumë më shumë nevojitet për t'u bërë. Autoritetet e Kosovës thirren fuqishëm që të bëjnë përpjekje të qëndrueshme në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me rekomandimet e lëshuara nga Raporti i Vlerësimit të ciklit të parë të PECK. Kjo do të kërkonte përkushtim të fortë politik përveç masave të koordinuara, të prioritetuara dhe efektive të cilat duhet të ndërmerren pa asnjë vonesë.

356. Autoritetet e Kosovës thirren të vazhdojnë t'ia kushtojnë rëndësinë e duhur masave që do të merren apo që janë në proces për t'u marrë në të ardhmen për të zbatuar rekomandimet e mbetura.

Shtojca I: Matrica e Përputhshmërisë – Cikli II

RV Cikli I - Rekomandimi	Zbatuar kënaqshëm	Trajtuar në mënyrë të kënaqshme	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1. Pasqyrë e përgjithshme e situatës aktuale të korrupsionit				
i. (i) të ndërmerret një vlerësim periodik i rreziqeve të korrupsionit, para çdo rishikimi tjetër të dokumenteve strategjike (strategjisë kundër korrupsionit dhe planit të veprimit); (ii) të miratohet një qasje më e integruar e aspekteve etike përmes planeve adekuate të integritetit, me qëllim të shtrirjes së masave parandaluese në tërë sektorin publik, përfshirë edhe pushtetin lokal; dhe (iii) të publikohen të gjeturat përkatëse dhe kështu të definojnë/përshtaten më tej prioritetet strategjike (paragrafi 62) ²⁴ ;	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
ii. të sigurohet zbatimi dhe monitorimi i duhur dhe efektiv i kornizës së re strategjike kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017, si dhe të zbatohen masat kyçe që nuk janë zbatuar prej planit të mëparshëm të veprimit 2010-2011 (paragrafi 72);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
iii. (i) të rregullohet korniza legjislative në lidhje me parandalimin e konflikteve të interesit, përmes harmonizimit të legjislacionit përkatës me Kodin Penal që është miratuar së fundmi; (ii) të shqyrtohet dhe të qartësohet korniza institucionale për parandalimin e konflikteve të interesit, përmes miratimit të një sërë udhëzuesve që do të mundësonin veprime efikase gjatë procedurave për kundërvajtje dhe atyre për veprat penale, (iii) të inicohet debat mbi ripërcaktimin e kompetencave të AKK-së, nga pikëpamja e nevojës për parandalim më efikas dhe efektiv të korrupsionit; dhe (iv) të përfshihen në mënyrë progresive autoritetet tatimore në verifikimin e pasurive të deklaruara, në mënyrë që të përmirësohet kontrolli i prejardhjes së pasurisë, dhe kështu të zvogëlohet hapësira për pasurim të paligjshëm (paragrafi 79).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.1 Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit - Gjyqtarët				
iv. të rishikohet përbërja e KGJK-së për ta pasqyruar plotësisht standardin e pavarësisë së gjyqësorit, si dhe ndarjen e pushteteve mes institucioneve (paragrafi 114);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
v. të miratohen kritere të qarta dhe transparente në bazë të të cilave presidenti do të mund ta refuzonte nominimin e ndonjë gjyqtari apo prokurori, si dhe bazën për apelimin e këtij vendimi (paragrafi 119);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
vi. të merret parasysh shqyrtimi i sistemit provues të emërimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, i cili parasheh afatin fillestar trevjeçar para konfirmimit përfundimtar të mandatit (paragrafi 129);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
vii. të sigurohet funksionimi i duhur i caktimit të rastësishëm të lëndëve, siç është parashikuar në Rregulloren për organizimin e brendshëm të gjykatave (paragrafi 141);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
viii. (i) të themelohet një sistem transparent dhe i unifikuar për ruajtjen dhe qasjen e informatave rreth dosjes së lëndës, ku do të përfshiheshin të gjitha fazat e hetimeve, të ndjekjes penale dhe të gjyqimit;	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

²⁴ Numrat e paragrafëve janë ato të përmendura në [Raportin e Vlerësimit](#) të PECK për përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën kundër korrupsionit (Cikli 1); 10 qershor 2013.

RV Cikli I - Rekomandimi	Zbatuar kënaqshëm	Trajtuar në mënyrë të kënaqshme	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
(ii) të përmirësohet menaxhimi i lëndëve, raportimi dhe qasshmëria e statistikave në sistemin gjyqësor, në veçanti lidhur me korrupsionin dhe veprat e ndërlidhura, duke siguruar përputhshmëri më të mirë me shërbimet e prokurorisë; dhe (iii) të përmirësohet transparenca e sistemit të drejtësisë penale kundrejt qytetarëve dhe mediave, veçanërisht në kontekstin e parandalimit dhe të luftimit të korrupsionit (<i>paragrafi 144</i>);				
ix. të përditësohen rregullat e etikës dhe të sjelljes profesionale për gjyqtarët, përmes përfshirjes së udhëzimeve të duhura, në veçanti lidhur me konfliktin e interesit dhe fushat e ndërlidhura (më konkretisht, për pranimin e dhuratave dhe përparësitë e tjera, mospërputhshmëritë dhe aktivitetet shtesë) (<i>paragrafi 148</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
x. që KGjK-ja të miratojë udhëzues transparentë lidhur me miratimin e angazhimeve të jashtëzakonshme të jashtme të gjyqtarëve, duke i përfshirë arsyetimet e qarta që do të përdoren për dhënien e lejimeve të tilla (<i>paragrafi 157</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xi. (i) të krijohen marrëdhënie formale mes ZPD-së dhe prokurorit të shtetit me qëllim që të përmirësohen hetimet disiplinore dhe penale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të bëhet transparent bashkëpunimi i tyre i ndërsjellë; dhe (ii) të rregullohet dhe qartësohet korniza institucionale dhe procedurat për hetimet disiplinore/penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke përfshirë edhe caktimin e afatit të procedurave disiplinore me qëllim të shmangies së vonësive të panevojshme dhe të mbivënies së procedurave (<i>paragrafi 187</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xii. të qartësohet ndërveprimi në mes të AKK-së dhe të prokurorit, si dhe gjyqtarëve në procedurat për kundërvajtje dhe vepra penale përmes procedurave standarde të operimit mbi konflikteve të interesit, duke pasur parasysh Kodin e ri Penal (<i>paragrafi 188</i>).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.2 Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit - Prokurorët				
xiii. KGjK-ja dhe KPK-ja të miratojnë procedura të qarta dhe gjithëpërfshirëse të verifikimit (i) duke u bazuar në kritere objektive dhe transparente; (ii) të ditura paraprakisht dhe (iii) që çdo vendim të arsyetohet në mënyrë të duhur (<i>paragrafi 209</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xiv. KPK-ja të miratojë udhëzues lidhur me miratimin e angazhimeve të jashtëzakonshme të jashtme të prokurorëve, dhe të përcaktohet kufiri i pagesës për angazhime të tilla (<i>paragrafi 220</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xv. të krijohet marrëdhënie formale mes ZPD-së dhe KPK-së (duke marrë parasysh edhe marrëdhënien mes të kryeprokurorëve dhe ZPD-së) me qëllim të përmirësimit të hetimeve disiplinore dhe penale të prokurorëve, duke u bazuar në parimet e transparencës, duke mbajtur njëkohësisht fshehtësinë e hetimeve dhe duke i mbrojtur të dhënat personale (<i>paragrafi 239</i>).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.3 Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit - Policia				
xvi. të themelohen kritere objektive dhe transparente për emërimin/shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm të policisë për të siguruar pavarësinë operacionale të policisë (<i>paragrafi 254</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xvii. të themelohen kritere objektive dhe transparente për emërimin/shkarkimin e dëvendës drejtorëve dhe të zyrtarëve të tjerë të	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

RV Cikli I - Rekomandimi	Zbatuar kënaqshëm	Trajtuar në mënyrë të kënaqshme	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
nivelit të lartë në polici (<i>paragrafi 255</i>);				
xviii. të miratohen udhëzues për policinë lidhur me miratimin e angazhimeve të jashtëzakonshme të jashtme dhe të themelohet një kufi për pagesën e këtyre angazhimeve (<i>paragrafi 259</i>);	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xix. të themelohen kufizimet pas përfundimit të marrëdhënies së punës së policëve prej të gjitha niveleve dhe të bëhen aranzhime të duhura për mbikëqyrjen efikase të zbatimit të atyre rregulloreve (<i>paragrafi 262</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xx. të fuqizohen kapacitetet njerëzore të organeve përkatëse disiplinore dhe të hetimeve të brendshme të policisë, dhe të mbahen regjistra të besueshëm me të dhëna rreth veprimeve disiplinore dhe të tjera që ndërmerren lidhur me policët (<i>paragrafi 276</i>).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.4 Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit – Administrata Publike				
xxi. (i) të rritet transparenca në administratën publike (përfshirë "e-qeverisjen") përmes zbatimit të politikës më proaktive, fuqizimit të duhur të kornizave rregullative dhe institucionale, si dhe përmes monitorimit dhe raportimit të vazhdueshëm; dhe (ii) të ndërmerren hapa të mëtejshme për ta zbatuar në mënyrë adekuate qasjen në dokumente publike si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal (<i>paragrafi 288</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xxii. (i) të zbatohen rregulla të njëtrajtshme për punësim dhe avancim transparent dhe të paanshëm të nëpunësve civilë, ndër të tjera, përmes njoftimeve të duhura për pozitat e lira, konkurrencës së drejtë mes kandidatëve dhe shmangies së konfliktit të interesit; (ii) të shtohet mbikëqyrja dhe monitorimi i procedurave të përzgjedhjes dhe avancimit të zyrtarëve publikë; dhe (iii) të themelohen procedura të duhura verifikuese për kontrollimin e të dhënave dhe të integritetit të kandidatëve për pozitat në administratën publike (<i>paragrafi 304</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xxiii. (i) të miratohet kodi i etikës për nëpunësit civilë sa më shpejt që është e mundur; (ii) të shqyrtohet mundësia e shtrirjes së zbatimit të tij për kategoritë e pambuluara të zyrtarëve në administratën publike; dhe (iii) të rritet njohuria e të gjitha niveleve të administratës publike rreth standardeve të etikës profesionale (ndër të tjera përmes trajnimeve, udhëzimeve, këshillave të rregullta) (<i>paragrafi 308</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xxiv. të zhvillohen udhëzues në lidhje me sjelljen dhe veprimet e zyrtarëve publikë me rastin kur ata marrin dhurata, në mënyrë që të kompletohen rregullat e parapara në Nenin 11 të Ligjit nr. 04/L-050 mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave të të gjithë Zyrtarëve Publikë (<i>paragrafi 311</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xxv. (i) të fuqizohet kontrolli i deklarimit të pasurisë dhe të interesave me qëllim që të arritjes së zbatimit dhe monitorimit të duhur; (ii) të shtohen përpjekjet për zhvillimin e kapaciteteve nëpër institucionet individuale për parandalimin dhe zbulimin e konflikteve të interesit përmes mbikëqyrjes nga afër dhe mekanizmave bashkëndues si dhe përmes materialeve specifike referuese, udhëzuesve dhe trajnimeve; dhe (iii) të shtrihet tek secili person që ushtron funksion në administratën publike (duke i përfshirë menaxherët dhe këshilltarët) në çdo nivel të qeverisë një standard adekuat dhe i zbatueshëm lidhur me konfliktin e interesit, duke e përfshirë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

RV Cikli I - Rekomandimi	Zbatuar kënaqshëm	Trajtuar në mënyrë të kënaqshme	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
migrimin jo të duhur në sektorin privat ("pantouflage"), (paragrafi 320);				
xxvi. të merret parasysh përdorimi më i gjerë i rotacionit në sektorët e administratës publike, në veçanti në sektorët më të ekspozuar ndaj rrezikut të korrupsionit (paragrafi 322);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xxvii. të themelohet dhe të mirëmbahet raportimi i rregullt qendror i statistikave mbi aplikimin e procedurave dhe sanksioneve disiplinore në administratën publike (paragrafi 332).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
2.5 Mbrojtjet themelore dhe parandalimi i korrupsionit – Anëtarët e Parlamentit (Deputetët)				
xxviii. Kodi i mirësjelljes së deputetëve të kuvendit të rishikohet dhe të plotësohet me masa praktike për zbatimin e tij, siç janë trajnimet e dedikuara, këshillimet në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me etikën dhe korrupsionin (paragrafi 351);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xxix. t'ij jepet AKK-së – ose ndonjë organi tjetër zyrtar, në bashkëpunim me administratën tatimore - kompetenca për kryerjen e vlerësimit të duhur të pasurisë së deklaruar (paragrafi 367);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xxx. të ndërmerren masa për të siguruar mbikëqyrjen dhe zbatimin e rregullave ekzistuese lidhur me konfliktin e interesit dhe zbulimin e lidhjeve të jashtme nga ana e deputetëve të kuvendit (paragrafi 379).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
2.6 Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore				
xxxi. të bëhet harmonizimi i dispozitave juridike për financimin e subjekteve politike dhe të fushatave në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për kandidatët e tjerë për zgjedhjet (për zgjedhjet komunale dhe të përgjithshme dhe për zgjedhjet presidenciale) (paragrafi 403);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xxxii. të përgatitet një faqe unike dhe gjithëpërfshirëse e internetit, e cila e paraqet kornizën juridike dhe rregullative dhe ofron informata përkatëse në lidhje me raportet periodike të subjekteve politike si dhe informata të tjera relevante (paragrafi 404);	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xxxiii. të sigurohet që përkufizimi i 'kontributit' dhënë partisë politike, siç parashihet me Rregullën 01/2008 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, të përdoret vazhdimisht në kornizën legjislative dhe rregullative në lidhje me financimin e subjekteve politike dhe fushatave zgjedhore në mënyrë që të përfshihen burimet e tërthorta (si për shembull shërbimet apo donacionet në natyrë) (paragrafi 420);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xxxiv. të bëhet përkufizimi dhe rregullimi i subjekteve të lidhura me partitë politike (mundësisht) (paragrafi 422);	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xxxv. të përcaktohen kushte më të sakta për kërkesat e raporteve financiare dhe për afatin/afatet e publikimit (paragrafi 436);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xxxvi. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve/Zyrës ose Agjencisë kundër Korrupsionit t'ij jepet mandati dhe autoriteti i duhur si dhe burimet financiare dhe personeli i specializuar për mbikëqyrjen efektive dhe proaktive të financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore, për hetimin e shkeljeve të pretenduara të rregullave për financimin politik, dhe, sipas nevojës, për shqiptimin e sanksioneve (paragrafi 442);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

RV Cikli I - Rekomandimi	Zbatuar kënaqshëm	Trajtuar në mënyrë të kënaqshme	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
xxxvii. (i) të unifikohen formularët e raportimit të partive, në veçanti në lidhje me përmbajtjen, afatet e dorëzimit dhe të publikimit të tyre; dhe (ii) të përcaktohet procedura për monitorimin e standardeve të përcaktuara (<i>paragrafi 443</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xxxviii. të përcaktohen rregulla të qarta të cilat e sigurojnë specializimin, pavarësinë dhe ekspertizën/njohuritë e auditorëve të thirrur për ta bërë auditimin e llogarive të partive politike dhe të kandidatëve (<i>paragrafi 444</i>);	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xxxix. të vendosen sanksione më bindëse, më efektive dhe më proporcionale në lidhje me shkeljen e rregullave të financimit politik dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'i jepet autoriteti i duhur për hetimin e këtyre rasteve dhe për vendosjen e sanksioneve të duhura (<i>paragrafi 454</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xl. t'i caktohet Zyrës autoriteti i duhur për kryerjen, sipas nevojës, të verifikimit thelbësor (përveç shqyrtimit formal ekzistues) të informatave të dhëna prej kandidatëve zgjedhorë dhe subjekteve të tjera politike (<i>paragrafi 455</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xli. raportet e partive politike të publikohen rregullisht në një faqe publike të internetit (<i>paragrafi 456</i>);	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.7 Prokurimi Publik				
xlii. të krijohen kushte për më shumë transparencë dhe barazi në konkurrim, me qëllim për ta minimizuar rrezikun e mundësive për korrupsion në fushën e prokurimit publik dhe të privatizimit (<i>paragrafi 467</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xliii. (i) me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve dhe mundësive për korrupsion, të sigurohet rregullimi i mëtejshëm i procedurave dhe i rregullave për prokurimin publik, duke përfshirë fillimin e shpejtë të blerjes qendrore; (ii) të shtohen mekanizmat dhe kapacitetet e monitorimit, mbikëqyrjes dhe shqyrtimit; (iii) të rishikohet Ligji mbi prokurimin publik për sa i përket fushëveprimin dhe procedurave në lidhje me raportimin e shkeljeve dhe shkelësve të prokurimit publik; dhe (iv) të shtohet shkëmbimi dhe trajtimi i informatave dhe bashkëpunimi horizontal ndërmjet agjencive, sidomos mes organeve të prokurimit publik, të auditimit, organeve kundër korrupsionit, organeve tatimore dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit (<i>paragrafi 489</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
xliv. (i) të krijohen politika dhe trajtime koherente për punonjësit në sistemin e prokurimit publik me qëllim të mënjanimin të ndryshimeve të punonjësve; (ii) të qartësohen dhe fuqizohen procedurat me qëllim për të pasur kritere objektive për lidhjen e kontratave; (iii) të krijohen rregulla për parandalimin e konfliktit të interesit në prokurimin publik, duke përfshirë edhe deklarin e detyrueshëm të situatave të konfliktit të interesit nga anëtarët e paneleve të prokurimit, dhe (iv) të promovohen trajnime dhe specializime të mëtejme të përqëndruara në parandalimin dhe zbulimin e praktikave korruptive (<i>paragrafi 498</i>).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.1 Ligji penal, zbatimi i ligjit dhe procedura penale – Veprat penale dhe sanksionet				
xlv. të ndërmerren masa juridike për t'i mbuluar drejtpërdrejt përfituesit e tretë në Nenet 429 dhe 430 të KP në lidhje me ryshfetin aktiv (<i>paragrafi 524</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

RV Cikli I - Rekomandimi	Zbatuar kënaqshëm	Trajtuar në mënyrë të kënaqshme	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
xlvi. autoritetet të sigurojnë që të mos ketë zbrazëti në sistem, dhe nëse është e nevojshme, të ndër marrin masa legjislative që veprat e mitos aktive dhe pasive në sektorin publik t'i mbulojnë të gjitha veprimet/mosveprimet në ushtrimin e funksioneve të zyrtarit publik, qofshin apo jo në kuadër të fushëveprimit të detyrave të zyrtarit (<i>paragrafi 526</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xlvii. të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislative për të siguruar që korrupsioni në sektorin privat të penalizohet në përputhje me nenet 7 dhe 8 të Konventës Penale mbi Korrupsionin (STE Nr. 173) (<i>paragrafi 539</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xlviii. të shqyrtohet heqja e kërkesës për penalizim të dyfishtë në Nenet 115 dhe 116 të KP në lidhje me veprat penale të korrupsionit që kryhen jashtë vendit (<i>paragrafi 561</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
xlix. të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislative për të siguruar që afatet kohore për hetimet të mos e pengojnë luftën efektive kundër korrupsionit (<i>paragrafi 569</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
I. të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislative për të siguruar shfuqizimin e mundësisë së paraparë përmes mbrojtjes së veçantë të pendimit efektiv për t'ia kthyer ryshfetin dhënësit të ryshfetit që e raporton veprën penale para se ajo të zbulohet (<i>paragrafi 572</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Përgjegjësia e personave juridikë				
li. të fuqizohen funksionet kontrolluese të regjistrimit të ndërmarrjeve me qëllim që të sigurohet që personat fizikë si dhe ata juridikë të cilët themelojnë kompani të kontrollohen dhe të monitorohen në lidhje me historitë e mundshme penale dhe diskualifikimet profesionale apo edhe informatave të tjera përkatëse mbi personat juridikë gjatë procesit të regjistrimit (<i>paragrafi 580</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
lii. të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislative për të siguruar që subjektet juridike të mund të konsiderohen përgjegjëse jo vetëm në situatat kur do të mund të dënohej personi fizik, duke i përfshirë situatat kur përgjegjësia bazohet në mungesën e mbikëqyrjes, por gjithashtu edhe në situatat kur nuk është e mundur të vërtetohet përgjegjësia e personit fizik për veprën penale (<i>paragrafi 584</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
liii. autoritetet e Kosovës të ndër marrin hapat e nevojshëm për ta siguruar dhe për ta përmirësuar zbatimin praktik të kësaj mase (përgjegjësia e personave juridikë) si mjet për sanksionimin e veprimitarisë penale (<i>paragrafi 585</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
liv. Kosova ta shqyrtojë mundësinë që të kërkojë prej auditorëve të jashtëm që ata t'i raportojnë tek menaxhmenti aktet e dyshuara të mitos, ose nëse menaxhmenti nuk reagon apo nëse menaxhmenti është vet i përfshirë, që t'i raportojnë ato tek autoritetet kompetente të pavarura prej kompanisë, siç janë autoritetet e zbatimit të ligjit apo autoritetet rregullative, dhe, kur të jetë e nevojshme, të sigurojnë që auditorët që i bëjnë ato raportime në mënyrë të arsyeshme dhe në mirëbesim të mbrohen prej veprimeve juridike (<i>paragrafi 593</i>);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
3.2 Ligji penal, zbatimi i ligjit dhe procedura penale – Procedura penale dhe hetimore				
iv. të ndërmerren hapa për mbledhjen e informatave dhe statistikave të nevojshme dhe të detajuara, duke përfshirë të gjitha aspektet e rasteve të korrupsionit prej fillimit deri në fund (përfshirë edhe rezultatin e	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

RV Cikli I - Rekomandimi	Zbatuar kënaqshëm	Trajtuar në mënyrë të kënaqshme	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
rastit), me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të hetimeve/ndjekjes penale (paragrafi 612);				
Ivi. të fuqizohet Departamenti special kundër korrupsionit si në lidhje me kompetencën e këtij departamenti ashtu edhe në lidhje me rritjen e burimeve dhe bashkëpunimit midis prokurorëve, hetuesve dhe ekspertëve (paragrafi 615);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Ivii. të ndërmerren hapat e nevojshëm legjislativ për të siguruar që pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqes ankesë në lidhje me ndërprerjen e hetimeve (paragrafi 617).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
3.3 Ligji penal, zbatimi i ligjit dhe procedura penale – Konfiskimi dhe mohimet e tjera të dobive dhe të të ardhurave nga krimet				
Iviii. (i) të themelohet një entitet në kuadër të strukturës ekzistuese me theks të posaçëm për identifikimin, gjurmimin dhe ngrirjen e të ardhurave nga krimi; dhe (ii) të rritet efektiviteti i sistemit përmes themelimit të standardeve të detyrueshme për zbatim të ligjit në ndjekjen e fondeve të mjeteve të jashtëligjshme për hetimet e veprave penale që gjenerojnë të ardhura nga krimi (paragrafi 636);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ilix. të sigurohet që sendet që planifikohen të përdoren në ndonjë vepër penale të mund të konfiskohen si dhe të zgjerohet fushëveprimi i dispozitave për konfiskimin e dobive pasurore dhe i të ardhurave nga krimi në mënyrë që të ofrohen mundësi më të mira për përdorimin efektiv të konfiskimit në rastet e korrupsionit (paragrafi 637).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
3.4 Imuniteti nga hetimi, ndjekja ose dënimi i veprave penale të korrupsionit				
Ix. të ndërmerren hapa për të siguruar që të mos merret parasysh periudha kur hetimi nuk mund të kryhet në afatin kohor për hetim (paragrafi 647).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
4. Bashkëpunimi Ndërkombëtar				
Ixi. (i) të ndërmerren hapa për mbledhjen e informatat dhe statistikave e duhura dhe të detajuara që i përfshijnë të gjitha aspektet e kërkesave për ndihmë juridike reciproke që nga fillimi e deri në fund, në mënyrë që të vlerësohet efikasiteti i dhënies së ndihmës juridike reciproke; dhe (ii) të aplikohen standarde të shërbimit rreth kohës së kthimit të kërkesave të jashtme për ta garantuar efektivitetin e sistemit (shih raportin e vlerësimit kundër pastrimit të parave për pastrimin e parave) (paragrafi 659);	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ixii. të ndërmerren hapa për të siguruar që ndihma juridike reciproke në përputhje me rregullat e Konventës së të drejtës penale mbi korrupsionin (ETS 173) jepet në rastet e korrupsionit, pavarësisht asaj që Kosova nuk ka një detyrim të tillë ligjor (paragrafi 660).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>